

**FINANCAT E TREGTISË: ANALIZË E FAKTORËVE, TË MJEDISIT
MAKROEKONOMIK DHE STRUKTURËS INSTITUCIONALE, QË
KUSHTËZOJNË ZHVILLIMIN E FINANCAVE TË TREGTISË SË
JASHTME NË SHQIPËRI**

Dorina Çumani

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Ekonomi , me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Profesor i Asociuar Doktor Anilda Bozdo

Numri i fjalëve: 52,296

Tiranë, Shtator 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyre eksplicite si të tilla.

Ky material nuk është prezantuar më parë në ndonjë institucion të ngjashëm

Abstrakti

Financat e Tregtisë kanë qenë një nga aktivitetet më të hershme të bankave, dhe nevojat për të mbështetur zgjerimin e tregtisë dhe minimizimin e rreziqeve nga tregtia me vendet e huaja, kanë qenë faktorët shtytës të inovacionit dhe risive në fushën e biznesit bankar. Lindja e kambialeve, premtimpagesave dhe teoria e viteve të fundit po i jep rëndësi instrumenteve financiarë të financave të tregtisë duke i konsideruar si një mjet të mirë për të rritur flukset tregtare dhe menaxhuar rreziqet për tregtarët. Disponueshmëria e instrumentave të financave për tregtinë mund të jetë një katalizator i përshpejtimit të tregtisë ndërkombëtare për vendet në zhvillim dhe vendet me rrezik të lartë të vendit.

Ky punim është fokusuar në disa çështje që lidhen ngushtë me instrumentet e financave për tregtinë dhe ndikimin që përdorimi i tyre mund të japë në nxitjen e flukseve të jashtme tregtare të Shqipërisë. Punimi ka qëllim të identifikojë dhe analizojë faktorët e mjedisit makroekonomik si faktorët kryesorë që kushtëzojnë zhvillimin dhe ofrimin të financave të tregtisë në Shqipëri. Faktorët kryesorë të mjedisit makroekonomik ndikojnë në zhvillimin institucional të financave të tregtisë, ky i fundit bashkë me faktorët kryesorë të mjedisit makroekonomik ndikojnë në disponueshmërinë e financave të tregtisë. Kjo analizë do të ndihmojë të evindetojë faktorët që e kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë, të identifikojë arsyet e paqartësisë së biznesit në lidhje me këto instrumente, të evidentojë se çfarë duhet përmirësuar për të zhvilluar financat e tregtisë, të kuptojë rëndësinë e disponueshmërisë së financave të tregtisë në flukset tregtare dhe sa i ndihmon tregtarët në menaxhimin e rrezikut të vendit.

Nga pikëpamja metodologjike, në shqyrtimin e kësaj problematike jam udhëhequr nga qasja e autorëve të ndryshëm që janë marrë me studimin e kësaj tematike, e cila përfshinë përveçse analizën e përgatitjes dhe gatishmërisë së sistemit bankar të vendit në financat e tregtisë dhe mbulimin e rreziqeve të pagesave në tregtinë me jashtë. Gjithashtu në punim është përdorur analiza krahasuese statistikore e nivelit të zhvillimit të faktorëve që ndikojnë përdorimin e financave të tregtisë në Shqipëri me vendet partnere të saj. Natyra e punimit është hulumtuese dhe analitike.

Studimi konkludon se faktorët që kushtëzojnë më shumë përdorimin e instrumenteve të tregtisë së financave të tregtisë në Shqipëri janë volumi i ulët tregtar, formalizimi i biznesit, rregullimi i pronësisë, mungesa e dijes/trajnimeve nga biznesi, menaxherët, financierët dhe punonjësit e bankave për përdorimin e këtyre instrumenteve, pra lidhja treg pune-dije, koha e aprovimit të instrumentit, kultura e biznesit Shqipëtar i cili merr cdo rrezik përsipër. Shqipëria, nga vlerësimet ka një rrezik të lartë të vendit dhe, sipas teorisë dhe gjetjeve empirike të mëparshme duhet që me rritjen e rrezikut të vendit të rritet edhe përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë.

Fjalët kyç: Financa të Tregtisë, rrezik i vendit, mjedis makroekonomik, instrumente financiare, flukse tregtare.

Abstract

Trade finance has been one of the earliest banks' activities, and the need to support trade expansion and the minimization of trade risks with foreign countries have been the driving factors behind innovation and innovations in the banking business. Birth of bills of exchange, promissory note and the theory of recent years is giving importance to finance trade finance instruments by konsiseruar as a good tool to increase trade flows and manage risks for traders. Availability of financial instruments to trade can be a catalyst for the acceleration of international trade for developing countries and countries with high country risk.

This paper is focused on several issues that are closely related to the financial instruments to trade and the impact that their use can provide in promoting Albania's foreign trade flows. The paper aims to identify and analyze the macroeconomic environmental factors as the main factors that influence the development and provision of trade finance in Albania. The main factors affecting the macroeconomic environment in finance institutional development of trade, the latter with the main factors affecting the macroeconomic environment in the availability of finance trade. This analysis will help clarify the factors that are conducive to the development of trade finance, to identify the reasons for business uncertainty about these instruments, to identify what needs to be improved to develop trade finance, to understand the importance of the availability of finance trade in trade flows and how it helps traders in the country's risk management.

From a methodological point of view, in addressing this issue, I have been led by the approach of different authors who have been involved in the study of this topic, which includes, besides analyzing the preparation and readiness of the country's banking system in trade finance and payment risk coverage in foreign trade. Also in the paper it is used comparative statistical analysis of the level of development of the factors that influence the use of trade finance in Albania with its partner countries. The nature of the work is investigative and analytical.

The study concludes that the factors that make the use of trade finance instruments in Albania more prone to trade are low trade volume, business formalization, ownership regulation, lack of knowledge / training from the ward, managers, financiers and bank employees to use of these instruments, ie the labor-knowledge link, the time of instrument approval, the Albanian business culture that takes every risk. Albania, the estimates there is a high risk country and, according to the theory and previous empirical findings that have increased country risk and increase the use of financial instruments to trade.

Key words: Trade finance, country risk, macroeconomic environment, financial instances, trade flows.

Këtë punim ia dedikoj bashkëshortit tim, Altinit.

FALENDERIME

Falenderoj të gjitha bankat dhe stafin perkatës për informacionet, të cilat më ndihmuan në kërkimin tim.

Banka Raifaisen Bank AL dhe E.Gjoni

Banka Banka Kombëtare Tregtare dhe E.Zeqaj

Credins Bank dhe Erion Daullja, Blerina Mancellari

Intesa Sanpaolo Bank dhe F. Kristo

Alpha bank dhe Elton Rroju Bankën Amerikane të Investimeve

Falenderoj për mbështetjen e profesorëve

Profesor i Asociuar Doktor Elvin Meka

Profesor i Asociuar Doktor Selami Xhepa

Profesor i Asociuar Doktor Arbi Agalliu

pa ndihmën e tyre nuk do ishte e mundur të bëhej ky punim.

Falenderoj për mbështetjen morale që më kanë dhënë gjatë punimit të desertacionit vajzat e mia Megi dhe Dea, prindërit e mi Vasil dhe Kleopatra, gjithashtu Refie dhe Fation Çumani.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakt	3
KAPITULLI I: HYRJE	16
1.1. Pyetja kërkimore dhe hipoteza bazë	18
1.2. Metodologjia	19
1.3. Rëndësia e punimit	21
1.4. Përshkrim i shkurtër i literaturës	22
1.5.Struktura e punimit.....	22
1.6. Përmbledhje e kapitullit	24
KAPITULLI II: KUADRI TEORIK I FINANCAVE TË TREGTISË	25
2.1. Tregtia ndërkombetare dhe financat e tregtisë	25
2.2. Përkufizime të financave të tregtisë	27
2.3. Ndryshimi ndërmjet huasë bankare dhe financave të tregtisë.....	30
2.4. Rëndësia e financave të tregtisë	31
2.4.1. Rëndësia e financave të tregtisë në menaxhimin e rrezikut	39
2.5. Llojet e instrumenteve të financave të tregtisë.....	56
2.5.1.Cash -in -Advance (Parapagim)	58
2.5.2.Documentary Collections (Koleksionet dokumentar)	60
2.5.3.Open Account (Llogari e Hapur)	62
2.5.4.Consignment (dorëzimi i porosisë)	63
2.5.5.Letter of credit (Leter kredi)	64
2.5.6.Export Working Capital Financing (EWC)	68
2.5.7.Working Capital Loan Programs	68
2.5.8.Export Credit Insurance (ECI)	68
2.5.9.Eksport Factoring	69
2.5.10.Government-Backed Agricultural Export Financing	84

2.5.11.E- Financa tregtare	70
2.6. Pëmbledhje kapitulli.....	75
KAPITULLI III: FAKTORËT QË KUSHTËZONË FINANCAT E TREGTISË	77
3.1. Rëndësia e përdoruesve dhe aktorëve kryesorë të financave të tregtisë	86
3.2. Indikatori i matjes së financave të tregtisë.....	89
3.3. Përmblendhje kapitulli	93
KAPITULLI IV : METODOLOGJIA	94
4.1. Shrytëzimi i kuadrit teorik për kërkimin e të dhënave në teren	94
4.1.1. Burimet e informacionit	95
4.2. Mbledhja e të dhënave parësore.....	97
4.2.1. Lloji i pyetësorit dhe ndërtimi i tij:	97
4.2.2. Qëllimi i pyetësorit:.....	98
4.2.3. Analiza përshkruese statistikore e të dhënave.....	98
4.2.4. Vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren.....	99
4.3. Mbledhja e të dhënave dytësore :Faktorët e marrë në studim në analizën krahasuese	100
4.3.1. Vështirësitë e mbledhjes së të dhënave dytësore	104
4.3.2. Burimet e faktorëve.....	105
4.4.Përmblendhje kapitulli	106
KAPITULLI V : ANALIZË VROJTUESE E FINANCAVE TË TREGTISË NË SHQIPËRI.....	107
5.1. Rezultatet e pyetësorit.....	107
5.2. Përmblendhje kapitulli	122
KAPITULLI VI: ANALIZË KRAHASUESE STATISTIKORE E FAKTORËVE QË KUSHTËZONË FINANCAT E TREGTISË	123
6.1. Konkurenca e Shqiperisë në tregun global	123
6.2. Analizë krahasuese e faktorëve që kushtezojnë financat e tregtisë.....	128
6.2.1. Situatës së tregtisë	128
6.2.2. Borxhi publik	132
6.2.3. Investime të huaja direkte	136

6.2.4. Kursi i këmbimit	139
6.2.5. Politika monetare e Shqipërisë.....	141
6.2.6. Zhvillimi i tregut financiar	143
6.2.7. Cilësia e bankave.....	150
6.2.8. Vështiësia në huamarrje	151
6.2.9. Aspekti ligjor.....	152
6.2.10. Aftësia kredituese.....	155
6.2.11. Situata e Kreditimit të biznesit dhe tregtisë	157
6.2.12. Rreziku i vendit	162
6.3. Natyra e sigurt e përdorimit të financave të tregtisë së jashtme	163
6.4. Përmbledhje kapitulli	168
KAPITULLI VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	170
7.1. Konkluzione	172
7.2. Rekomandime	180
7.3. Kontributi i punimit	183
7.4. Kërkimet e ardhshme	184
Shtojca.....	185

LISTA E ILUSTRIMEVE

Grafiku 1: Eksportet sipas vendeve partnere kryesore	129
Grafiku 2 Importet sipas vendeve partnere kryesore.....	130
Grafiku 3 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin	132
Grafiku 4 Struktura e stokut të borxhit i.....	133
Grafiku 6 : Borxhi publik sipas vendeve për vitin 2015	135
Grafiku 7 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin	135
Grafiku 8 Niveli I investimeve të huaja direkte në Shqipëri 2014-2017.....	137
Grafiku 10 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin	138
Grafiku 11. Zhvillimin financiar të Shqipërisë nga viti 2006-2015	145
Grafiku 12 : zhvillimit financiar me vendet partnere	146
Grafiku 13 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin	147
<i>Grafiku 14 : Disponueshmërinë e shërbimeve dhe instrumentave financiarë për biznesin nga viti 2010-2015.....</i>	<i>154</i>
Grafiku 15 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin	156
Grafiku :16 Kredia për biznese sipas sektorëve të ekonomisë.	159
Grafiku: 17 Kërkesa dhe oferta e kredisë.	160
Grafiku 18 Kredia për biznese sipas ekonomive.....	160
<i>Tabela 26:Normat e humbjes te transaksionit 2008-2014</i>	<i>164</i>
Grafiku19 , 20 , 21, 22:Normat e mospagesës te konsumatorëve nëpër rajone dhe Produkte, 2008-2014	165
Grafiku 23: Vëllimi i L / Cs dërguar nga Rajonet, 2014	166
Grafiku 24: Vlera mesatare e L / Cs dërguar nga Rajonet, 2014	166
Grafiku 25 : Transaksionet e propozuara	168
Grafiku 26:Transaksionet E refuzuara.....	168

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabela 1. Forma të ndryshme të rrezikut në tregtinë ndërkombëtar	41
Tabela 2: Krahاسimi i instrumentave të financave të tregtisë	67
Tabela 3. Huatë dhe depozitat sipas bankave.....	96
Tabela 4. Huatë dhe depozitat sipas bankave që i janë përgjigjur pyetësorit	97
Tabela 5 Lloji i instrumentave të përdorur nga bankat në Shqipëri	107
Tabela 6 Numri i klientëve që përdorin financat tregtare	110
Tabela 7 Destinancini i përdorimit të instrumenteve të financave tregtare	111
Tabela 8 Koha mesatare e aprovimit të instrumenteve	112
Tabela 9 Madhësia e biznesit që përdorin financat tregtare.....	113
Tabela 10 Lloji i biznesit që përdorin financat tregtare	114
Tabela 11 Lloji i kolateralit që kërkohet për instrumentet e financave tregtare	115
Tabela 12 Rajonet ku përdoren më shpesh instrumentet e financave tregtare.....	116
Tabela 13 Dokumentacioni i kërkuar për instrumentet e financave tregtare	117
Tabela 14 Vlerësimi i faktorëve që kushtëzojnë financat tregtare në Shqipëri.....	120
Tabela 15 Shkallët e zhvillimit të vendit	123
Tabela 16 Tregtia në Shqipëri 2012-2016.....	128
Tabela 17 Bilanci tregtar i vendeve kryesore partnere të Shqipërisë.....	131
Tabela 18 kursi mesatar i këmbimit me dy monedhat kryesore 2012-2016	140
Tabela 19: Zhvillimin financiar të Shqipërisë nga viti 2006-2015	144
Tabela 20 Cilësia e Bankave	150
Tabela 21 Veshtiresia në huamarrje	151
Tabela 22 Veshtiresia në huamarrje	153
Tabela 23 Aftësia kredituese	156
Tabela 24 Rreziku i vendit	162
Tabela 25: Normat humbjes të obliguesit 2008-2014.....	164
Tabela 26: Normat e humbjes të transaksionit 2008-2014.....	164

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

BIS	Komiteti i Bazelit per Survejimin e Bankave (Basel Committee on Banking Supervision),
ICC	Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (International Chamber of Commerce)
IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar (International Monetary Fund)
UNCTD	United Nations Conference on Trade and Development (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin)
UNCTAD	Division on International Trade in Goods and Services and Commodities (Divizioni për Tregtinë Ndërkombëtare në mallra dhe shërbime)
IFC	International Finance Corporation (Korporata Ndërkombëtare e Financimit)
WEF	World Economic Forum (Forumi Ekonomik Botëror)
ITC	International Trade Center (Qendra Ndërkombëtare e tregtisë)
UNICITRAL	United Nations Commission on International Trade Law (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare)
ADB	Asian Development Bank (Banka Aziatike për Zhvillim)

EBRD	European Bank for Reconstruction and Development (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim)
ESCAP	Economic and Social Commission for Asia and the Pacific (Komisioni Ekonomik dhe Social për Azinë dhe Paqësorin)
ECA	Eksportit Credit Agencies (Agjensia e kreditimit të eksportit)
NVM	Ndërrmarrje të vogla dhe të mesme

KAPITULLI I: HYRJE

Në mes të realitetit të vështirë të viteve të fundit ku ekonomitë e botës luftojnë krizën e fundit financiare, liderët politikë dhe të biznesit vazhdojnë të shikojnë flukset e tregtisë dhe investimet e fuqishme si mjet për të mbështetur sistemin ekonomik global dhe për të shërbyer si motor i shërimit nga krizat të cilat përballemi. Tregtia mbetet një faktor i rëndësishëm i përpjekjeve të shumta që lidhen me zhvillimin ndërkombëtar, uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike në vendet në zhvillim.

Një nga mësimet e nxjerra në kulmin e krizës globale ekonomike, ishte roli i financave të tregtisë i cili u konsiderua thelbësor për tejkalimin e krizës së likuiditetit. Kriza globale financiare gjithashtu ka krijuar debat në lidhje me nivelin e disponuashmërisë e financave të tregtisë, sidomos në kohë krize dhe sidomos për vendet në zhvillim, në mënyrë që të mbajnë stabël dhe pse jo të rrisi flukset tregtare.

Biznesi në Shqipëri si pjesë e një vendi në zhvillim dhe rrezik të lartë të vendit, ka nevojë për financim dhe lehtësi në gjendjen e këtij financimi nëpërmjet instrumentave të tillë që sigurojnë transaksione të sigurta dhe menaxhim e rreziqeve në tregtinë ndërkombëtare. Si rrjedhim, i jep mundësi biznesit të integrohet në tregje të reja, partnerë të rinj dhe e bën biznesin Shqipëtar më konkurrues me vendet e tjera.

Instrumentet e financave të tregtisë, janë dukshëm pak të kuptuar si faktor i zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare, nga kompanitë e të gjitha madhësive, dhe nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në veçanti në Shqipëri. Këto të fundit janë të bazuara në zhvillim dhe në zgjerimin e tregjeve dhe si rrjedhojë kanë nevojë edhe më urgjente të likuiditetit dhe të zbutjes së rrezikut përmes instrumenteve të posaçëm. Bizneset duhet të sigurohen se po kryejnë transaksione të sigurta duke u mbrojtur ligjërisht nga rreziqet e vendit me të cilin po kryen shkëmbimet, duhet të sigurohet eksportuesi se do të paguhet dhe duhet të sigurohet importuesi se porosia do të vijë e pa dëmtuar dhe në kohë. Gjithashu nëpërmjet

këtyre instrumentave tregtarët mund të mbrohen nga rreziqe, si: rreziku politik, institucional, i biznesit, komercial etj.

Për tu bindur për rëndësinë e disponueshmërisë së financave tregtare dhe instrumentave të saj në flukset tregtare, kontributin që i jep tregtarëve në menaxhimin e rrezikut të vendit është e domosdoshme ta studiojmë çështjen dhe të hulumtojmë mbi faktet.

Qëllimi i këtij studimi në këtë punim është të identifikojë dhe analizojë faktorët e mjedisit makroekonomik dhe institucional që kushtëzojnë zhvillimin dhe ofrimin e financave të tregtisë së jashtme në Shqipëri. Egzistojnë arsye pse ky punim është fokusuar te financat e tregtisë dhe faktorët që i kushtëzojnë ato. Së pari, financat e tregtisë janë një mjet i mirë për ti krijuar likuiditet tregut. Së dyti, biznesi ka pasur dhe do ketë gjithnjë nevojë për financim, këtë fakt e ka përforcuar më shumë kriza e fundit financiare. Së treti, tregtia ndikon pozitivisht në zhvillimin e vendit dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë. Së katërti, në një vend me rrezik të lartë të vendit si ku Shqipëria tregtarët dhe partnerët tregtarë të saj duhet të menaxhojnë rreziqet përdorimi i financave të tregtisë duhet të jetë i lartë. Instanca të ndrryshme ndërkombëtare publikojnë në mënyrë periodike raporte që tregojnë nivelin e ulët të përdorimit të financave të tregtisë dhe rrjedhimisht edhe nivelin e ulët të përdorimit të instrumenteve të saj. Por një studim i thelluar i cili analizon shkaqet e mundshme të një niveli të ulët të zhvillimit të financave të tregtisë në Shqipëri, me fokus implementimin e tij dhe gjetja e mënyrave për nxitjen dhe përmirësimin e tij në të ardhmen, do të ishte me interes të biznesit, institucioneve financiare dhe institucioneve politikëbërëse.

Objektiva të punimit janë: *së pari*, të evidentojë faktorët e mjedisit makroekonomik që e kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë; *së dyti*, të analizojë këta faktorë duke i krahasuar nivelin e zhvillimit të tyre me të njëjtët faktorë të partnerëve tregtarë të Shqipërisë, nëpërmjet analizës krahasuese të faktorëve; *së treti*, të analizojë situatën aktuale të disponibilitetit të instrumentave financiarë për tregtinë në tregun bankar Shqiptar, nëpërmjet pyetësorit; *së katërti*, të analizojë arsyet e paqartësisë së biznesit në lidhje me këto instrumente; *së pesti*, të evidentojë se cilët faktorë duhet përmirësuar për të zhvilluar financat e tregtisë në Shqipëri; *së gjashti*, të kuptojë rëndësinë e disponueshmërisë së

financave të tregtisë në flukset tregtare dhe sa i ndihmon tregtarët në menaxhimin e rrezikut të vendit.

1.1. Pyetja kërkimore dhe hipoteza bazë

Pyetja bazë kërkimore është:

Cilët faktorë të mjedisit makroekonomik kushtezojnë zhvillimin e financave të tregtisë së jashtme në Shqipëri?

Hipoteza bazë:

Zhvillimi i financave të tregtisë dhe struktura institucionale varet drejtpërdrejt nga mjedisi makroekonomik dhe rreziku i vendit.

Me “*faktorë/ mjedis makroekonomik*” në rastin e financave të tregtisë do të kuptojmë: situatën e tregtisë, burime financiare, borxhet e jashtme dhe likuiditeti, politika e kursit të këmbimit, sistemi monetar dhe sistemi financiar, tregu i kreditimit dhe mjedisi ligjor.

Për “*strukturën dhe kapacitetin institucional i financave të tregtisë*” do të kuptojmë faktorët: institucionet financiare, kapitali dhe kreditimi, kosto e huamarrjes. Faktorët e mjedisit makroekonomik ndikojnë në zhvillimin institucional të financave të tregtisë, ky i fundit bashkë me faktorët e mjedisit makroekonomik ndikojnë në disponueshmërinë e financave të tregtisë.

Me “*rrezik të vendit*” do të kuptojmë një koleksion i rreziqeve që lidhen me investimin në një vend të huaj. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun politik, rrezikun e kursit të këmbimit, rrezikun ekonomik, rrezikun sovran dhe rrezikun i transfertave, që është rreziku i bllokimit të kapitalit ose ngrirjes nga veprimi i qeverisë. Rreziku i vendit ndryshon nga një vend në tjetrin. Vende që kanë rrezik të lartë dekurajojnë shumë investimet e huaja.

Me frazën “*varet drejtpërdrejt*” do të kuptojmë se zhvillimi i këtyre faktorëve ndikon në kushtëzimin apo në zhvillimin e financave të tregtisë.

Sipas Malaket (2014) “*financat e tregtisë*” do ti kuptojmë si kombinimin e katër faktorëve: lehtësimi dhe sigurimi i pagesave në kohë; sigurimi i financimit të blerësve, shitësve, bankave dhe anëtarëve të zinxhirit të vlerës të transaksioneve tregtare; zbutja e llojeve të rrezikut në kontekstin e tregtisë ndërkombëtare; sigurimi i informacionit rreth transaksionit në lidhje me lëvizjen financiare.

Disa nga çështjet e mësipërme janë gjithnjë e më shumë në qendër të transaksioneve të brendshme dhe modeli i financimit të zinxhirit të ofertës të cilat mund të aplikohen për të dy llojet e bizneseve si lokale dhe biznes ndërkufitar. Informacioni mbi flukset, transaksionale dhe financiare, është një fushë me fokus dhe theks në rritje, se si ofrues të ndryshëm kërkojnë zgjidhje dhe mënyra për të dalluar ofertat e tyre nga konkurrentët është një fakt që mund të provohet nga bizneset e të gjitha madhësive.

Kombinimi optimal i katër faktorëve varion nga natyra e transaksionit ndërmjet blerësve dhe shitësve, tregut të përfshirë dhe produkteve që tregtojnë.

Disa mund të mendojnë se financat e tregtisë është një produkt i vetëm financiar, por është më shumë se një produkt, natyra dhe mënyra e përdorimit do të trajtohet në vijimësi. Produktet janë disa në varësi të nevojës dhe kërkesave të blerësve dhe të shitësve. Për më shumë, produktet u përshtaten të gjitha llojeve të bizneseve dhe madhësive. Financat e tregtisë janë gjithnjë e në përsosje të instrumentave të saj duke iu përshtatur tregut global.

1.2. Metodologjia


Në funksion të vërtetimit të hipotezës në studim është përdorur analiza krahasuese statistikore e nivelit të zhvillimit të faktorëve që ndikojnë përdorimin e financave të tregtisë në Shqipëri me vendet partnere të saj. Gjithashtu, është përdorur një analiza vrojtuese e cila këkon të evidentojë sa përdoren, sa njihen, përdoren më shumë për eksport apo import, a i ndihmojnë tregtarët për të kryer transaksione të sigurta, dhe a ka pengesa ligjore për përdorimin e tyre. Natyra e punimit është hulumtuese dhe analitike.

Në analizën krahasuese statistikore të nivelit të zhvillimit të faktorëve që ndikojnë përdorimin e financave të tregtisë në Shqipëri analizohen statistikatat, niveli i zhvillimit të

faktorëve makroekonomik me zhvillimin e tyre në vendet partnere në tregti me Shqipërinë dhe nivelin e disponueshmerisë të financave tregtare, përkatësisht.

Disponueshmëria dhe zhvillimi i financave tregtare ndikohet në mënyrë indirekte nga mjedisi makroekonomik, kjo përcaktohet nga flukset tregtare aktuale të një vendi, burimet neto, borxhi i jashtëm dhe likuiditeti etj., Por ndikohet drejtpërdrejt edhe nga struktura institucionale e financimit të tregtisë dhe kapaciteti i institucioneve financiare, kufizimet e kapitalit dhe kredisë dhe koston e huamarrjes. Megjithatë, siç tregohet qartë në figurë struktura institucionale dhe kapaciteti i financave të tregtisë vetë varet drejtpërdrejt nga mjedisi makroekonomik. Pra, faktorët kryesorë të mjedisit makroekonomik ndikojnë në zhvillimin institucional të financave të tregtisë, dhe ky i fundit bashkë me faktorët kryesorë të mjedisit makroekonomik ndikojnë në disponueshmërinë e financave të tregtisë.

Figura 1 Dhjetë përcaktues të qasjes dhe disponueshmërisë së financave të tregtisë
Burimi: Development handbook for economies in transition(2005)



Ne pjesën hulumtuese studimi shtrihet në bankat më të mëdha që operojnë në Shqipëri të cilat përbëjnë afërsisht 80% të totalit të huasë bankare dhe mbi 70 % të depozitave në vend.

Këto të dhëna japin një pasqyrë të plotë dhe realiste të situatës në vend. Të dhënat parësore janë mbledhur gjatë vitit 2017 dhe bankat janë përgjigjur pyetësorit për gjendjen e faktorëve që kushtëzojnë zhvillimin e financave e tregtisë për tregtinë jashme, etj. Analiza e faktorëve që ndikojnë dhe kushtëzojnë financat e tregtisë në Shqipëri përbën pjesën kryesore të punimit dhe të konkluzionet që dalin nga ajo. Punimi ka përdorur si referencë një literaturë të gjerë të huaj të fokusuar në financat e tregtisë. Të dhënat dytësore për analizën krahasuese janë marrë nga databaza të besueshme si Doingbusiness, WEF, Banka Botërore, Banka Qendrore e Shqipërisë dhe Instat etj.

1.3. Rëndësia e punimit

Nga teoria trumpetohet se tregtia është mjet i rritjes ekonomike dhe zhvillimit të vendit, si rrjedhim, rrit konkurrencën e vendit me vendet e tjera. Shumë vende i kushtojnë rëndësi faktorëve që ndikojnë/ kushtëzojnë zhvillimin e saj duke bërë studime në teren dhe duke analizuar statistikën e publikuara periodikisht. Pikërisht për këtë arsye si edhe mungesa e një analize të financave të tregtisë në Shqipëri vendosa të analizojë dhe hulumtojë mbi çështjen.

Rëndësia e këtij punimi konsiston në evindetimin dhe nxjerrjen në pah e faktorëve që e kushtëzojnë zhvillimin e financimit të tregtisë, në analizimin këtyre faktorëve duke i krahasuar me tregun ndërkombëtar, në analizimin e situatës aktuale të disponibilitetit të instrumentave financiarë për tregtinë në tregun bankar, në analizimin e arsyeve e paqartësisë së biznesit në lidhje me këto instrumente, në evidentimin e faktorëve që duhen përmirësuar për të zhvilluar financimin e tregtisë dhe të kuptojmë rëndësinë e disponueshmërisë së financave të tregtisë në flukset tregtare dhe sa i ndihmon tregtarët në menaxhimin e rrezikut të vendit. Në përfundim, është i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e biznesit, bankave dhe politikbërësve mbi rëndësinë e financave të tregtisë dhe domosdoshmërinë e përdorimit të këtyre instrumentave në shkëmbimet ndërkombëtare. Punimi nxjerr përfundime bazuar në analizën e faktorëve që ndikojnë financat e tregtisë në Shqipëri dhe bën rekomandimet e duhura për të përmirësuar kushtet në të ardhmen.

1.4. Përshkrim i shkurtër i literaturës

Literatura egzistuese përse i përket financave të tregtisë nuk është shumë e gjerë për shkak se është një fushë relativisht e re nga ana akademike edhe në aspektin e mbledhjes së statistikave në shtrirje kohore. Megjithatë në funksion të vërtetimit të hipotezës qëllimit dhe objektivave të punimit është shfrytëzuar literatura në dispozicion nga një sere autorësh dhe ekspertësh ku trajtohen përkufizimet mbi financat e tregtisë, llojet e instrumenteve, rëndësia e përdorimit të financave të tregtisë në rritjen e flukseve tregtare në përgjithësi. Pjesa më me rëndësi për punimin është pjesa e shfrytëzuar për identifikimin e faktorëve të mjedisit makroekonomik që ndikojnë në zhvillimin e financave të tregtisë.

Një aspekt tjetër i trajtuar nga teoria në shërbim të punimit është edhe lidhja e menaxhimit të rreziqeve të ndryshme me përdorimin e *financave të tregtisë* në tregtinë ndërkombëtare. Në lidhje me ndikimin e përdorimit të financave të tregtisë egzistojnë një serë punimesh empirike që tregojnë se vendet i përdorin për të krijuar marrëdhënie të besueshme me partneret e tyre në tregti dhe krijimin e transaksioneve të sigurta ndërkombëtare. Të dhënat, statistikave për vendet e zhvilluara në shumicën e rasteve janë të gjendshme por për Shqipërinë janë inegzistente. Mungesa e të dhënave për financat e tregtisë në Shqipëri ndihet më shumë në të dhënat mbi përdorimin e tyre, dhe strategjitë e ndjekura për zhvillimin e çështjes. Pikërisht për këtë fakt ndoshta e bën këtë punim të rëndësishëm dhe të domosdoshëm, edhe pse rezultatet e arritura mund të jenë modeste por të rëndësishme për të qënë referencë për studime më të thelluara në të ardhmen.

1.5 Struktura e punimit

Realizimi i këtij punimi është organizuar në gjashtë kapituj. Secili nga kapitujt është ndërthurrur me tjetrin duke krijuar kështu një vijueshmëri të mendimit dhe qëllimit kryesor të punimit.

Për studimin e financave të tregtisë në Shqipëri, në *kapitullin e parë* punimi nis me një shpjegim të problematikës, rëndësisë së studimit dhe shtrimit të pyetjeve dhe hipotezave kryesore metodologjinë e përdorur, një përshkrim të shkurtër të literaturës dhe shtrukturën e tij sipas kapitujve të trajtuar.

Në *kapitullin e dytë* bëhet një trajtim i teorive dhe përkufizimet kryesore të financave të tregtisë, ndrryshimi ndërmjet huasë dhe financave të tregtisë, rëndësia e financave të tregtisë dhe rëndësia në vecanti në më menaxhimin e rrezikut dhe vlerësime nga autorë të ndrryshëm për financat tregtare. Kapitulli mbyllet me llojet e instrumentave të financave të tregtisë, përdorimin e tyre dhe teknika.

Në *kapitullin e tretë* evidentohen nga teoria faktorët kryesorë që kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë, institucionet kryesore dhe aktorët kryesorë që marrin pjesë në infrastrukturën e financave të tregtisë. Në përfundim të kapitullit është evidentuar Indikatori i matjes së financave të tregtisë si pjesë e faktorëve kryesorë për lehtësimin e tregtisë.

Në *kapitullin e katërt* tregohet në mënyrë të hollësishme metodologjia e ndjekur për vërtetimin e hipotezës bazë dhe kthimit përgjigje të pyetjes kërkimore. Gjatë kapitullit janë treguar hollesisht metodologjia e zbatuar në vujim të punimit. Janë shqyrtuar çështje si: shrytëzimi i kuadrit teorik për kërkimin e të dhënave në teren, qëllimi i pyetësorit, lloji i pyetësorit dhe ndërtimi i pyetësorit, vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren. Kapitulli vijon me detajimin e dhjetë përcaktuesve të qasjes dhe disponueshmërisë së financave të tregtisë : situata e tregtisë, burimet neto, borxhi jashtëm dhe likuiditeti, politika kursit të këmbimit dhe disponueshmeria, sistemi monetar dhe financiar, tregu i kreditimit, mjedisi ligjor, institucionet financiare, kapitali dhe kreditimi, kosto e huamarrjes.

Në *kapitullin e pestë* tregohen rezultatet e një hulumtimi në tregun bankar të Shqipërisë. Të dhënat janë burime parësore të mbledhura nga pyetësi i drejtuar bankave më të mëdha në Shqipëri. Këto pyetje janë përgatitur vetëm për këtë punim duke marrë parasysh kushtet e

bankave në Shqipëri dhe respektimin e sekretit bankar. Pyetësi ka pesëmbëdhjetë pyetje me fund të mbyllur. Në vijim të kapitullit trajtohen rezultatet e pyetësorit.

Në kapitullin e gjashtë pasi analizohet konkurrenca e Shqipërisë në tregun global, analiza vazhdon në mënyrë të hollësishme me faktorët të cilët ndikojnë dhe kushtëzojnë financat e tregtisë në tregtinë e jashtme të Shqipërisë. Analizohen faktorë makroekonomik si situata e tregtisë, burimet financiare, borxhet e jashtme dhe likuiditeti, politika e kursit të këmbimit, sistemi monetar dhe sistemi financiar, tregu i kreditimit, mjedisi ligjor dhe rreziku i vendit. Analizohet niveli i zhvillimit të tyre dhe më pas të krahasuara me nivelin e zhvillimit vendet e huaja konstatohen se sa i kushtëzon niveli i zhvillimit të tyre financat e tregtisë në Shqipëri. Në përfundim të kapitullit jepen fakte për natyrën e sigurt të instrumenteve të financave të tregtisë .

Në kapitullin e shtatë tregohen gjetjet e punimit, përfundimet kryesore, rëndësinë e punimit, rekomandime dhe këshilla për punime të mundshme të ardhshme.

1.6. Përmbledhje e kapitulli

Në këtë kapitull u diskutua për qëllimet, objektivat dhe rëndësinë e punimit duke vijuar me hipotezën dhe pyetjen kërkimore. Kapitulli diskuton mbi metodologjinë dhe literaturën e përdorur në punim duke përmbyllur me një pasqyrë të kapitujve në vijim. Në kapitullin pasardhës do të diskutohen teoritë dhe përkufizimet kryesore të financave të tregtisë, ndrryshimi ndërmjet huasë dhe financave të tregtisë, rëndësia e financave të tregtisë, vlerësime nga autorë të ndrryshëm dhe llojet e instrumentave të financave të tregtisë.

KAPITULLI II: KUADRI TEORIK I FINANCIVE TË TREGTISË

2.1. Tregtia ndërkombetare dhe financat e tregtisë

Ndonëse financat e tregtisë janë rutinë, ato janë jetike për aktivitetet tregtare. Përpara krizës financiare së viteve 1990 dhe 2008-09, financimi në tregti ishte i lehtë për të marrë e për të dhënë. Gjatë krizave financiare Latino Amerikane dhe Aziatike, krediti në nivel vendi preku eksportin dhe importin deri në pikën e ndalimit, (OBT, 1998: cituar nga Trade Finance and SME-s, 2016). Kjo çoi komunitetin ndërkombëtar të reflektojë në lidhje me disponueshmërinë e financave të tregtisë dhe përdorimin e instrumenteve të saj gjatë periudhave të krizës dhe më gjerë. FMN (2003 cituar nga Trade Finance and SME-s, 2016) dhe OBT (2004 cituar nga Trade Finance and SME-s, 2016) identifikuan elementët e dështimit të tregut, reagimet masive për llogari të bankave, konfuzionin e palës tjetër dhe rreziqet e vendit, boshllëqet e perceptuara si dhe sjellje të tjera përçarëse. FMN-ja ka rekomanduar një sërë masash për të ndihmuar importuesit, eksportuesit dhe bankat e tyre, sidomos për lehtësimin e financimit të tregtisë gjatë krizës dhe periudhave të qeta gjithashtu.

Gjatë kësaj periudhe, anëtarët e OBT-së raportuan në Konferencën e OBT "kryesisht e bazuar në përvojën e fituar në Azi dhe gjetkë, se ka nevojë për të përmirësuar stabilitetin dhe sigurinë e burimeve të financave tregtare, veçanërisht për të ndihmuar në periudhat e krizës financiare. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme nga vendet, organizmat ndërqeveritarë dhe të gjithë partnerët e interesuar në sektorit privat, për të eksploruar mënyra dhe mjete në mënyrë që të sigurohen burime të sigurta të përshtatshme dhe të parashikueshme të financave të tregtisë. Në veçanti në rrethana të jashtëzakonshme si krizat financiare (OBT, 2003, cituar nga Trade Finance and SME-s, 2016). Pavarësisht nga mësimet e krizës financiare aziatike, gjatë krizës financiare 2008-09 tregjet e financave të tregtisë ishin subjekt i rëndë i mungesës së likuiditetit për shkak të infektimit të krizave në segmentet e tjera të bankare, edhe pse G20 zbatoi një paketë prej US \$ 250 trillion (përfshirë US \$ 130 trilion për vende në zhvillimin) në formën e kredisë dhe garancive

tregtare dhe sigurime, situata nuk u kthye në normalitet deri në vitin 2012 dhe duket se është përkeqësuar në vendet e varfra për shkak të zvogëlimit të rrjetetve globale bankare (OBT, 2013, cituar nga Trade Finance and SME-s, 2016). Ky mesazh vazhdimisht është vënë në dukje nga ekspertët e financave të tregtisë, grupeve multilaterale, institucione dhe bankat e sektorit privat për trendet e vërejtura në tregjet e financave të tregtisë. (Trade Finance and SME-s, 2016)

Si u përmend edhe me lart një numër i konsiderueshëm institucionesh ndërkombetare janë të përfshira direkt ose indirekt në infrastrukturën e financave të tregtisë. Organizata të tjera të përfshira në nivel global janë: BIS, ICC, IMF, ITC, UNCTAD, UNICTRAL dhe Banka Botërore. Në nivel rajonal janë: ADB, EBRD, ESCAP.

Komiteti i Bazelit për Survejimin e Bankave (Basel Committee on Banking Supervision)¹.

Komiteti i Bazelit lëshoi një kornizë të rishikuar për konvergjencën ndërkombëtare të matjes të kapitalit dhe standardeve të kapitalit, i njohur zakonisht si Bazel II. Kjo kornizë është një rishikim i Marrëveshjes së Bazelit i vitit 1988 dhe ka për qëllim forcimin e mëtejshëm, qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit bankar ndërkombëtar. Bazel II përcakton një sërë kërkesash në fushën e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë që bankat duhet të plotësojnë.

Zbatimi i Bazel III sundon mbi kërkesat e kapitalit

Sistemi bankar në fillim të vitit 2008, nisi një krizë financiare që tronditi ekonominë globale. Si pasojë, Komiteti i Bazelit filloi një ri-vlerësimin të rregullave të saj. Në shtator të vitit 2010, komisioni ngriti një kuadër të ri të standardeve të forta nën Basel III. Rregullat e reja kanë për qëllim zbutjen e rrezikut të dështimeve të bankës duke kufizuar praktikat e sëmura dhe të pakujdesshme; Megjithatë, këto kanë disa implikime negative në financimin e tregtisë. Sipas rregullave të reja, bankat duhet të mbajnë rezervë të lartë të kapitalit ndaj

¹ <http://www.bis.org>

marrëveshjeve të financimit të tregtisë, i cili është shqetësimi më i madh i tyre. Raporti i propozuar do të kërkojë bankave për të vendosur mënjatë 100% të kapitalit për çdo instrumenti jashtë bilancit të tregtisë së financave, të tilla si L / Cs, e cila është pesë herë më shumë se raporti i konvertimit të kredive 20% që përdorej për financimin e tregtisë në Bazel II. Një sondazh jozyrtar nga Baft-IFSA ka zbuluar se Basel III mund të rrisë kostot e financave tregtare me 18-40%, e cila në fund të fundit do të kalojë për klientët e korporatave.

Ndikimi i Basel III në financimin e tregtisë: së pari, llogaritja e propozuar për raportin e levave kërkon 100% faktor konvertimi të kreditit për artikuj të caktuar jashtë bilancit, duke përfshirë gatishmërisë dhe tregtisë L/ Cs. Së dyti, Komiteti i Bazelit ka refuzuar propozimin për të ulur CCF 20% sipas Basel II të vetë-likuidimit L / Cs. Së treti, afati: Komiteti i Basel ofron një përjashtim nga maturimi gati një vjeçare në L/Cs, duke lejuar llogaritjen në pjekurinë efektive. *Produktet e tjera financiare të tregtisë mund të përjashtohen, në varësi të gjyqimit kombëtar.* Së katërti, masat e reja të likuiditetit nuk arrijnë të njohin instrumentet financiare të tregtisë si mjete likuide. Së pesti, vlera e aseteve të produkteve të financave tregtare (afatshkurtër, të vetë-likuidimit) nuk janë të ndara nga produktet e tjera të korporatave bankare (MENA Trade Finance, 2015).

2.2 Përkufizime të financave të tregtisë

Ka përkufizime të ndryshme për financat e tregtisë dhe zgjedhja e fjalëve të përdorura nga autorët që e studiojnë atë është interesante. Ajo është përshkruar edhe si një "shkencë" edhe si "një afat i papërcaktuar që mbulon një numër të aktiviteteve të ndryshme". Nga natyra e këtyre gjërave, të dyja janë të sakta. Nga njëra anë kjo është një shkencë mjaft e saktë në menaxhimin e kapitalit për tregtinë ndërkombëtare, ku ka një gamë mjetesësh në dispozicion të financuesve, të cilat përcaktojnë se si të hollat, kreditë, investimet dhe pasuri të tjera mund të shfrytëzohen për tregti.

Sipas Aleksander Malaket 2014, financat e tregtisë janë pak të kuptuara nga institucionet financiare dhe kritik për menaxhimin e rrezikut të tregtisë ndërkombëtare me instrumentat e

saj. Kohët e fundit kriza financiare globale ka vërtetuar, panvaresisht debatit të përdorimit të tyre, se institucionet financiare qeveritare dhe organizatat po i bëjnë të disponueshme për rimëkëmbien e ekonomisë. Gjithashtu kriza theksoi më shumë rreziqet të cilat egzistojnë, por i bënë ata që të kuptonin më shumë mbi rëndësinë e financave të tregtisë dhe mbrojtjes nga rreziku. Ai vë në dukje se lidhja e financave të tregtisë me tregtinë është e rëndësishme dhe anasjelltas. Sipas Malaket, 2014 ” Financat e tregtisë”, sidomos kur flitet për tregtinë ndërkombëtare, dhe përdorimi i instrumenteve të saj janë kombinimi i katër faktorëve: së pari, lehtësimi dhe sigurimi i pagesave në kohë; së dyti, sigurimi i financimit të blerësve, shitësve, bankave dhe anëtarëve të zinxhirit të vlerës të transaksioneve tregtare; së treti, zbutja e llojeve të rrezikut në kontekstin e tregtisë ndërkombëtare; së katërti, sigurimi i informacionit rreth transaksionit në lidhje me lëvizjen financiare.

Disa nga çështjet e mësipërme janë gjithnjë e më shumë në qendër të transaksioneve të brendshme dhe modeli i financimit të zinxhirit të ofertës mund të aplikohet për të dy llojet e bizneseve si lokale dhe biznes ndërkufitar. Informacioni mbi flukset tregtare, transaksionet dhe financat, është një fushë me fokus me theks në rritje ku ofrues të ndryshëm kërkojnë zgjidhje. Përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë është mënyra për të dalluar ofertat e tyre nga konkurrentët është një fakt që mund të provohet nga bizneset e të gjitha madhësive. Kombinimi optimal i katër faktorëve varion nga natyra e transaksionit ndërmjet blerësve dhe shitësve, tregut të përfshirë dhe produkteve që tregtojnë.

Disa mendojnë se financave të tregtisë është një produkt i vetëm financiar, por është më shumë se një produkt, janë disa në varësi të nevojës dhe kërkesave të blerësve dhe të shitësve. Për më shumë, produktet u përshtaten të gjitha llojeve të bizneseve dhe madhësive të tyre. Financat e tregtisë janë gjithnjë e më përsosje të instrumentave të saj duke iu përshtatur tregut global.

Nga pikëpamja e Anders Grath 2008, çështjet të cilat lidhen me tregtinë automatikisht lidhen edhe me financimin e saj, si: metodat e pagesës, menaxhimin të rrezikut, sigurimit, dhe infrastrukturën e nevojshme për të kryer transaksione ndërkombëtare. Ai e shikon çështjen në dy pikëpamje: nga pikëpamja e eksportuesit dhe nga pikëpamja e importuesit.

Nga pikëpamja e shitësit. Pse disa kompani eksportojnë me më sukses dhe me më shumë efektivitet se te tjerat? Sepse ato menxhojnë dhe mbulojnë edhe rreziqet më të mëdha të exportit. Vetëm atëherë ata mund të zënë një vend të mirë në treg ose të hyjnë në tregje të reja. Për t'ia arritur kësaj duhet të shesësh por duhet të sigurohesh që do të paguhesh.

Pse gjerat ndonjëherë shkojnë keq dhe eksportuesi nuk paguhet? Sepse shitësi shpesh nuk kupton plotësisht rrezikun që ndërmerr kur kryen transaksione ndërkombëtare dhe/ose nuk di se si ti menaxhojë këto rreziqe edhe nëse ka dijeni për to, madje dhe nuk di kujt dhe ku ti drejtohet.

Nga pikëpamja e importuesit. Të gjithë ata që paguajnë presin që produkti apo shërbimi i marrë të jetë i padëmtuar dhe i plotë. Por, si ka mundësi që disa importues e marrin porosinë e plotë dhe të padëmtuar dhe disa jo? Kjo ndodh sepse blerësit, si shitësit, nuk kuptojnë se si të menaxhojnë rrezikun.

Çelësi i suksesit në tregtinë ndërkombëtare sipas Garth 2008, është se “financat e tregtisë” nëpërmjet instrumenteve të saj, të cilat përshtaten për çdo situatë dhe nevojë të përdoruesit. Ai përmend disa rreziqe që ndërmeren gjatë tregtisë ndërkombëtare të cilat mund të menaxhohen ose minimizohen duke përdorur financat e tregtisë, si: rreziku i prodhimit dhe i transportit, rreziku komercial, rreziku politik, rreziku i biznesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku financiar.

Eric Bishop thotë se të gjithë ata që bëjnë biznes ndërmarrin rreziqe por tregtia brenda vendit është me pak e rrezikshme se tregtia ndërkombëtare. Kur tregton në një vend të huaj me partner të huaj dhe kultura të ndryshme rreziku kalon në një dimension tjetër. Kështu palët që marrin pjesë në transaksion duhet të menaxhojnë dhe minimizojnë rrezikun. Duke i dhënë një dimension ligjor çështjes. Bishop mendon se “financat e tregtisë”, të cilat tashmë janë rregulluar ndëkomtarisht dhe mbështetet nga disa organizata ndërkombëtare, e lehtëson tregtinë duke i siguruar eksportuesit se do të paguhet dhe importuesit se do të marrë porosinë e duhur pa dëmtime. Sigurisht institucioni më i rëndësishëm ndërmjetës është banka (banka e shitësit dhe banka e blerësit).

Sipas Oliver Wyman 2008, i quan produktet e financave të tregtisë shtyllën kurrizore të një ekonomie të globalizuar përderisa ata kryejnë transaksione ndërkombëtare për të siguruar kapital punues dhe minimizuar rrezikun e transaksioneve. Ai është fokusuar te theksimi i rëndësisë së financimit të tregtisë duke lënë pas tashmë globalizimin e modelit e biznesit të korporatave. Merita qëndron në tre faktorë: këto instrumente janë hartuar duke patur parasysh rreziqet e tregtisë ndërkombëtare, vlerësimi i mirë nga ana e bankave duke u fokusuar më shumë te rreziku i vendit. Autori thekson se pasiguria e klientit lidhur me situatën ekonomike të vendeve në krizë dhe pas krize bën që ai të përdori më shumë instrumentet e financave të tregtisë. Madje financat e tregtisë kanë arritur të ndryshojë modelet e biznesit kuke integruar pjemarrës të rinj si agjensitë e sigurimit të cilat bashkëpunojnë me bankat, pikat e grumbullimit, agjensi transporti, agjentë etj. sepse të mbrohesh nga rreziqet është gjithnjë shumë e nevojshme.

Të gjithë këta autorë mendojnë se avantazhi primar i financave të tregtisë është se lehtëson tregtinë dhe e zgjeron atë, duke i pajisur tregtarët me instrumenta që mbështesin dhe mbrojnë interesat e tyre duke menaxhuar rreziqet dhe rrjedhimisht duke rritur fitimet.

2.3. Ndryshimi ndërmjet huasë bankare dhe financave të tregtisë

Financat e tregtisë ndihmojnë për të financuar kostot e tregtisë, zakonisht kostot e importimit apo eksportimit të mallrave dhe kostot deri te klienti. Rritja e biznesit mund të shkaktojë vështirësi për të menaxhuar rritjen e kostove nga kompania. Kështu kompania për të arritur të përballojë kërkesën duhet të ruaj likuiditetin dhe menaxhojë rrezikun e humbjes së klientit e rrjedhimisht konsumatorit duke ruajtur, sigurisht, cilësinë (Sadie Keljikian dhe David Estrakh, 2017).

Shumë pronarë të biznesit që janë duke pritur për të marrë kredi bankare (tradicionale) për të plotësuar rrjedhjen tradicionale e tyre të të hollave, janë përballur me kërkesa të rrepta nga ana e bankave, kushtet të panegociueshme dhe kohë të gjatë aprovimi. Në fund të ditës, kreditë tradicionale mund të jenë një pengesë sesa një mjet për të ndihmuar.

Aplikimi për një kredi biznesi përfshin kërkesë të tepruar dokumentacioni, kohë të gjatë aprovimi, që do të thotë në përgjithësi fondet nuk arrijnë te biznesi menjëherë. Kreditë bazuar te bankat janë kreditit të biznesit tuaj, që do të thotë se çdo vështirësi financiare do të llogaritet mbi ju dhe pasurinë tuaj. Bankat tentojnë, të vetëdijshëm për rrezikun, të sigurojnë fonde vetëm kur pasuritë janë të bollshme dhe për këtë arsye rreziku për ta është i ulët. Financimi i bankave do të jetë i kufizuar, i papërkulur dhe e vështirë për të plotësuar nëse edhe të ardhurat tuaja periodike nuk plotësojnë dhe justifikojnë pagesat mujore.

Financat e tregtisë ndihmojnë tregtarët nëse kanë nevojë për kapital për të financuar operacionet shpejt dhe mund të përdorin mbështetjen financiare dhe logjistike gjatë gjithë zinxhirin e furnizimit tuaj. Financat e tregtisë janë ndryshe nga një kredi tradicionale, sepse fondet lëvrohen në bazë të transaksioneve të momentit, në vend të kreditit tuaj ose atë të biznesit tuaj. Fondet që lëvrohen janë të bazuara te faturat tuaja dhe urdhërat e blerjes. Pronarët nuk kanë nevojë të sigurohen për vite të tëra dhe të paguajnë për vite të tëra. Për më tepër, financat tregtare janë përshtatur që të rritet në lidhje me shitjet, nuk do të jetë e nevojshme për të aplikuar për linjë kredie. Financimi rritet në propocion të drejtë me urdhërat e blerjeve dhe shitjeve.

2.4. Rëndësia e financave të tregtisë

Vitet e fundit financat e tregtisë po i kushtohet vemëndje më e madhe për shkak të rëndësisë së saj në rritjen e flukseve tregtare dhe menaxhimin e rreziqeve për tregtarët.

Së pari, financat e tregtisë pakësojnë rrjedhjen e kapitalit, u mundëson financa kompanive që kanë nevoja për kapital dhe likuiditet, për të menaxhuar më mirë xhirimin e parasë, duke i lejuar të zgjerohen dhe të rriten. Së dyti, menaxhon rrezikun. Për post nevojave për kapital, tregtarët kanë nevojë edhe për support për të menaxhuar rrezikun që lidhet me transaksionet e tregtisë ndërkombëtare. Infrastruktura e financave të tregtisë të mundëson siguri dhe një numër opsionesh për të ulur rrezikun të lidhura me pagesat, luhatjen e kursit të këmbimit, shkëmbimet tregtare, rregullimi financiar dhe destabilizimi politik, etj. Së treti, rrit nivelin e konkureshmërisë. Kushtet e pagesës janë përdorur gjithnjë e më shumë

si mjete konkurrues gjatë negociimit të kontratës. Blerësit në përgjithësi do të favorizonin një kontratë që ofron siguri dhe bëhet tërheqëse në termat e kreditimit. Tregtarët me qasje në një rrjet të gjerë të mjeteve të financave të tregtisë dhe instrumenteve janë më të favorizuar. Ekzistojnë metoda të shumta të financave tregtare dhe instrumente për të mbështetur të gjithë tregtarët dhe ciklin tregtar.

Rëndësinë e financave të tregtisë në tregtinë ndërkombëtare e deri te rëndësia për një biznes të vetëm e kanë testuar shumë studiues kohët e fundit, të cilët kanë kontribuar në kuptimin më të mirë të saj.

Teorinë e ndajmë në tre pjesë ku janë punimet të cilat kanë përdorur informacion financiar nga sektorë të ndryshëm për të parë ndikimin e kushteve të financimit në flukset tregtare, punimet të cilat fokusohen mbi marrëdhënien e bankave dhe kompanive apo eksportuesve dhe punime të cilat përdorin produkte të caktuara ose grupe produktesh për të analizuar të dhënat e përdoruesve të financave të tregtisë (Clara Brandi and Birgit Schmitz , 2015).

Forma të tjera të rrezikut financiar janë : kur shitësi e gjykon gabim rreziqet e përfshira në transaksion ekspozohet me kushtet e pagesës që nuk mbulojnë gjendjen reale të rrezikut, apo hyn gabimisht në marrëveshje pa mbrojtjen e duhur të rrezikut. Është e vetëkuptueshme që ndërrthurrje të tilla mund të kenë pasoja të rënda financiare, nga vonesat në pagesa.

Rreziqet financiare në përgjithësi janë të lidhura ngushtë me strukturën e kushteve të pagesës. Siguria e kushteve të pagesës për palët që kanë rënë dakord, normalisht do të jetë e kushtueshme në qoftë se ata nuk përmbajnë siguri bankare, të tilla si një kredie ose një garancie bankare. Megjithatë, blerësi shpesh nuk është i përgatitur për të pranuar kosto më të larta dhe përdorimi i instrumentave të kreditit mund të shihen si kërkesa të te përtë nga shitësit, përfshirja në metodat e pagesave, e cila sipas mendimit të tyre janë praktika jo normale.

Përfundimisht, shitësi mund të duhet të pranojë kushtet e pagesës të ofruara dhe të përpiqet të mbulojë rreziqet e mbetura në ndonjë mënyrë tjetër, ose për të gjetur një kompromis.(Handbook of International Trade and Finance, 2008).

Por shumëllojshmëria e instrumentave të financave të tregtisë i përshtatet kushteve të gjithsecilit dhe marreveshjeve që palët duan të lidhin. Kuptohet se importuesi do të kërkojë të mbulojë rreziqet financiare, politike, të kursit të këmbimit, dhe eksportuesi rreziqet e mospagesës, transportit, magazinimit nëse është e nevojshme, të biznesit dhe të prodhimit.

Përdorimi i instrumentave të financave të tregtisë bëhet në varësi të marrëveshjes vlerës së kontratës, rrezikut të vendit ku po tregtohet madje edhe lloji i biznesit. Specialisti bankar duhet të këshillojë instrumentin e duhur sipas nevojës së tregtimit dhe llojit të rrezikut të cilin ata duhen të mbrohen. Nëse një tregtar Shqipëtar kërkon të eksportojë në shumicën e vende të OECD-së atij i duhet të mbrohet nga rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku i transportit apo i biznesi, nuk është e nevojshme të mbrohet nga rreziku i vendit (rreziku politik, ekonomik , stabilitet makroekonomik etj). Ndërsa një tregtari të vendeve të OECD që i duhet të eksportojë në Shqipëri atëherë ai duhet të mbrohet nga rreziku i vendit ndër të tjerave si: rreziku i mospagesës, i biznesit, politik etj.

Megjithë sa u thanë më lartë për rreziqet e prodoktit, prodhimit, informacioni, korrupsioni, rreziku politik, i mospagesës, i bleresit, etj, tregtarët duhet të njohin kulturën e bashkëpunëtorit. Pyetjes se si modelet e tregtisë ndërkombëtare ndryshojnë në varrësi të nivelit kulturor dhe se si kjo marrëdhënie zhvillohet me kalimin e kohës, studiuesit shprehen se dallimet në institucione informale, të tilla si tiparet kulturore, janë një pengesë e nënkuptuar për tregtinë sepse ato të krijojnë kosto në transaksione dhe shpenzime për informacionin. Logjika është se dallime të thella kulturore kanë një ndikim negativ në tregti. Nëse ky argument është i saktë, duhet të presim që njerëzit me tipare të ngjashme kulturore, por të vendosura në vende të ndryshme, duhet të tregtojnë shumë. Arsyeja pse dallimet kulturore ndikojnë negativisht tregtisë ndërkombëtare është besimi. Besimi është një komponent i rëndësishëm në përcaktimin marrëdhënieve ekonomike, duke përfshirë edhe marrëdhëniet tregtare. Dallimet kulturore kanë të ngjarë të jenë të lidhura me

institucionet e ndryshme formale dhe, gjërat e tjera janë të barabarta, për të dekurajuar ofshoring. Megjithatë, ndërsa në të dy listat marrëdhënia është negative, tregtia në mallra të ndërmjetëm duket të jetë më pak - në vendet që janë prekur më shumë nga diferencat kulturore. Vendet me largësi kulturore kanë më pak të ngjarë që të ketë institucione të ngjashme formale në zonat të tilla si të drejtat e pronësisë intelektuale apo të investimeve që janë thelbësore për zhvillimin e suksesshëm ndërkufitar të zinxhirit të vlerës.

Këtë argument e lehtëson përdorimi i instrumenteve të financave bankare. Përderisa bankat janë institucione ndërkombëtare dhe instrumentet e financave të tregtisë janë instrumente që lëshohen nga këto institucione, duke marrë vlerë ligjore, pa prekur pjesën kulturore apo fetare mund të rrisin flukset tregtare me vendet me diferenca të mëdha kulturore.

2.5. Llojet e instrumenteve të financave të tregtisë

Për të kuptuar ndikimin e financave të tregtisë në flukset tregtare fillimisht bizneset eksportuese dhe ato importuese duhet të njohin instrumentat e saj nënyrë që të kuptojnë si veprojnë ato dhe çfarë përfitimesh kanë ata nga këto lloj instrumentesh. Gjithashtu bizneset duhet të kuptojnë se cili instrument u nevojitet në faza të caktuara të biznesit. Duke njohur instrumentet, përdorimin, specifikat e cdo njërit do të jëtë më e kuptueshme edhe mënyra e ndikimit të disponueshmërisë së instrumentave të tregtisë në flukset tregtare dhe si rrjedhim menaxhimi i rrezikut të vendit për tregtarët.

Informimi mbi përdorimin, domethënë, kur përdoret një instrument, për çfarë situate është i rëndësishëm/nevojshëm, çfarë të mirash sjell? Ose, a është në gjendje banka me të cilën punoj të më mundësoj instrumentin e duhur për nevojat e mia? Ose, a jam në gjendje ta menaxhoj rrezikun deri në fund pa ndihmë, a më mjaftojnë fondet që kam në dispozicion, a i menaxhoj dot marrëdhëniet me bashkëpunëtorët, (sidomos kur janë bashkëpunëtor të rinj). Pasi janë kuptuar nevojat për financim është e nevojshme të kuptohet edhe koha për të cilën duhen ato. Ka burime informale dhe formale dhe kështu ju duhet të jeni në gjendje të kuptoni se cilat janë instrumentat e duhura dhe që i pershtatën nevojave tuaja. Një burim

mund të jenë bankat që tashme janë shumë të njohura, kreditimi i tregtisë si dhe grantet qeveritare. Ka gjithashtu një sërë instrumentash që financojnë biznesin, ku ju mund të mbështeten tregtarët.

Shkëmbimet ndërkombëtare janë logjikisht më të shtrenjta si nga komplikimi i operacioneve dhe mjedisit të ri si dhe ndërveprimi kulturor të cilat duhet të jenë efektive për të patur sukses. Këto konplikime gjenden në bashkepunimin me partneret, ndermjetesit financiare dhe mungesën e informacionit.

Në biznesin ndërkombëtar përfshihen parametrat makro sic janë destabiliteti politik, ekspozimi në rreziqet e huaja, konplikime që lidhen me logjistikën, transportin e mallrave në tregje të tjera. Ka edhe diferenca të tjera që variojnë nga lloji i tregjeve. Prandaj të gjithë këta faktorë duhet të mirë menaxhohen për të patur fitime positive.

Biznesi duhet të konsiderojë kursin e kembimit, dhe kjo varet se kush është bleresi dhe shitesi. Nëse ti je shitesi ose eksportuesi përfitimet e tua nga diferenca në kursin e kembimit (nëse paraja e vendit tend është e zhvlerësuar) vijnë nga që ti je më konkures duke ulur cmimin në krahasim me të tjerët. Si importues ti mund të përfitosh nga kjo sepse do të shpenzosh më pak për të njëjtin produkt. Të bëhesh pjesë e biznesit ndërkombëtar duhet të jesh kreativ, zhvillim dhe të mbash marrëdhënie dhe ti menaxhosh ato në distancë.

Të qenit në distancë ulë besueshmerinë dhe rrit rreziqet në biznes se sa rasti i të qenit ballë për ballë, si në transaksionet brenda vendit. Ndërsa teknologjia na ka lehtësuar disi të bërit business ballë për ballë një tjetër kujdes duhet ti kushtohet kulturës dhe prejardhjes së partnerëve dhe kulturës së tyre sepse shpesh herë ajo është edhe më e rëndësishme sesa të bërit biznes. Por këto cka u thanë duhet të integrohen, fillimisht, dhe të përshtaten në bizneset në zhvillim apo në tregjet e reja, pra komunikimi, teknologjia. Pra biznesi duhet të informohet në mënyrë që të përballojnë distancat në biznes.

Kujdes të vecantë duhet edhe nga ana ligjore, duhet të njihet legjislacioni dhe të hartohen marrëveshje të rregulluara nga ligji. Në tregtinë vendase kjo është më e thjeshtë dhe zgjidhjet bëhen sipas ligjit të vendit por në tregtinë ndërkombëtare zgjidhjet janë më të

komplikuara. Koha e një trasaksioni gjithashtu ndryshon. Në trasaksionet e brendëshme është më e shkurrtë sesa në transaksionet ndërkombëtare.

Edhe pse transaksionet ndërkombëtare tentojnë të jenë më të rrezikshme, ato kanë mundësinë të bashkëpunojnë me institucione të cilat janë të specializuara për tregtinë ndërkombëtare dhe shumica e rreziqet mund të menaxhohen dhe kontrollohen. Këto institucione mund të lehtësojnë biznesin ndërkombëtar. (How to Access Trade Finance, 2009)

Koha për të cilën i duhet një transaksioni ndërkombëtar të kryhet dhe koha deri në kryerjen e pagesës për të dy palët përbën rrezik. Kështu eksportuesi dëshiron të marrë pagesën para se porosia të mbërrijë dhe importuesi dëshiron të marrë porosinë dhe më pas të kryejë pagesën.

Për të tregtuar se vendet i kushtojnë rëndësi eksportit duhet të ofrojnë klienteve metoda atraktive pagese. Këto metoda duhen zgjedhur me kujdes në mënyrë që të minimizohet rreziku i mospagesës për transaksionet ndërkombëtare.

2.5.1.Cash -in -Advance (Parapagim)

Sipas kushteve të parapagimit, eksportuesi mund të marrë pagesën përpara se të mbërrijë porosia në destinacion. Kështu eliminon rrezikun e mospagesës që në fillim. Trasferrat bankare ose kartat e kreditit përdoren për këto lloje dokumentesh. Për importuesit Cash -in -Advance⁷ është një instrument pak atraktiv sepse metoda e paradhenies mund të shkaktojë

⁷ Shiko ITA, (2007) ,(2008) ,(2012) ;

Eric Bishop (2004) ;

IFC ,Global Trade Finance Program WTO (2011);

Malakiet(2014) (2015) ;

OPUS (March 2013) ;

World Bank, International trade payment method ;

United Nations and ITC (2005),

mungesë të likuiditetit dhe nuk është konkuresive për eksportuesin sidomos kur importuesi mund të zgjedhi një eksportues tjetër. Për blerësin është me rrezik sepse mendon se porosia nuk do të dërgohet nëse paguan parafutur.

Për këtë arsye, blerësi rrallë do të paguajë para në dorë në fillim para se të marrë një siguri se mallrat do të transportohen dhe se cilësia dhe sasia e mallrave e urdhëruar do të jetë dërguar. Edhe pse kjo metodë e pagesës nuk është e pazakontë, kur shitësi kërkon pagesa të plota paraprakisht mund të shkaktojë shitje të humbura për një të huaj ndaj konkurrentit i cili është në gjendje të ofrojë kushte më tërheqëse të pagesës. Në disa raste, megjithatë, ku procesi i prodhimit është i specializuar, i gjatë ose capital intensive, mund të jetë e arsyeshme për të kërkuar disa pagesa së plota paraprakisht, ose me pagesa progresive. Kjo metodë shpesh është shumë e shtrenjtë dhe e rrezikshme për blerësit e huaj, kur kredia e blerësit është e pakënaqshme, ose kur mallrat janë bërë me porosi sipas kërkesave të konsumatorit por kur eksportuesi e di se importuesi nuk mund ta zëvendësojë për një sërë arsyesh mund të kërkojnë pa frikë një Cash-in-Advance. Ky instrument gjithashtu është i përshtatshëm për porosi të vogla, kur është klient i ri (por ka rrezik konkurrence), rreziku i vendit dhe politik i vendit importues është i lartë, kur importuesi nuk mund ta zëvendësojë eksportuesin (sepse produkti nuk gjendet diku tjetër, është shumë larg dhe ka kosto të larta dhe do shumë kohë të mbërrijë, është produkt i personalizuar, si pikturë. Në disa raste kjo metodë e pagesës mund të ndryshohet për një parapagim të pjesshëm duke rënë dakord, me kështu apo kushte shtesë. Ky instrument mund të përdoret: Së pari, kur blerësit i mungon kreditimi. Së dyti, kur blerësi nuk është në gjendje të ofrojë siguri të mjaftueshme për pagesën. Së treti, kur blerësi është i vendosur në një rajon pa stabilitet ekonomik dhe politik. Së katërti, kur produkti është i specializuar është bërë posaçërisht për konsumatorët dhe nuk mund të shiten lehtë në një klient tjetër.

Të gjitha këto dokumente trutojnë instrumentet e financimit të tregtisë (shiko edhe: LatinTrade, 1999; . <http://www.tradeport.org>; . <http://internet.ggu.edu>, . <http://www.occ.gov/publications/>

2.5.2.Documentary Collections (Koleksionet dokumentar)

Documentary Collections (D/C)⁸ është një instrument ku eksportuesi ia beson mbledhjen e pagesës bankës së eksportuesit e cila dërgon dokumentat bankës së importuesit lidhur me të dhënat për pagesat. Kështu banka e importuesit dërgon pagesën sipas kushteve të banka e eksportuesit. D/C përfshin përdorimin e një fature e cila e detyron blerësin të paguajë edhe në një moment të dytë, datë të mëvonshme. Bashkë me D/C është një letër e cila jep të gjithë informacionin e transaksionit. Banka luan rolin e lehtëtësuesit (agjentit) për klientët e saj. D/C janë më të lira se Letër kreditë. D/C nuk i detyron importuesit të paguajnë para dërgesës. D/C mund të përdoret kur importuesit dhe eksportuesit kanë një marrëdhënie të mirë, pra e njohim mirë njëri-tjetrin. Eksportuesi e di se vendi është ekonomikisht dhe politikisht stabil ose në rastet kur importuesi nuk pranon një LC.

D/P (Documents against Payment Collection) eksportuesi para se të nis ngarkesën i dorëzon dokumentat bankës, e cila koordinon me bankën e importuesit dhe mënyrën si do të marrë paratë nga importuesi. Në këtë marrëveshje banka në bazë të dokumentave dërgon pagesën të banka e eksportuesit. Pra koha e pagesës është pasi dërgohet porosia por pas relizimit të dokumentave.

⁸ ITA, (2007) ,(2008) ,(2012)

Eric Bishop (2004)

IFC ,Global Trade Finance Program WTO (2011b)

Malaket(2014) (2015)

OPUS (March 2013)

World Bank, International trade payment method

United Nations and ITC (2005),

Të gjitha këto dokumente trartojnë instrumentet e financimit të tregtisë (shiko edhe: LatinTrade, 1999; . <http://www.tradeport.org>; . <http://internet.ggu.edu>, . <http://www.occ.gov/publications/>

D/A (Documents against Acceptance Collection) ky lloj dokumenti ka të përcaktuar një datë për pagesën kundrejt eksportuesit. Në momentin e pranimin nga importuesi, pagesa behët e ligjshme e detyruar sipas kushteve të përcaktuara.

Draft Documentary Collection është përdorur kur as parapagimi nuk është i pranueshëm për blerësin, apo as open account (llogari e hapur) nuk është e pranueshme për shitësin. Me Draft Documentary Collection, shitësi ose eksportuesi ngarkon mallrat dhe tërheq një projekt apo kambial përmes një banke ndërmjetëse. Drafti është një mënyrë për të bërë një pagesë në përputhje me kushtet e sigurisë. Dokumentet e nevojshme janë të specifikuar më parë me titullin për mallrat që po transferohen. Janë katër palë të përfshira në metodën e Documentary Collection: Blerësi, mbledhësja (banka e blerësit), shitësi dhe ridërguesi (banka e shitësit). Gjithashtu, ka katër hapa kryesore në Documentary Collection.

Në procesin e metodës Documentary Collection, para së gjithash, shitësi dërgon draftin në bankë. Banka ridërguese, si një ndërmjetës, dërgon projektin për mbledhjen e dokumentacionit; banka psezantuese, si një ndërmjetës, vë dokumentet në dispozicion të blerësit. Blerësi, pasi shqyrton dokumentet, ka tre opsione: për të paguar menjëherë; të paguajnë në të ardhmen; të refuzojnë të paguajnë për draftin. Kur drafti është paguar, dokumentet me titullin janë lëshuar për blerësit në mënyrë që ai / ajo mund të marrë në posedim mallrat. Kur titulli i mallrave është transferuar në draft, është paguar ose vetëm pranuar, edhe blerësi dhe shitësi janë të mbrojtur.

2.5.3.Open Account (Llogari e Hapur)

Me Open Account⁹ porosia dërgohet para pagesës, mesatarisht në 30, 60, 90 ditë. Kjo metodë është avantazhuese për importuesit si në xhirimin e parasë dhe në kosto, por është e rrezikshme për eksportuesit. Për shkak të konkurrencës së madhe në treg importuesit detyrojnë eksportuesit të përdorin këtë lloj dokumenti. Nëse eksportuesit nuk pranojnë kërkesat e importuesve mund të humbasë klientin. Me kushtet e open account eksportuesi duhet të ketë informacion për rrezikun politik, ekonomik të vendit importues si dhe diferencat kulturore në menyrë që të sigurohet për pagesën e porosisë. Në këtë mënyrë minimizohen rreziqet e transaksionit. Ky instrument ndihmon që eksportuesi të jetë më konkurrenues në treg duke pasur marrëdhënie më afatgjata me klientët e tyre. Open account mund të ofrohet më një ose me shumë teknika të tjera të financave të tregtisë : financimi i kapitalit të punës për eksport të (export working capital financing), programet qeveritare për kapitalin e punës për eksport (government-guaranteed export working capital programs), sigurimet e kredisë për eksport (export credit insurance), export factoring.

Një transaksion open account do të thotë se mallrat janë prodhuar dhe do të dërgohet para se pagesa të kryhet (për shembull, pagesa mund të behet për 14, 30, ose 60 dite pas dergesës ose shpërndarjes). Metoda siguron fleksibilitet, në shumë vende përdoret kjo metodë por më e mira është të përdoret kur bleresi dhe shitesi kanë krijuar një marrëdhënie të stabilizuar nëse nuk shoqërohet me një instrument tjetër.

⁹ ITA, (2007) ,(2008) ,(2012)

Eric Bishop (2004)

IFC ,Global Trade Finance Program WTO (2011b)

Malaket(2014) (2015)

OPUS (March 2013)

World Bank, International trade payment method

United Nations and ITC (2005), Të gjitha këto dokumente trartojnë instrumentet e financimit të tregtisë (shiko edhe: LatinTrade, 1999; . <http://www.tradeport.org>; . <http://internet.ggu.edu>, . <http://www.occ.gov/publications/>

Metoda open account është metoda e preferuar e pagesës për importuesin, pasi ajo zhvendos rrezikun te eksportuesi ose shitësit. Kjo metodë nuk mund të përdoret në mënyrë të sigurtë, nëse blerësi nuk është i denjë për të marrë kredi dhe vendi i destinacionit është politikisht dhe ekonomikisht i pa qëndrueshëm (këto janë informacione të cilat i disponon banka e importuesit).

Metoda e open account është e dobishme për blerësit pasi nuk është e rrezikshme për të.

Metoda open account mund të jetë e dobishme në qoftë se: ka marrëdhënie afat-gjatë; informacion të mjaftueshëm për të dhe besim në mes të blerësit dhe shitësit; shitësi është nën presion për të shitur pasurinë e tij; blerësi ka një reputacion shumë të mirë dhe është i njohur në treg; blerësi është i vetëm.

Të dy metodat e pagesës, të parapagim dhe open account, nuk janë të përshtatshme kur blerësi dhe shitësi nuk e njohin njëri-tjetrin shumë mirë ose shitësi nuk dëshiron të marrë përsipër rrezikun e kredisë ose rrezikun që kanë të bëjnë me një vend të veçantë duke ofruar kushtet e pagesës për blerësin.

2.5.4.Consignment (dorëzimi i porosisë)

Consignment¹⁰ është një version i open account në të cilën pagesa për eksportuesin bëhet vetëm kur mallrat e dërguara janë shitur nga shpërndarësi kryesor për te konsumatori

¹⁰ITA, (2007) ,(2008) ,(2012)

Eric Bishop (2004)

IFC ,Global Trade Finance Program WTO (2011b)

Malaket(2014) (2015)

OPUS (March 2013)

World Bank, International trade payment method

United Nations and ITC (2005),

Të gjitha këto dokumente tratojnë instrumentet e financimit të tregtisë (shiko edhe: LatinTrade, 1999; . <http://www.tradeport.org>; . <http://internet.ggu.edu>, . <http://www.occ.gov/publications/>

përfundimtar. Një transaksion ndërkombëtar me Consignment bazohet në një kontratë midis distributorit kryesor të huaj dhe eksportuesit ku distributori pret ngarkesën, e menaxhon, dhe i shet ato. Përdorimi më i gjërë i Consignment është për makineritë e rënda dhe pajisje sepse distributorët kanë nevojë për modele dhe inventar për të shitur. Mallrat e pashitur deri në kohën e përcaktuar në kontratë i rikthehen ekstortuesit. Për eksportuesit nuk ka garanci nëse do të paguhet dhe dikush tjetër posedon mallin e tij, por nën një kontratë të ligjshme. Për eksportuesit të cilët provojnë tregje të reja, klient të rinj apo janë në fillimet e tyre ky lloj instrumenti është avantazhues. Consignment është një instrument i cili ndihmon eksportuesin për të reduktuar kostot direkte për ruajtjen dhe menaxhimin e inventarit dhe shitjen e tyre me cmimin e tregut në konkurrencë të plotë. Eksportuesit duhet të kenë parasysh se marrëdhënia me një distributor me reputacion të mirë dhe të besueshëm dhe përdorimi i këtij instrumenti do të conte vecse në sukses.

Shitësi nuk merr pagesën deri sa importuesi shet ose rishet mallrat. Produkti qëndron me importuesit deri sa të gjithë kushtet e shitjes janë të plotësuar. Në metodën consignment, importuesi quhet marrësi dhe ai / ajo është përgjegjës për të paguar për mallrat, kur ata janë shitur. Avantazhet dhe rreziqet e Consignment janë disa: si, përparësi dhe rreziqet e të mbi pagesën e dërgesës metodë. Consignment është e dobishme në qoftë se: Marrësi është i besueshëm; Marrësi ka një histori të mirë në marrjen e kredisë; Vendi marrësit ka stabilitet ekonomik dhe politik; Marrësi është zyra e degës e kompanisë kryesore. (Informacione të tilla disponohen nga banka e importuesit)

2.5.5. Letter of credit (Leter kredi)

Letter of credit (LC)¹¹ është një nga instrumentet më të sigurta për tregtarët ndërkombëtarë. Një LC është një angazhim i bankës të zgjedhur nga importuesi, që sipas kushteve të

¹¹ ¹¹ ITA, (2007), (2008), (2012)

Eric Bishop (2004)

IFC, Global Trade Finance Program WTO (2011b)

përcaktuara në të garanton që pagesa do ti bëhet eksportuesit. LC është një instrument i cili përmban kushte të përcaktuara qartë në lidhje me transaksionin. Ky instrument mund të përdoret kur eksportuesi nuk njeh mirë gjendjen financiare të importuesit, por eksportuesi heq shqetësimin në momentin që ka nënshkruar një LC me bankën e importuesit. Por edhe importuesi është i mbrojtur për porosinë, sepse dokumenti i LC përmban informacion për porosinë për të cilën është dakord. Asnjë nga palët në një moment të dytë nuk mund të fshehin apo genjejnë për detyrimet ndaj njeri tjetrit. Pagesa behet pasi ngarkohet porisia. Është instrument i cili ka një cmim shërbimi i cili i paguhet bankës. LC bazohet në kontaktin e shitjes dhe përfshin gjithë informacionin e detajuar. Detyrimi i bankës për të paguar është vetëm kondicionuar mbi pajtueshmërinë me shitësit, me termat dhe kushtet e LC. Në transaksionet LC, bankat merren vetëm me dokumentet, jo mallrat. Një LC mund të përdoret për një transaksion të vetëm ose për një seri transaksionesh.

Letra e Kredisë ka qenë një gur themeli i tregtisë ndërkombëtare për shumë vjet. Ajo vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në tregtinë botërore sot. Me metoda të ndryshme alternative të pagesës në dispozicion të blerësit dhe shitësit të mallrave ose shërbimave. Pse është Letër Kredia metoda më e zakonshme e pagesës? Një përgjigje e thjeshtë mund të jetë se shitësi nuk do të dergojë pa sigurimin pagesën e një bankë. Letra e Kredisë ofron të tjera përparësi për blerësit dhe shitësit. Për çdo kompani që hyn në tregun ndërkombëtar Letër Kredia është një mekanizëm i rëndësishëm pagese që duhet të jetë kuptuar.

Një letër kredi është një dokument i lëshuar nga një bankë me kërkesë të blerësit në favor të shitësit; garanton se blerësi do të paguajë shumën e rënë dakord të parave tek shitësi

Malaket(2014) (2015)

OPUS (March 2013)

Të gjitha këto dokumente tratojnë instrumentet e financimit të tregtisë (shiko edhe: LatinTrade, 1999; .
<http://www.tradepoint.org>; . <http://internet.ggu.edu>, . <http://www.oec.org/publications/>

World Bank, International trade payment method

United Nations and ITC (2005),

brenda një periudhe të caktuar kohe, me kusht që shitësi të përputhet me specifikimet e produktit dhe kërkesat e dokumentit të blerësit¹².

Letra e kredisë është një mjet i specializuar, teknik që zbatohet kur paguhet për një dërgesë të mallrave ose shërbimeve nga një pale në palen tjetrën. Të dy aplikantët dhe përfituesit, përfitojnë nga të veçantat e një Letër Kredie. Megjithatë, të dy këto palë duhet të jenë të vetëdijshëm për atë që një Letër Credit nuk ka të bëjë me ofrimin e sigurisë të përgjithshme e pagesës për të gjithë. Një Letër Kredie garanton pagesën vetëm nëse termat dhe kushtet janë të kënaqshme për palët. Vlera e një garancie të tillë varet nga stabiliteti i bankës. Ajo nuk jep garanci se mallrat përshkruar në dokumentet e prezantimit janë dorëzuar. Bankat nuk kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet; ata merren me dokumente që kanë të bëjnë me Letrën e Credit. Sasia dhe cilësia e mallrave dërguar varet ndershmëria dhe integriteti i shitësit që ka prodhuar ose mallrat e paketuara dhe shpërndarë.

Blerësi mund të përcaktojë se Letra e Kredisë shoqërohet me certifikatat e testimit laboratorike, certifikatat e inspektimit ose dokumente të tjera që konfirmuar cilësinë apo sasinë e mallrave. Në përgjithësi, blerësi dhe shitësi bien dakord paraprakisht mbi të cilat pala është përgjegjëse për shumën e këtyre shërbimeve. Ndershmëria e shitësit dhe blerësit janë të lartë në ndonjë shkëmbim të mallrave ose shërbimeve pavarësisht nga metoda e pagesës.

Letra e kreditit do të shpjegojë saktësisht se si të përgatitatisësh draftin, se si duhet të jenë të përgatitur fatura komerciale, çfarë dokumentesh duhet të jenë përgatitur, të bashkangjitur me draftin e pagesës dhe afati. Shitësi duhet të ngarkojë mallrat dhe të paraqesi dokumentet për pagesën. Saktësia është shumë e rëndësishme. Historikisht, tregtarët kanë kërkuar mënyrat e pakësimit të këtyre dallimeve dhe zbutjen progresin të tregtisë. Mbrojtja dhe mundësitë e ofruara nga Letra e Credit vlejnë si për tregtinë vendase dhe ndërkombëtare. Palët e interesuara me një Letër Kredi janë përshkruar më poshtë:
Aplikuesi: Pala që organizon për Letër Kredi, zakonisht blerësi (importuesi) në një transaksion tregtar ose huamarrësi në një transaksion financiar; Përfituesi: Pala emëruar në

¹²<http://internet.ggu.edu>

Letrën e Kredisë në favor të të cilit Letër Kredia është lëshuar, ajo në përgjithësi është shitësi (eksportuesi) në një transaksion komercial ose kreditori në një transaksion financiar; Banka Lëshuese: Banka e parashtruesit që lëshon ndërmarrjen e saj të përfituesit në formën e një Letër Kredie; Banka Këshilluese: Banka, zakonisht në vendin e Përfituesit, i cili njofton Përfituesin që një bankë tjetër ka lëshuar një Letër Kredi në favorin e tyre.

Tabela 2: Krahësimi i instrumentave të financave të tregtisë, Burimi: World Bank
Përpunimi Autori

Metodat	Marrja e mallit	Ko e pagesës	Rreziku i eksportuesit	Rreziku i importuesit
Cash in Advance	Pas pagese	Para dergese	Shume i ulet	Mbeshtetje maksimale te eksportuesit per dërgimin e mallrave
Open account	Para pagese	Sipas marreveshjes	Mbeshtetje importuesit për të paguar ne llogari si marreveshja-merr rrezik të plotë	Shume i ulet
Consignment	Para pagese	pasi importuesi i ka perdorur apo shitur	Rrezik real për eksportuesin pervec se importuesi eshte I besueshem/njohur	Shume i ulet
Documentary Collection/ Collection/ Sight Draft /Documents against Payment	Pas pagese	Ne prezantim e draftit per importuesin.	Nëse drafti nuk eshte paguar, Mallrat duhet të kthehen ose konsiderohet humbje.	Pasiguri në cilesi dhe ne sasi nese malli nuk kontrollohet para dergeses.
Documentary Collection/ Time Draft/ Documents against Acceptance	Para pagese	Ne maturim te draftit	mbështetet sa më importuesi për të paguar draft	Minimumi mnd te shikojë dërgesen për sasinë dhe cilësi
Letter of Credit Confirmed Unconfirmed	Pas pagese	Kur dokumentat jane gati per transport	Shume i ulet	Sasia dhe cilesia jo e sigurt nese nuk inspektohet ngarkesa

2.2.6.Export Working Capital Financing (EWC)

EWC¹³ (financimi i kapitalit të punës për eksport) lejon eksportuesin të blejë mallra dhe shërbime për të mbështetur eksportin e produkteve. Ky instrument shërben për të ndihmuar sipermarrjet e vogla dhe të mesme për të pasur më shumë likuiditet për të kryer proceset e produktit deri në ekstort. EWC ndihmon eksportuesit të marrin hua për të plotësuar likuiditetin në momentin që presin për pagesën nga distributori i huaj (importuesi). Zakonisht këto hua përdoren për materiale, punëtorët, dhe inventare etj, por edhe për të rritur eksportet në rast të zgjerimit në tregje të tjera. EWC zakonisht sigurohet me asete, garanci personale apo dhe fatura që do të materializohen. Ndhmon në stabilizimin e problemeve me likuiditetin ndersa ato shiten në tregje globale.

2.5.7.Government-Guaranteed Export

Working Capital Loan Programs (Garancitë qeveritare për eksportin. Programet qeritare për huatë e kapitalit të punës.)

Këto lloj programesh hartohen enkas për të ndihmuar eksportuesit vendas kur mungon financimi privat ose gjysmë privat.

2.5.8.Export Credit Insurance (ECI)

ECI (Sigurimi i kreditit për eksportin) mbron eksportuesit nga rreziku i mospagimit nga bleresi i huaj. Me fjale të tjera redukton rrezikun e mospagimit të lidhur me të bërit biznes ndërkombëtar. Nese ai sigurohet se pagesa do të bëhet edhe pse eksportuesi nuk mund të

¹³ ITA, (2007) ,(2008) ,(2012) Eric Bishop (2004) IFC ,Global Trade Finance Program WTO (2011b)

Malaket(2014) (2015) OPUS (March 2013) World Bank, International trade payment method United Nations and ITC (2005),

paguajë. Sigurimi mbulon rrezikun e tregtimit dhe sigurisht rrezikun politik (luftë, terrorizëm, revolucion). Bankat specializohen për të shërbyer këtë lloj instrumenti për mbrojtjen e eksportuesit.

2.5.9.Eksport Factoring

Është¹⁴ një paketë e kompletuar e cila konbinon financimin për kapitalin e punës për eksport, mbrojtjen e kreditit, llogaritë e huaja arkëtueshme të kontabilitetit dhe shërbimet e grumbullimit. EF është një marrëveshje midis agentit dhe eksportuesit. Gjithashu agjenti merr përsipër rrezikun e mospagimit të eksportuesit. EF lejon eksportuesin të mbajë likuiditetin në normë, rrit konkurueshmërinë dhe 100% mbrojtje nga mospagimi.

2.5.10.Forfaiting

Është metodë që lejon eksportuesin të gjenerojë para nga shitja duke mos marrë rrezik përsipër. Agjentet i ofronë këto instrumente për eksportuesit që kanë projekte të medha dhe shesin shumë. Ata i financojnë keta eksportues në periudha nga 180 ditë në shtatë vjet. Këto instrumente janë të garantuara nga banka e importuesit e cila lejon eksportuesin të ruaj balancën e llogarisë (të mos ketë shpenzime). Forfaiting eliminon rrezikun e eksportuesit dhe financon 100% të kontratës me importuesin. Tre avantazhet kryesore të Forfaiting janë: Vellimi: mund të përdoret edhe vetëm për një transaksion të vetëm pa pasur një vazhdimësi në dërgësa; Aprovimi: mund të bëhet për disa orë ose dite në bazë të vendit pritës; Thjeshtësia: dokumentacioni zakonisht është e thjeshtë, konçiz, dhe i drejtpërdrejtë.

2.5.11.Asistencë qeveritare për të financuar blerësin e jashtëm

¹⁴ ITA, (2007) ,(2008) ,(2012) Eric Bishop (2004) IFC ,Global Trade Finance Program WTO (2011b)

Malaket(2014) (2015) OPUS (March 2013) World Bank, International trade payment method United Nations and ITC (2005),

Ky lloj financimi¹⁵ mundëson financim për blerësit e huaj me një interes fikse ose mundëson garanci për financimin nga huadhënës privat. Në mënyrë që vendi huadhënës të përfitojë në eksporte. Kjo bëhet nga qeveritë e vendeve për të përmirësuar eksportin e sipermarrjeve të vogla dhe të mesme në vendet në zhvillim.

2.5.12. Government-Backed Agricultural Export Financing

(Financim i qeverisë për eksportin e agriculturës)

Ndërtimi i një database të dhënash për hartën e prodhimit dhe menaxhimin e prodhimit duke e magazinuar në zona të afërta dhe transportuar në destinacionet e negociuara më parë. Kështu i jep mundësi fermerëve të eksportojnë dhe të fitojnë duke shtuar më tej eksportin.

2.5.13. E- Financa tregtare

Disa banka në botë kanë zhvilluar financat elektronik të tregtisë¹⁶. Ky sistem i mundëson gjithashtu dhe aplikimin për hua, përfshijnë kërkesat për kredi, të këmbimit valutor, letrat e kreditit, factoring, shërbimet të tjera kredie, sigurimit të mallrave dhe shërbimeve të tjera financiare të ofruara online.

Tani, bankat dhe institucionet financiare janë duke ofruar shërbime të reja në celular me synimin për të zgjeruar pikat e kontaktit të tyre të klientit përtej degëve. Motivimet e tyre janë të qarta: rritja sofistikimi për klientët e tyre, kosto relativisht më të ulët të blerjes të shërbimeve për konsumatorët dhe për të arritur një bazë më të gjerë të konsumatorëve në çdo kohë dhe kudo.

Shërbimet online të financave të tregtisë nuk janë të kufizuara për individë të pasur apo korporatat e mëdha. SME-të gjithashtu mund të përdorin këto shërbimeve online për shkak

¹⁵ ITA, (2007), (2008), (2012) Eric Bishop (2004) IFC, Global Trade Finance Program WTO (2011b)

Malak (2014) (2015) OPUS (March 2013) World Bank, International trade payment method United Nations and ITC (2005),

¹⁶ United Nations and ITC (2005),) Eric Bishop (2004)

të kostos relativisht të ulët të zbatimit. Në fakt, shumë nga shërbimet bankare online nuk kërkojnë pajisje të sofistikuara: një kompjuter i thjeshtë personal me një lidhje interneti mund të jetë e mjaftueshme.

Shërbimet online të financave të tregtisë dhe shërbimet financiare bazuar në Internet janë duke fituar gjithnjë e më shumë terren dhe me një ritëm të jashtëzakonshëm. Arsyeja është e thjeshtë: kur tregtarët pajisen me teknologji dhe informacion, kërkesa për shërbime financiare përkatëse rritet në përputhje me rrethanat.

Një sistem tipik i *shërbimit online të financave të tregtisë* përfshin: (a) Një model aplikimi: në një faqe web të ndërtuar enkas ku publikohen të gjitha instruksionet e nevojshme për importuesin dhe eksportuesin të cilat e ndihmojnë të kuptojnë për arritur të konkludojnë një transaksion. Në këtë faqe web duhet të mundësohen rregulla të biznesit dhe kontrollet, formularët, të drejtat etj. Në internet mund të miratohet pa nevojën për të dërguar informacionin më pas në sistemin bankar; ky sistem i lejon përdoruesit për të përcaktuar personat e autorizuar për të bërë dhe miratuar aplikacionet me anë të nënshkrimeve digjitale. Sistemi i *shërbimit online të financave të tregtisë* duhet të jetë fleksibël dhe i përshtatshëm ndaj kërkesave menaxheriale dhe financiare të kompanive individuale. Për shembull, disa kompani do të kërkojë vetëm një autorizues të miratojë transaksionin financiar, ndërsa kompanitë e tjera do kanë AUTORIZUES të ndryshëm në varësi nga sasia ose vlera e financiare e transaksionit; kjo veçori i mundëson përdoruesve për të ndjekur të gjitha aktivitetet e tyre bankare dhe të gjenerojë raporte dhe analiza. Analiza dhe raportimi janë të rëndësishme për të dy përdoruesit dhe bankën, ata mund të përdoret si një mjet efektiv për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me financat e tregtisë; përdoruesit zakonisht i jepet një kartë smart për të ruajtur në mënyrë dixhitale kopje të tyre të nënshkruara. Siguria mundësohet, zakonisht, përmes infrastrukturës publike kryesore (PKI aplikacion i cili mbron transaksionet tregtare nga interneti); sistemi i *shërbimit online të financave tregtare* duhet të jetë në gjendje të integrohen në sistemin zyrtar të kompanive më të mëdha, duke përfshirë edhe planet e tyre; planifikimit të burimeve dhe shkëmbimet e tyre ekzistuese.

TIK dhe interneti kanë potencialin për të reduktuar në masë të madhe shpenzimet e transaksioneve financiare dhe rrit shpejtësinë me të cilën dorëzohet shërbimet financiare. Disa nga përfitimet më të veçanta të *shërbimit online të financave të tregtisë* janë si më poshtë:

(a) Qasja më e lehtë në shërbimet financiare dhe informacionit: në përgjithësi, ndërmarrjet e mëdha kanë më shumë akses në financa me kushte konkurruese sesa ato më të vogla. Bankat dhe institucionet financiare nuk janë të prirura të shërbejnë SME-ve për arsye të tilla si mungesa e informacionit të kredive, nevojat e të vogla financiare dhe kostot e larta. SME-të në ekonomitë në zhvillim, përfaqësojnë pjesën më të madhe të kapaciteteve prodhuese në këto vende, ato përballen me një mungesë edhe më e rëndë e qasjes në financa. Megjithatë, e-financa mundëson bankat dhe institucionet tjera financiare për të ofruar kudo shërbimeve financiare, pavarësisht nga madhësia e klientëve të tyre, kostoja e operimit të sistemit është pothuajse fiks;

(b) Produkte të reja financiare: me *shërbimin online të financave të tregtisë*, bankat janë në një pozitë më të mirë për vlerësuar gjendjen financiare të klientëve të tyre. Nëpërmjet përdorimit të mjete të sofistikuar të dhënave, bankat mund krijojnë një profil më mirë të klientëve të tyre dhe kështu më mirë të menaxhojnë ekspozimin ndaj rrezikut. Si rezultat, bankat mund të zhvillojnë produkte më të sofistikuar financiare për klientët e ndryshëm me nivelet të ndryshme rreziku;

(c) Përmirësimi i saktësisë dhe shpejtësia e miratimit: shumica e sistemeve financiare e-tregtisë tani përdorin "përpunim drejt-përmas". Dikur vetëm procesi i regjistrimit të të dhënave eliminon nevojën për kontrollin e përsëritur të informacionit, duke reduktuar nevoja për gjetjen e gabimeve dhe më pas korrigjimin. Kjo ka reduktuar në mënyrë të konsiderueshme kohën mesatar të nevojshme për miratimin e dokumenteve financiare. Për shembull, një bankë në Singapor merr vetëm tre minuta për të të miratuar një kërkesë për L / C me anë të sistemit të saj të e- financa tregtare në krahasim me tre deri në pesë ditë kohë nëse aplikimi është i përpunuar në mënyrë tradicionale, përdorimi i formtit në letër;

(d) Integrimi i proceseve të financimit të tregtisë me sistemet e tjera tregtare: sistemet e *shërbimit online të financave të tregtisë*, nëse zhvillohen në bazë të standardeve globale, mund të integrohen lehtësisht me sistemet e tjera tregtare. Për shembull, sistemi i *shërbimit online të financave të tregtisë* i një banke mund të integrohet në sistemin elektronik të dokumentacionit tregtar të vendit, duke rezultuar në një nga praktikat më të shpejta dhe me një cikël më të shkurtër të biznesit;

(e) "Çdo herë dhe kudo": në vendet me norma të zhvilluara të telekomunikacionit, konsumatorët mund të aplikojnë kudo që janë dhe në çdo kohë;

(f) Barrierat e ulëta në hyrje: kostoja e krijimit të një sistemi bankar në internet është përgjithësisht shumë më e ulët se sa kostoja e krijimit të një lidhjeje fizike në deget e bankes. Në vendet ku ka kufizime në numrin e njësive të degëve që një bankë mund të ketë, e-banking do të bëjë këtë kufizim të paefektshme, si çdo kompjuter personal me një lidhje interneti mund të bëhet një "degë" virtuale. Barrierat e ulëta në hyrje, ndërkohë që sigurisht kërkojnë që qeveritë të zhvillojnë rregullore të reja dhe mekanizma të mbikëqyrjes, kështu mund të ulen kostot dhe përmirësohet aksesimi për të tregtuar shërbimet financiare.

Modelet e e-financave tregtare

Ndërsa *shërbimet online të financave të tregtisë* (United Nations and ITC, 2005), janë dhënë vetëm nga bankat dhe institucionet financiare, janë hartuar shumë modele të ndryshme. Disa banka kanë vendosur të ruajnë kompetencat e tyre bazë, duke siguruar e-financa tregtare. Megjithatë, disa kanë bashkëpunuar me operatorët e-tregtise për të integruar shërbimet e tyre financiare me ato ndërkombetare. Disa banka kanë shkuar edhe më tej kompetencave të tyre bazë duke krijuar vetë tregje virtuale për të siguruar një shërbim të integruar për klientët e tyre.

Shërbimi pavarur e-banking. Modeli i pavarur i shërbimit e-banking i referohet rastit të shërbimeve financiare bankare dhe produkteve si pjesë e një shërbimi më të madh e-bankar për klientët e korporatave. Konsumatori i bankës do të duhet të përdorni faqen e internetit të bankës për të aplikuar për shërbimet e ofruara.

E-tregu me e-banking. Disa banka kanë integruar shërbimin e tyre bankar në internet për ofruesit e e-tregut. Përparësia e këtij modeli është se kompanitë tani nuk kanë nevojë të kalojnë nëpër një proces të veçantë login me bankën, pasi i kryejnë transaksionet e biznesit në e-treg. Tregtia dhe Informacioni bankar mund të konsolidohen dhe të shihet në një platformë të vetme që ofron menaxhim më të mirë të informacionit dhe transparencë më të madhe. Çështjet kryesore këtu do të kenë mbrojtje të konfidencialitetit të informacionit bankar të klientëve. Masa të mjaftueshme të sigurisë duhet të zbatohet për të parandaluar zbulimin e paautorizuar të informacionit bankar. Standard Chartered Bank ka krijuar një platformë tregtare të quajtur B2BeX(www.scb2bex.com). Ndryshe nga shumë platforma të tjera bankare, B2BeX është një sistem ambicioz projektuar për të menaxhuar çdo aspekt të procesit të tregtisë. Blerësit mund të kërkojnë për produkte online, porosi, dokumentet e procesit, të koordinojë logjistikën, të negociojnë e sigurojnë dhe të koordinojë financimin. Sistemi i jep përdoruesve mundësinë për të zgjedhur vetëm një ose disa shërbimeve në dispozicion. Vendorsja e importuesit dhe eksportuesit në të njëjtën platform i bënë ata edhe më konkurrues dhe efikas, sipas bankës, e cila pretendon se kompanitë që përdorin platformën kanë fituar 25 deri në 50 për qind në efikasitet, në dokumenta dhe administrimin e tyre.

Ndërsa *shërbimet online të financave të tregtisë* (United Nations and ITC, 2005), ndihmojnë për të përshpejtuar financimit për kompanitë, ata nuk ofrojnë një zgjidhje të përgjithshme për eksportuesit ose importuesit. Disa ofrues të shërbimeve janë përpjekur për të zhvilluar portaleve globale tregtare që do të lejonin të gjitha aspektet e një transaksioni tregtar (p.sh., financiare, logjistike dhe madje edhe aspektet rregullatore) të menaxhohet nga një platformë të vetme online me pak ose aspak nevojë për tu bazuar në letra. Tre platforma të tilla globale janë përshkruar shkurtimisht më poshtë:

(A) KartaTregtare(Trade Card): Kartat Tregtare automatizojnë transaksionet tregtare nga prokurimi përmes pagesave. Karta Tregtare ofron dokumenta dhe financim sipas kërkesave të një transaksioni të tregtisë së brendshme ose ndërkombëtare me lëvizja fizike e mallrave, duke eliminuar kohë. Sistemi lejon një blerës që të lidhi qarkullimin fizike të mallrave me rrjedhën e fondeve elektronike me të njëjtën dokument elektronik. Karta tregtare përpiket

të sigurojë një shërbim me kosto efektive, praktike dhe menaxhimin të financave të zinxhirit të ofertes. Përveç financave dhe shërbimeve të logistikës, karta tregtare gjithashtu ofron shërbime të integruara të inspektimit. Është raportuar një rritje 230 për qind në vëllimin e biznesit në mes të 2003 dhe 2004¹⁷.

(B) Bolero: Bolero¹⁸.net është një platformë globale neutrale, zotërohet bashkërisht nga SWIFT, dhe Through Transport Club, i cili siguron sigurime për një numër portesh dhe terminale. Iniciativa e Bolero trajton një boshllëk të automatizimit të financave në zonën e tregtisë, çështjen e sigurisë dhe të legalizimit¹⁹.

(C) GlobalTrade Corporation (GTC): GTC është një ofrues i shërbimit financiar ku përfshin institucionet e tregtisë ndërkombëtare tregtimit. Shërbimet e kompanisë Transaksionet tregtare janë kryer duke përdorur kredi dokumentare, letra krediti, koleksioneve dokumentare, llogaritë e hapura dhe të holla. Përdoruesit janë në gjendje për të kryer biznesin e tyre në internet, duke maksimizuar kreditin e disponueshëm, duke ulur tarifat e transaksionit dhe në mënyrë dramatike thjeshtimi gjithë aspekte të procesit, duke përfshirë lëshimin e dokumenteve dhe ndjekja e progresit të transaksionit. Kompania filloi platformën e saj @GlobalTrade në vitin 2002 dhe ka ndërtuar partneritet strategjik me Adobe, Cap Gemini Ernest & Iri, SITPRO dhe Visa International. Duke mbajtur rregullat ekzistuese dhe praktikën bankare për të cilat komuniteti tregtimit është mësuar, ai u përpoq për të krijuar versione të thjeshta elektronike të një letër kredie për të përmirësuar rrjedhjen e dokumenteve elektronike që bëhet në tregti²⁰.

2.6. Pëmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull u trajtua pjesa teorike e financave tregtare. Përgjatë kapitullit u trajtua tregtia ndërkombëtare dhe financimi i saj, përkufizime të financave të tregtisë dhe ndrryshimi ndërmjet huasë bankare dhe financave të tregtisë. Gjithashtu u tregua rëndësia e

¹⁷ <http://www.tradecard.com>

¹⁸ Eric Bishop (2010) United Nations and ITC (2005)

¹⁹ <http://www.bolero.net>

²⁰ <http://www.globaltradecorp.com>

financave të tregtisë në tregti dhe rëndësia e financave të tregtisë në menaxhimin e rrezikut, duke u mbështetur në një literaturë të gjerë dhe autorë të ndrryshëm që kanë studiuar çështjen. Në fund kapitulli bën një përshkrim të llojeve të instrumenteve për financave tregtare. Në kapitullin në vijim do të evidentohen nga teoria faktorët që kushtëzojnë zhvillimin e financimin e tregtisë dhe aktorët kryesorë të saj. Gjithashtu, do të trajtohet dhe evidentohet indeksi i matjes së financave tregtare si pjesë e indeksit të lehtësimit të tregtisë.

KAPITULLI III: FAKTORËT QË KUSHTËZOJNË FINANCAT E TREGTISË

Firmat e angazhuara në tregtinë ndërkombëtare përballen me rreziqe që në tregtinë e brendshme janë pak ose aspak të pranishme. Të gjitha firmat e vogla apo të mëdha shoqërohen me rreziqe gjatë “jetës” së tyre por kur tregtojnë ndërkombëtarisht rreziku merr një dimension tjetër krahasuar me tregtimin brenda vendit, duke përfshirë rrezikun e tregtimit, rrezikun politik, rrezikun e shkëmbimit valuator, rrezikun e vendit, rreziku nga lufta etj. Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare dhe garantimin e pagesave duke reduktuar rrezikun e transaksioneve. Duke kontrolluar rrezikun tregtarët Shqiptarë mund të zgjerojnë eksportet në tregje të reja dhe kjo mund të bëhet shumë fitimprurese. Përdorimi i instrumenteve financiarë të financave të tregtisë dhe reduktimi i rrezikut në firmat Shqipëtare do të jetë një avantazh dhe një mundësi në biznes.

Për të pasur një marrëdhënie të suksesshme ndërmjet bankave dhe biznesit duhet një mjedis makroekonomik i përshtatshëm që lidhet me institucionet dhe ligjet. Infrastruktura e përshtatshme për përdorimin e instrumentave financiarë lidhet me tre aktivitete: *nevojën për kapital të firmave që janë të angazhuara në tregtinë ndërkombëtare, nevojën për shërbime dhe support në rrezikun e ndërmarrë në transaksione, dhe nevojën për një mekanizëm pagesash ndërkombëtare*. Të treja këto aktivitete janë të lidhura me performancën e *institucioneve financiare: banka, kompani sigurimesh etj.*

Lind pyetja: cilët janë faktorët që ndikojnë dhe kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë?

Është e ditur se tregtia ndërkombëtare është një mekanizëm i mirë i rritjes në shumë vende në tranzicion dhe në ekonomitë në zhvillim. Për të praktikuar tregtinë ndërkombëtare me efikasitet duhet një politikë monetare, politikë bankare, regjim financiar e fiskal transparentë dhe një treg funksional të sigurimit. Vendi duhet të inkurajojë investimet e huaja. Nevoja më e madhe për biznesin në këto ekonomi ka qënë gjithnjë financimi, kostot e transportit dhe sigurimi.

Duke thënë këto kuptojmë dhe rëndësinë e instrumenteve të Financave të Tregtisë.

Meqënëse instrumentet financiare ofrohen nga institucionet financiare domethënë se, është e lidhur ngushtë me sistemin financiar. Si rrjedhim kuptojmë se një mjedis makroekonomik i qëndrueshëm është një factor i rëndësishëm i zhvillimit të financave të tregtisë shoqëruar edhe me një politikë të hapur ekonomike.

Nga teoria dihet se mjedisi makroekonomik ndikon zhvillimin Financave të Tregtisë e nëpërmjet disa elementeve: situates së tregtisë, burimeve, borxhet e jashtme dhe likuiditeti, politika e kursit të këmbimit, sistemi monetar dhe sistemi financiar, tregu i kreditimit, mjedisi ligjor dhe rreziku i vendit. Funksionimi jo i mirë i këtyre elementeve bën që institucionet financiare të mos funksionojnë mirë, kapitali dhe kreditë të tkurren dhe kostot e borxhit të rriten (UNCTAD/WTO 2005).

Situata e tregtisë rrit orientimin për performancë më të mirë në eksporte të cilat ndihmojnë zhvillimin afatgjatë të Financave të Tregtisë. Sasia e flukseve tregtare është një tregues i mirë i nivelit të nevojës për instrumentet e Financave të Tregtisë. Duke rritur orjentimin e eksporteve dhe të flukseve tregtare në afatgjatë krijohet një mjedis i përshtatshëm për zhvillimin e Financave të Tregtisë.

Ndryshimet demografike vazhdojnë ti japin formë tregtisë ndërkombëtare, emigrimi pjesëmarrja në rritje e grave në forcën punëtore dhe ndryshimet në edukim bëjnë që demografia të vazhdojë të jetë një avantazh konkurues për vendet (Trade Report, 2013). Në disa vende numri i njerëzve në gjendje pune rritet dhe në disa vende ulet. Kështu dhe sasia dhe kërkesa dhe lloji i importeve ndryshon, duke shkaktuar efekte të ndryshme në flukset tregtare. Disa vende ndërmarrin politika për të angazhuar të gjithë forcën punëtore duke u dhënë aftësitë e duhura, në prodhim, shërbim etj. Vendet hartojnë politika në favor të forcës punëtore në lidhje me taksimin dhe aplikojnë përkrahje sociale, duke mbrojtur avantazhin e vendit dhe tregtinë gjithashtu. Edukimi i punëtorëve dhe cilesia e sistemit arsimor do ti lejojë vendet të integrohen lehtësisht në zinxhirin global të ofertës dhe të rrisi sofistikimin e eksporteve të tyre.

Gjithashtu teknologjia, kostot e transportit dhe tregtia. Transferimi i teknologjisë është i lartë kur vendi ka transaksione të larta ndërkombëtare dhe ndryshimi i saj bëhet në përputhje me kërkesat dhe nevojat e klientëve ndërkombëtarë. Pra zhvillimi i teknologjik në rastin e një vendi të hapur është më i shpejtë, të cilat duhet të ecin paralel me një forcë punëtore të trajnuar. Kostot e transportit (World Trade Report, 2013) janë ulur gradualisht ndër vite negociatash për uljen e tarifave nga Gatt që tani është WTO. Ulja e kostove të transportit bën të mundur që edhe produkte të cilat nuk janë transportuar në masë më parë të fillojnë të transportohen. Faktorë që influencojnë më shumë kostot e transportit janë karakteristikat e produktit, infrastruktura, konkurenca e tregut, *gjeografia*, ndryshimi i teknologjisë, lehtësitë në tregti dhe kosto e karburantit. Për ndikimin e konkurenca e tregut, ndryshimi i teknologjisë, infrastruktura në tregti është folur më parë në punim.

Një tregues i rëndësishëm është edhe distanca gjeografike, Çumani (2013) në punimin e saj tregon me anë të modelit të gravitetit për Shqipërinë se distanca e ndikon negativisht tregtinë. Nëse distanca rritet një përqind importet reale ulen, -0.0026%, dhe po për një rritje një përqind të distancës eksportet reale ulen, -0.0017%. Kjo nënkupton se distanca të mëdha rrisin kostot në transportit.

Kuptimi i kostove të tregtisë është e domosdoshme, me qëllim që ndërhyrjet politike për të reduktuar shpenzimet të jenë efektive. Komiteti tregtisë OECD ka ofruar njohuri në faktorët e kostos në të gjithë zinxhirin e tregtisë, dmth jo vetëm kur mallrat dhe shërbimet janë para kalimit të kufijve, gjatë kalimit të mallrave e shërbimeve në kufi për eksport dhe nga kufiri për import (Evdokia Moïse and Florian Le Bris, 2013).

Në kufij, i është vënë theksi i kostove të gjeneruara nga procedurat dhe rregulloret e doganave dhe agjencive të tjera kufitare. Nga vlerësimi rezulton se një ulje e kostos kufitare me 1% të vlerës së tregtisë botërore do të gjenerojë përfitime të mirëqenies e rreth 40 miliardë dollarë në mbarë botën, këto fitimeve u intesojnë shumë vendeve në zhvillim (OECD-së, 2009).

Shpenzimet indirekte që mbulojnë të gjitha vonesat procedurale në doganë, të shoqëruara me inventar dhe kosto oportune për firmat tregtare, llogaritet të shkojnë mes 1-24% të

vlerës së mallrave të tregtuara, janë kontribuesit më të mëdhenj të reduktimit të kostove në kufi, pasi ata kryesisht kontribuojnë në fitimet e pastra dhe në efikasitet. Kostot e fshehura, të tilla si kontrabanda, tregtia joformale, ryshfetit dhe korrupsionit në kufi kontribuojë në humbjen e mbledhjes së taksave doganore, e cila nganjëherë mund të kalojë 5% të PBB-së në vendet në zhvillim (Evdokia Moïse dhe Florian Le Bris, 2013). Kostot e zbatimit duhen kufizuar dhe të kompensohen shpejt nga fitimet e rëndësishme afat-gjatë, produktivitet, të ardhurat publike dhe konkurrueshmërinë e eksporteve për të dy agjentët publikë dhe privatë.

Kostot e tregtisë pas-kufirit janë shqetësim për eksportuesit apo për importuesit për rregulloret e brendshme, rajonal ose ndërkombëtarë dhe standardet për mallra dhe shërbime, ndikimet e cilave mund të jenë thelbësore për mirëqenien dhe tregtinë. Përveç masave jotarifore, studimet e OECD kanë theksuar edhe potencialin e fortë të masave të transparencës dhe përmirësime në mjedisin e biznesit të cilat ndikojnë në uljen e pengesave të tregtisë, (me një kosto të ulët të veçantë të zbatimit). Roli zgjerimin të informacionit dhe teknologjive të komunikimit (TIK), **ndërmjetësimi financiar**, shpërndarjen dhe shërbimet e biznesit në botë, produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, integritit dhe industrinë e prodhimit "i kanë bërë shërbimet një komponent të plotë të përkufizimeve moderne të kostove të tregtisë dhe politikave lehtësuese tregtare.

Shkaqe themelore të shpenzimeve tregtare ka në të gjitha fazat e tregtisë ndërkombëtare. Shumë kosto në tregtisë lindin si pasojë pasigurisë, ose, në të kundërtën, besueshmërinë dhe parashikueshmëri në ofrim: politikëbërësit në këtë mënyrë duhet ti adresojnë ato në një mënyrë gjithëpërfshirëse. Politikat për të trajtuar kostot dhe lehtësuar tregtinë duhet të mendohet në një mënyrë tërësore.

Disponueshmëria e fondeve; fondet e jashme shihen si faktor i mirë për zhvillimin e Financave të Tregtisë. Kur niveli i borxheve të jashme zhgjerohet atëherë dhe financimi vihet në dyshim. Këto flukse gjenerojnë investime të huaja, portofole investimi apo grante. Përderisa investimet e huaja mundësojnë transferimin e teknologjive të reja dhe rrisin konkurrueshmërinë janë fitimprurese në ekonomi.

Investimet në infrastrukturë mund të rezultojnë në nevoja për pjesëmarrës të tjerë në tregti. Kjo mund të jetë shumë e rëndësishme për vende të cilat kanë një ekonomi të vogël dhe nuk janë integruar akoma mirë në tregun global. Investimet në infrastukturë (World Trade Report, 2013) do e lejonin biznesin të merrnin shërbime nga jashtë apo nga intitucione të tjera të cilat janë jashtë vendit apo kompanisë së tyre (outsourcing). Qeveritë e këtyre vendeve duhet të fokusohen në krijimin e një infrastukture të tillë duke filluar nga institucionet e saj në shërbim të biznesit dhe tregtisë. Alternimi taksave bën të mundur që kursimet e biznesit të rriten në mënyrë që të rritet dhe tregtia. Kështu taksimi, politikat makroekonomike dhe shpërndarja e barabartë e investimit në infrastrukturë është e rëndësishme. Qeveritë gjithashtu mund të ndihmojnë investimet e huaja duke bërë vendin më atraktiv dhe mund të nxisi bankat të përdorin instrumenta të ndryshme financimi në ndihmë të tregtisë. Kështu këto vende mund të rrisin ofertën e tyre në tregun global. Vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion duhet të fokusohen në ndërtimin e një infrastrukturë të mirëfilltë bankare duke krijuar mundësinë e biznesit dhe tregtisë të rriten duke i financuar duke i venë në dispozicion instrumenta të specializuara të cilat jo vetëm rrisin dhe ndihmojnë por mbrojnë biznesin nga rreziqe të ndryshme dhe gjithashtu mbrojnë dhe interesat e investitoreve.

Efekte indirekte mbi disponueshmërinë e Financave të Tregtisë dhe zhvillimit të saj, ka gjithashtu **borxhi i jashtëm dhe likuiditeti** (UNCTAD/WTO, 2005). Sa më i lartë niveli i borxhit, më të larta në të ardhmen pagesat e shërbimeve të borxhit si rrjedhim shterim në financat e brendshme (pagesat e shërbimeve të borxhit janë flukset vjetore për të mbuluar pagesat e interesit dhe principalit). Një nivel i ulët i likuiditetit kufizon aftësinë e një vendi për të importuar mallra dhe shërbime. Luhatjet do të ndikojnë politikën monetare për shkak se borxhi i jashtëm është i shprehur në monedhë të huaj. Vlera e monedhës vëndase zhvlerësohet dhe një krizë financiare mund të afrojë.

Financave të tregtisë ndikohet nga regjimet e **kursit të këmbimit** valutor (UNCTAD/WTO, 2005). Politikat monetare dhe fiskale ndikohen nga ndjeshmëria e biznesit, nga politikat e kursit të këmbimit dhe luhatshmërisë së kursit të këmbimit. Në të njëjtën kohë kërkohen rezerva valutore për pagesa ndërkombëtare. Qeveritë mund të

ndikojnë në lehtësimin e pagesave ndërkombëtare. Qeveritë mund të hedhin një objektiv në kursin e këmbimit për të lehtësuar transaksionet ndërkombëtare. Kursi i këmbimit fleksibël mund të jetë më i favorshëm për zhvillimin afatgjatë të një infrastrukture të financave të tregtisë. Gjithashtu, efekte të tërthorta pozitive kanë akumulimi dhe mirëmbajtja e rezervave të mëdha valutore.

Sistemi monetar dhe ai financiar janë treguesit që shprehin nivelin e zhvillimit financiar. Ato tregojnë masën në të cilën transaksionet bankare janë më të rëndësishme se transaksionet në “kesh” dhe në masën të cilën sistemi bankar është i pranishëm në ekonomi. Të dy treguesit e mëposhtëm përdoren për vlerësimin e zhvillimit financiar:

Thellimi financiar (masa e thjeshtë e thellimit financiar është për të parë nivelin e parasë së gjerë (quasi money and narrow money) në krahasim me GDP. Ai mat shkallën e monetarizimit të ekonomisë. *Narrow money* përfaqëson paranë, ajo do të tregojë nivelin transaksioneve të zhvilluara në ekonomi sasinë e transaksioneve financiare që kryen vendi, nëpërmjet ndërmjetësve. Nëse sasia e transaksioneve financiare që kryen vendi rritet, rritet eedhe dhe përdorimi i instrumenteve të Financave të Tregtisë. Evolucionin e normës reale të interesit. Kur sistemi bankar është i besueshëm për të tërhequr e rritur nivelin e depozitave të kursimit kjo përfaqëson një shenjë e shëndetit financiar. Këto kanë një efekt pozitiv mbi disponueshmërinë dhe zhvillimin e financave të tregtisë.

Zvogëlimi sasinë e fondeve në dispozicion për menaxhimin e financave e tregtisë nga qeverisja publike e financave mund të jetë e dëmshme për normat e interesit. Në të vërtetë, një deficit i gjerë (kur të ardhurat nuk mbulojnë shpenzimet) mund të mbulohet nga shtypja e parave (seignorage është pjesa që ul vlerën reale të borxhit të brendshëm publik duke ngritur inflacionin) ose me shitjen e bonove qeveritare. Në të tilla raste politika monetare e shtrënguar (UNCTAD/WTO, 2005) konsiderohet në përgjithësi një prioritet, sepse deficitet qeveritare mbledhin kursimet private që të financojnë deficitin, duke lënë pak hapësirë për përdorimin e instrumenteve të financave të tregtisë. Perceptimi i gjendjes financiare të vendit nga pikëpamja e tregjeve ndërkombëtare mund të ketë ndikim shumë konkret në zhvillimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve financave të tregtisë. Për shembull,

Standard dhe Poor-së dhe Moody, dy agjenci ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë të bazuar në Shtetet e Bashkuara, sugjeron një rrezik të lartë në detyrimet e borxhit të qeverisë, i cili ka ndikime të forta në kursin e këmbimit. Kjo e bën huamarrjen e eksportuesit më të shtrenjtë, interesi do të rritet, dhe një zhvlerësim i mëvonshëm i monedhës do të ketë efektin e rritjes së shlyerjes së borxhit të huaj për kompanitë private dhe publike.

Një sistem i **plotë juridik** është i nevojshëm për zhvillimin e një shumëllojshmërie shërbimesh të financave të tregtisë (p.sh., leasing-ut). Liberalizimi jo i kujdesshëm (UNCTAD/WTO, 2005). mund të jetë e dëmshëm për ekonominë në këtë mënyrë që kuadri ligjor për kompanitë dhe bankat duhet të jetë i qartë dhe i rregulluar në mënyrë që të sigurojë minimizimin e rreziqeve sistematike. Cilësia e ligjeve të tregtisë, miratimi i rregullave ndërkombëtare, efektiviteti dhe zbatimi i ligjeve të falimentimit, standardeve dhe aftësia e sistemit ligjor për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tregtisë në kohën e duhur dhe transparente mund të ndikojë në zhvillimin dhe disponueshmërinë e financimit të tregtisë. Gjithashtu, zhvillimi mund të lehtësojë dhe zvogëlojë koston dhe kohën që lidhen me kërkesat ligjore.

Në sistemin bankar ku është kanalizuar **kreditimi tregtar** i cili mund të ndikojë thelbësisht sistemin financiar, stukturën dhe efikasitetin e tij dhe si rrjedhim mund të ndikojë dhe disponueshmërinë e financave të tregtisë. Efikasiteti i sistemit që matet me diferencën midis depozitave dhe normat e huadhënies , dhe / ose me numrin e ditëve që duhet për të transferuar paratë nga një institucion në një tjetër, do të përcaktojë nevojat e eksportuesve dhe importuesve. Një treg bankar i plotësuar do të ishte kur ky sektor të kanalizohet në financave e tregtisë duke u specializuar në përdorimin e këtyre instrumentave.

Ekzistenca e kufizimeve të qeverisë në instrumentet e tregut dhe kapitalit do të ndikojë drejtpërdrejt në radhët e instrumenteve të financave të tregtisë dhe shërbimeve në dispozicion për të zbutur rrezikun ose sigurinë e kredisë. Institucionet financiare dhe ndërmjetësit mund të hartojnë instrumenta apo kontrata (marreveshje edhe pa ndihmën e

institucioneve shtetërore duke krijuar një infrastrukturë të financimi të tregtisë në ndihmë të eksportuesve apo importuesve) (UNCTAD/WTO, 2005).

Ekspotuesit shpesh përballen me vështirësi financiare dhe vështirësi që i atribuohen mos koordinimit të kohës ndërmjet pagesave dhe porosive. Normat e interesit të huasë variojnë nga një vend në tjetrin dhe rrisin kostot e produktit final duke ulur kështu konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve. Si rrjedhim kosto e lartë e huamarrjes ka efekt negativ të eksportuesit dhe në zhvillimin e financimit të tregtisë. Përfundimisht, kostoja e huasë varet nga mjedisi makroekonomik.

Institucionet

Institucionet politike veprojnë në dy mënyra: në radhë të parë vendosin për veprimet politike dhe influencojnë institucionet ekonomike në zbatimin e tyre dhe në adoptimin e tyre. Institucionet politike ndikojnë mbi tregtinë indirekt, kështu mungesa e transparencës, legjitimitetit rrit kostot e tregtisë. Lidhja midis institucioneve politike dhe tregtisë është vlerësuar të jetë një lidhje e drejtë, pozitive. Një shtet më demokratik ka dhe politikat me liberale të tregtisë.

Institucionet ekonomike, ndikojnë veçanërisht në cilësinë e rregulloreve dhe sundimit të ligjit sigurojnë një strukturë kritike për ndërveprim ekonomik. Rregulla të qarta, të qëndrueshme dhe të zbatueshme janë themelore për marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare. Për më tepër, institucionet ekonomike mund të formësojnë flukset e tregtisë duke ndikuar në avantazhin krahasues të vendeve. Të drejtat e pronave, rregulloret efektive dhe sundimi i ligjit lejojnë aktorët ekonomikë për të krijuar një marrëdhënie tregtare të cilën e rregullon këtë dhe pozicionet individuale. Këto institucione krijojnë stimuj për mallrat dhe shërbimet që shkëmbehen si dhe reduktojnë kostot e transaksionit që lidhen me pasiguri dhe mungesë të transparencës. Cilësia e shërbimeve dhe transparenca në institucionet qeveritare politike dhe ekonomike krijojnë një avantazh krahasues me vendet e tjera.

Faktorët që shpjegojnë marrëdhënie mes politikave tregtare dhe institucioneve ekonomike janë : *Së pari*, bashkimi me zinxhirët e ofertës mund të jetë një strategji e suksesshme për

vendet në zhvillim por varet nga forca dhe cilësia e institucioneve ekonomike. Vendet në zhvillimin duke forcuar zbatimin e kontratës, do të kenë shumë investime dhe kostot e prodhimit do të jenë më e ulëta se në vendet me institucione të varfëra. Së dyti, cilësia e kuadrit institucional është një përcaktues i rëndësishëm i zgjedhjes së firmave për t'u integruar në një fazë të veçantë të prodhimit.

Në infrastrukturë e mirë e institucioneve financiare dhe gjendshmëria/ lëshimi i instrumenteve financiarë të financave e tregtisë në gjithë nivelet e institucioneve do të ndihmonte në zhvillimin dhe rritjen e përdorimit të tyre.

Niveli i parë i institucioneve (kontrroll direkt nga qeveria) Banka Qëndrore ose autoriteti monetar mund të kosinderojë nevojën e biznesit për financim duke hartuar një rregullore të qartë të financimit të eksportit dhe procedurave që lidhen me të. Të cilat duhet të trasmetohen duke mundësuar disponueshmërinë e disa lloj instrumentash në nivele më të ulta të sistemit financiar, si përshëmbull bankat e nivelit të dytë apo banka tregtare.

Ministria e Financave mund të adoptojë politika të zhvillimit të ndërrmarrjeve. Përshëmbull, për biznesin e vogël: përfshirja e një takse motivuese e orientuar drejt eksportit. Ministritë të cilat kanë lidhje me tregtinë mund të luajnë një rol aktiv në promovimin dhe mbështetjen e tregtisë, pra biznesit. Gjithashtu ministria mund të negociojë për heqjen e pengesave që vijnë nga rrugë administrative dhe borde.

Niveli i dytë i institucioneve (e rëndësishme për tu theksuar është se në këtë nivel institucionet e nivelit të dytë të kenë një mbështetje nga qeveria që në zhvillimin e hershëm të tyre). Bankat e nivelit të dytë janë institucione të cilat mund të adoptojnë më së miri këto instrumenta, për më shumë janë të mbikqyrura nga Banka Qëndrore dhe kjo vëtë e mbikqyrur nga qeveria.

Niveli i tretë i institucioneve (drejtuar nga tregu, ndërhyrja e qeverisë minimale). Një legjislacion i qartë dhe transparent i cili kërkon zhvillimin e institucioneve jo bankare. Në këtë stad programet janë të qarta trajnimi i punonjësve është rutin, është e lehtë për të pasur akses në këto lloj instrumentash.

Duke formuar kështu një kulturë të shëndoshë të bërit biznes. Kultura e biznesit është e rëndësishme në zhvillimin e financave të tregtisë.

3.1. Rëndësia e përdoruesve dhe aktorëve kryesorë të financave të tregtisë

Eksportuesit (Eric Bishop, 2004) janë në fillim të çdo transaksioni të tregtisë ndërkombëtare dhe mund të jenë prodhuesit, tregtarët, bujqit ose prodhuesit e mallrave. Ata shesin mallra ose shërbime për blerësit e huaj në mënyra të ndryshme edhe, nëse ato nuk janë pjesë e një grupi të madh, pothuajse me siguri do të kërkojë shërbimet lojtarëve të tjetër kryesorë. Qëllimi i tyre është për të çuar mallrat e tyre te blerësit në mbarë botën, shpejtë dhe të sigurt dhe sigurisht të paguhen në brenda afateve të rëna dakord.

Rëndësia e eksporteve në ekonominë e shumë vendeve është demonstruar nga një gamë e gjerë e mbështetjes dhe inkurajimit të dhënë nga qeveritë, veçanërisht përmes Agjencitë e Creditimit të eksportit. Këto agjensi ofrojnë lehtësi për eksportet duke i lejuar eksportuesit të konkurojnë me konkurrentët e huaj të cilët shpesh gëzojnë avantazhet e kostos së ulët punës dhe lëndëve të para. Grupet shumëkombëshe kanë përhapur rritjen në zona me kosto të ulët dhe fitimet e tyre të riatdhësuar ndihmojnë duke reduktuar bilancin e deficiteve të pagesave, pra, në mënyrë të qartë. Vendet me tepricat e mëdha të burimeve natyrore janë shumë të varur nga eksportet, si pasojë ata janë shpesh të detyruar të hyjnë në skemat countertrade me vendet që nuk kanë shkëmbimin me të huajt. Countertrade është një formë e specializuar e financave projektuar për të lehtësuar tregtinë mes vendeve që nuk kanë mundësi për të fituar këmbimit valutor për të paguar importet, por kanë nevojë për të gjetur tregje për prodhimet e tyre.

Importuesit (Eric Bishop, 2004) mund të jenë prodhues të cilët blejnë lëndë të para për fabrikat e tyre, kompanitë e naftës blejnë naftë bruto për rafinim, ose mund të jenë thjesht tregtarë dhe tregtarët përmbushin kontratat me konsumatorët vendas dhe të huaj. Për këtë të fundit, financat në përgjithësi janë kritike, sidomos nga tejkalimi i periudhës mes

importin dhe shitjen. Si pasojë, tregtarët mbështeten kryesisht në banka dhe warehousemen të cilët ata do të zotohen për mallrat e tyre para se të ri-paketohen dhe transportohen për blerësit përfundimtar. Është e rëndësishme për ata që furnizuesit e tyre jashtë shtetit janë paguar vetëm kur mallrat e porositur të jenë dërguar; kjo përfshin përdorimin e metodave të pagesës të operuar nga bankat, të siguruara sipas titullit të mallrave. Edhe pse importuesit nuk konsiderohen aq të favorshëm si eksportuesit në vendet me problemeve me bilancin e tregtisë, kontributi i tyre në ekonomi është i vlefshëm.

Lëndët e para, produktet ushqimore, energjia dhe shërbimet janë thelbësore për të ruajtur prodhimin industrial aty ku nuk ka burime natyrore dhe kështu prodhimin, e me pas eksporti i mallrave do të ishte një mënyrë për të ulur deficitin tregtar. Përhapja e grupeve shumëkombëshe ka arritur në një farë mase të sigurojë lende të para nga vendet e pasura me minerale dhe kanë furnizuar vendet të cilët kanë investuar për import dhe që kanë mungesë të tyre.

Tregtarët importojnë mallra për rishitje dhe i përpunojnë para se ti riekportojnë. Ata gjithashtu hyjnë në kontrata me furnizuesit e huaj për mallrat të cilat janë dërguar direkt për blerësit në vende të tjera të huaja. I gjithë ky aktivitet kërkon aftësi financuese që ndonjëherë ose shpesh herë tejkalon mundësitë e operatoreve për të blerë dhe shitur me çmime më të dobishme.

Rishpërndarësit e mallrave, apo agjentët doganorë sic ata janë të njohur ndryshe, janë ndoshta operatorët më të gjithanshëm në zinxhirin e tregtisë. Ata mbledhin mallrat nga eksportuesit, ndonjëherë bëjnë dhe paketim për dërgesa të ndryshme, transport në porteve, transport rrugor, hekurudhor apo deri dhe lidhje të marredhenieve me kompani anijesh ose ajrore (Eric Bishop 2004). Njohja e tyre për tregjet e huaja, dokumentacionin i kërkuar dhe rregulloret aktuale të importit që zbatohen në vendet e huaja është me vlerë të madhe për eksportuesit të cilët shpesh do të besojë përgatitjen e dokumenteve që kërkon dhoma e certifikimit tregtisë dhe konsullore.

Warehousemen (**magaziniere**) kryejnë një shërbim të vlefshëm paraprak për dërgimin e mallrave dhe pas arritjes së tyre në portin e destinacionit. Ata mbajnë gjithmonë mallrat që i

përkasin një pale të tretë dhe është e domosdoshme që ata të kenë kërkesa të larta sigurie, më e rëndësishme e të cilave është që ata duhet të jenë plotësisht të pavarur. Financat janë të nevojshme për mallra të cilat duhet të jenë të magazinuara (Eric Bishop, 2004) në këtë fazë të transaksionit, bankat duan të jenë të sigurt se kompania magazinuese është plotësisht i besueshme dhe e menaxhuar si duhet. Me vlerë të veçantë në magazine është funksioni i specialist të paketimit. Magazinierët kanë njohuri të shkëlqyera për llojin e paketimit të nevojshme për mbrojtjen e mallrave gjatë çdo forme transporti dhe për të përmbushur rregullat e veçanta në fuqi në vendet e huaja.

Mallrat mund të transportohen në një numër mënyrash të ndryshme dhe nga disa lloje transportuesish. Por, ekziston një nevojë për transportuesin e pavarur rrugor, operatorë dhe kompanitë hekurudhore për kryer transportin e mallrave në rrugë të veçanta dhe të jetë përgjegjës për të gjithë udhëtimin. Bankat dhe kompanitë e sigurimit tani insistojnë në kufizimin e moshës së anijeve që transportojnë mallra në të cilat ata kanë një interes dhe janë të kujdesshëm. Këto kërkesa kanë tendencë për të drejtuar tregtinë drejt transportuesit me reputacion të padyshimtë. Transportimi (Eric Bishop, 2004) i produkteve të cilat duan shumë kujdes dhe ambiente të freskëta si lule, fruta, perime dhe mallra të tjera që prishen ka bërë që prodhuesit tani mund të shesin në tregjet të cilat janë mijëra milje larg dhe e di se mallrat do të vazhdojnë të jetë freskët në mbërritje. Ku shpejtësia është thelbi, prandaj eksportuesit gjithmonë do të mbështeten në ndihmen e nevojshme në stacione dhe deri në desalination, duke minimizuar humbjet e prodhimit.

Çdo lëvizje e mallrave nga deti, ajri apo transporti tokësor permbajnë rreziqe. Megjithatë gjatë dërgesave egziston gjithmonë mundësia të shkaktohen dëme; në disa pjesë të botës, pirateria dhe rrëmbimi është përhapur. Shumica dërgesave që financohen nga bankat ose institucionet e tjera financiare duan të sigurojnë ato nga këto rreziqe. Grupet kryesore të sigurimit (Eric Bishop 2004) të ofrojnë një gamë të gjerë të mbuluar ndaj rreziqeve detare dhe luftës, dhe në shumë raste përdorin politika specifike për mallrat e vecante. Për shembull, rreziqet e përfshirë në kryerjen e një ngarkesë të gazit të lëngshme janë krejtësisht të ndryshme nga ato që mund të paraqitet gjatë transportit të grurit, sheqerit apo produkte të ngrira. Bankat e kanë të domosdoshëm sigurimin e udhëtimit në rast se e

financon ajo udhëtimin. Ata duhet të jenë të sigurt se është vënë në dukje interesi i tyre në mbulimin e sigurimit nga kompania e sigurimeve dhe që kërkesat do të përmbushen shpejt.

Bankat ndërkombëtare kanë ndjekur fuqishëm zhvillimin e botës dhe tregjet janë të përfaqësuara gjerësisht nga degë dhe agjenci (Eric Bishop, 2004). Ato gëzojnë një avantazh të madh ndaj bankave të vogla në aftësinë e tyre për të siguruar paketa financiare për transaksionet shumëkombëshe dhe të përmbajnë të gjitha operacionet brenda rrjetit të tyre. Qasje në një gamë të madhe të monedhave, lehtëson financimin dhe shpesh zvogëlon nevojën për tu mbuluar nga tregu. Prania në çdo vend ofron mundësi për njohjen e rregulloreve lokale, importit dhe eksportit të kuotave dhe embargove, dhe mundësitë për të marrë informacion mbi qeverinë e afërt dhe kontratat private për të cilën klientët janë të interesuar. *Friederike Niepmann and Tim Schmidt-Eisenlohr, 2013*) në punimin e tyre gjetën se bankat kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e rrisit për eksportet. Nëse është e nevojshme, ata mund të sigurojnë lidhje për klientët jashtë shtetit. Bankat të cilat operojnë në rrjet kanë shumë më shumë gjasa për të tërhequr klientë për shumë lloje instrumentash të financimit të tregtisë, për shkak të statusit të tyre. Kërkesat e tregtisë botërore kanë çuar në zhvillimin e specialistit bankar të angazhuar vetëm në sigurimin e të gjithë klienteve të importit dhe eksportit.

3.2. Indikatori i matjes së financave të tregtisë

Teoritë e ndryshme ekonomike dhe faktorët e ndryshëm që ndikojnë në flukset tregtare dhe rrjedhimisht rrisin mirëqënien e vendit kanë çuar në krijimin e organizatave ndërkombëtare për matjen e tyre duke renditur vendet në bazë të zhvillimit të faktorëve që e ndikojnë atë. Si të gjithë ekonomistët dhe teoritë e tyre gjatë kohës edhe organizatat ndërkombëtare mendojnë se tregtia dhe rritja e saj varet nga faktorë të ndryshëm të cilët i shohin si faktorë të lehtësimit të saj.

Organizata Botërore e Tregtisë e përcakton lehtësimin e tregtisë si thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave të tregtisë ndërkombëtare. Në Axhendën e Zhvillimit të Dohas

përqëndrohet në negociatat e lehtësimit të tregtisë në lirinë e tranzitit, tarifat dhe formalitetet lidhur me importin dhe eksportin dhe transparenca e rregullat tregtare. Në thelb ka të bëjë me procedurat në kufi të tilla si doganat, procedurat e portit dhe formalitetet e transportit.

Komisioni European përcakton lehtësimin e tregtinë si thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave të tregtisë ndërkombëtare, duke përfshirë procedurat për importin dhe eksportin, të cilat në masën më të madhe i referohen aktiviteteve (praktikave dhe formaliteteve) të përfshira në mbledhjen, paraqitjen, komunikimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për lëvizjen e mallrave në tregtinë ndërkombëtare.

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Për OECD, lehtësimi i tregtisë ka të bëjë me riorganizimin dhe thjeshtimin e procedurave të tregtisë ndërkombëtare në mënyrë që të lejojë rrjedhjen më të lehtë të mallrave dhe të tregtisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këtë e trajtuam më gjerësisht te faktoret që ndikojë në rritjen e tregtisë, më parë në punim.

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillim. Për UNCTAD, çdo masë që lehtëson një transaksion tregtar dhe redukton kostot në transaksion përshtatet në kategorinë e lehtësimit të tregtisë. Kjo mund të përfshijë masa në lidhje me: (a) formalitetet, procedurat, dokumentet dhe përdorimi i standardeve dhe mesazhe elektronike për transaksionet tregtare; (B) lëvizja fizike e mallrave nëpërmjet përmirësimeve në shërbime, kornizën ligjore, transporti dhe infrastruktura, si edhe përdorimin e mjeteve moderne të teknologjisë së informacionit nga ofruesit dhe përdoruesit e shërbimeve të ndryshme; (c) diskutimin dhe shpërndarjen në kohë të informacionit lidhur me të gjithë palët e interesuara.

Organizata Botërore e Doganave e konsideron lehtësimin e tregtisë si aplikimin e teknikave moderne dhe teknologjitë, duke përmirësuar cilësinë e kontroleve në mënyrë të harmonizuar ndërkombëtarisht.

Banka Botërore. Lehtësimi i tregtisë i referohet kufirit dhe masave pas-kufitare. Fushat e fokusit të Bankës janë: investimet në infrastrukturë; modernizimi i doganave dhe kufirit; riorganizimi i kërkesave dokumentare dhe rrjedhjen e informacionit; automatizimi dhe shkëmbimi elektronik i të dhënave; efikasiteti porteve; logjistika dhe transporti i shërbimeve; rregullimi dhe konkurrenca; transiti dhe multimoda e transportit; dhe siguria e transportit.

Për Forumin Botëror Ekonomik lehtësimi i tregtisë fillon që me hapjen e vendeve për tregti, uljen e tarifave ose ulja e barrierave tarifore e deri te studimet më të fundit për uljen e barrierave në zinxhirin e ofertës ku bën pjesë dhe “Financave të Tregtisë” .

Scott Davis, Shefi Egzekutiv i UPS, SHBA, thotë :

ulja e tarifave stimulon rritjen flukseve tregtare por ulja e barrierave të zinxhirit të ofertës mund të rrisë flukset tregtare gjashtë herë më shumë se ulja e tarifave. Për të ulur barrierat e tregtisë duhet të jesh inovativ dhe të përdorësh praktikat më të mira të cilat do të ndihmonin jo vetëm kompanitë e medha por edhe kompanitë e vogla dhe ato të mesme, pra të jenë gjithëpërfshirëse.

Shtetet duhet t'i japin prioritet investimeve dhe bashkëpunimit midis shteteve. Reduktimi i barrierave tregtare, të tilla si vonesa zhdoganimit, mungesa e procedurave të standardizuara dhe infrastruktura e dobët, nuk do të jetë e lehtë për t'u arritur. Megjithatë, duke njohur se ne jemi tani një treg global dhe duke u fokusuar në "gjithë zinxhirin e ofertës", ne kolektivisht mund të krijojmë një ekonomi globale më të qëndrueshme.

Barrierat e zinxhirit të ofertës: (Enabling Trade Valuing Growth Opportunities, 2013) mungesa e infrastrukturës, institucionet, politikat dhe lehtësi në shërbime, rrjedha e lirë e mallrave në tregje dhe kufij.

Renditja e Shqipërisë për indeksin e lehtësimit të tregtisë ka pasur luhatje gjatë viteve : në vitin 2010 Shqipëria renditej e 59 nga 132 vende të monitoruara, në vitin 2012 Shqipëria

është renditur 49-ta pra ka patur një rritje në renditje prej 10 vendesh, në vitin 2014 renditej në vendin e 69 duke u ulur në renditje prej 20 vendesh dhe në vitin 2016 në nendin e 60, duke lehtësuar tregtinë në krahasim me 9 ekonomi të tjera të botës.

Barrierat të cilat duhet të ulen ose të zbuten në favor të tregtisë janë të klasifikuara në disa shtylla.

1. Aksesit në tregje: ku vendet lejojnë produktet e huaja të hyjnë në vend dhe vendet e tjera lejojnë produktet tona të hyjnë në vend

Kuotat,

Taksat e importit,

Masat e sigurisë së produktit, fitosanitare, certifikata, licenca import / export.

2. Bordet e administrimit : të cilat lehtësojnë hyrjen dhe daljen e produkteve (import-eksport)

Eficientë në administrim

Eficientë në procedurat e import-eksportit (nëpërmjet agjensive, standarteve.)

Tranparençë në administrim dhe lehtësira në pagesa.

3. Infrastruktura e transportit:

Disponueshmëri dhe cilësi në infrastrukturën e transportit

Disponueshmëria e shërbimeve në cilësinë e transportit

Disponueshmëria e përdorimit të teknologjisë, komunikacionit dhe informacionit

4. Mjedisit i biznesit:

Cilësia e qeverisë vendase duke përfshirë rregullat dhe siguria bëjnë më tërheqëse tregtinë.

Investim në politika

Siguri fizike

Rregullime dhe lehtësira, disponueshmëri në instrumenta: si “financa e tregtisë”.

Barrierat variojnë nga vendi në vend dhe nga mjediset rregullatore të cilat rrisin kostot dhe rrezikun, që reflektojnë në jo stabilitet dhe një qeveri që nuk funksionon mirë, vështirësi në punësim dhe mungesë të disponueshmërisë së “Financave të Tregtisë”. Kosto të cilat në një

mjedis të pasigurt kanë tendencë të rriten (rritja e kostove operacionale, rrit kostot e punës, rrit rrezikun politik, dhe jo vetëm.

Nga studimet dhe vlerësimet e Forumit Botëror Ekonomik rezulton se ulja e këtyre barrierave do të rriste PBB botërore me 5% dhe tregtinë me 15%. Reduktimi i këtyre barrierave rrit gjashtë herë më shumë PBB botërore se sa duke reduktuar tarifën. Arsyeja pse eficientia të tilla janë më të fuqishme dhe sjellin më shumë lehtësi në tregtinë ndërkombëtare është se reduktimi në pengesat të zinxhirit të ofertës (ku bën pjesë edhe financimi i tregtisë) përmirësojnë efikasitetin e lëvizjes së mallrave. Në të kundërt, reduktimet tarifore kryesisht përfaqësojnë një rishpërndarje të burimeve në një ekonomi, ndërsa kapin vetëm paaftësinë që krijohet nga tatimi.

3.3. Përmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull u trajtuan faktorët kryesorë që ndikojnë dhe kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë ndërkombëtare rëndësia e përdoruesve dhe aktorëve kryesorë të saj dhe në përfundim të kapitullit trajtohet indikator i matjes së financimit të tregtisë i cili bën pjesë në indikatorët kryesorë të lehtësimit të tregtisë ndërkombëtare. Në kapitullin në vijim bëhet përshkrim i detajuar i metodologjisë që dotë ndiqet në punim për evidentimin e faktorëve që kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë në Shqipëri. Do të përshkruhet hapat që do të ndiqen gjatë analizës vërtetuese në tregun bankar Shqiptar dhe faktorët që do të analizohen gjatë analizës krahasuese.

KAPITULLI IV : METODOLOGJIA

Në funksion të vërtetimit të hipotezës në studim analiza është ndarë në dy pjesë: *së pari*, është përdorur një analizë vrojtuese e cila këkon të evidentojë sa përdoren dhe sa njihen, përdoren më shumë për eksport apo import, a i ndihmojnë tregtarët për të kryer transaksione të sigurta, dhe a ka pengesa ligjore për përdorimin e tyre, cilët faktorë i kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë; *së dyti*, përdoret analiza krahasuese statistikore e nivelit të zhvillimit të faktorëve makroekonomik dhe institucional që ndikojnë përdorimin e financave të tregtisë në Shqipëri me vendet partnere të saj. Faktori kryesor i kushtëzimit të financave të tregtisë është mjedisi makroekonomik i cili ndikon edhe në cilësinë e institucioneve financiarë dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin e financave të tregtisë e nëpërmjet disa elementeve të saj. *Metodologjia e punimit mbështet në analizën vrojtuese, analizën faktoriale dhe atë krahasuese.*

Ky studim shtrihet në bankat më të mëdha që operojnë në Shqipëri të cilat përbëjnë afërsisht 80% të totalit të huasë bankare dhe mbi 70 % të depozitave në vend. Këto të dhëna japin një pasqyrë të plotë dhe realiste të situatës në vend. Të dhënat janë mbledhur gjatë vitit 2017 dhe bankat janë përgjigjur pyetësorit për gjendjen e faktorëve që kushtëzojnë zhvillimin e financat e tregtisë për tregtinë jashme. Analiza e faktorëve që ndikojnë financat e tregtisë në Shqipëri përbën pjesën kryesore të punimit dhe të konkluzioneve që dalin nga ajo. Punimi ka përdorur si referencë një literaturë të gjerë të huaj të fokusuar në financat e tregtisë. Të dhënat dytësore për analizën krahasuese janë marrë nga databaza të besueshme si Doingbusiness, WEF, Banka Botërore, Banka Qendrore e Shqipërisë dhe Instat etj.

4.1. Shrytëzimi i kuadrit teorik për kërkimin e të dhënave në teren

Të gjithë elementët dhe faktorët që shpjegon teoria si faktorë të rëndësishëm në kushte perfekte ndihmojnë financat e tregtisë, tregtarët dhe rrjedhimisht zhvillimin. Së pari, kuadri teorik i financave të tregtisë shpjegon diferencën midis huasë dhe përdorimit të instrumenteve të financave të tregtisë e cila përbën një element të rëndësishëm në trajtimin

e cështjes dhe kuptimin më të mirë të saj. Së dyti, faktorët kryesorë që ndikojnë në përdorimin e financave të tregtisë përbëjnë edhe pjesën kryesore të punimit dhe ndihmojnë për të bërë një analizë të detajuar të financave të tregtisë në Shqipëri. Së treti, teoria shpjegon se institucionet financiare, si bankat, janë institucionet kryesore të financave të tregtisë. Kjo na ndihmon që nëpërmjet tyre dhe informacionit të mbledhur nga to të kuptojmë situatën e përdorimit të financave të tregtisë në Shqipëri. Së fundmi, teoria shpjegon se përdorimi i këtyre instrumenteve menaxhon rreziqet e tregtimit ndërkombëtarisht, argument i cili plotëson dhe mbështet analizën që i bën punimi cështjes.

4.1.1. Burimet e informacionit

Pyetje bazë kërkimore është:

Cilët faktorë të mjedisit makroekonomik kushtezojnë zhvillimin e financave të tregtisë së jashtme në Shqipëri?

Hipoteza bazë:

Zhvillimi i financave të tregtisë dhe struktura institucionale e saj varet drejtpërdrejt nga mjedisi makroekonomik dhe rreziku i vendit.

Ashtu si u përmend qysh në fillim të punimit me faktorë të mjedisit makroekonomik do të kuptojmë: situatën e tregtisë, burimet neto, borxhi jashtëm dhe likuiditeti, politika kursit të kembimit dhe disponueshmeria, sistemi monetar dhe financiar, tregu i kreditimit, mjedisi ligjor. Për strukturën dhe kapacitetin institucional i financave të tregtisë faktorët janë: institucionet financiare, kapitali dhe kreditimi, kosto e huamarrjes. Gjithashtu, faktor i rëndësishëm është rreziku i vendit.

Për vërtetimin e hipotezës në punim janë përdorur dy lloj burimesh. Burimet kryesore të informacionit janë:

Burime parësore: Të dhëna të mbledhura nga pyetësi i drejtuar bankave më të mëdha në Shqipëri. Ky pyetësor është përgatitur vetëm për këtë punim duke marrë parasysh kushtet e bankave në Shqipëri dhe respektimin e sekretit bankar. Pyetësi ka 15 pyetje me fund të

mbyllur. Bankat që i janë përgjigjur pyetësorit përbëjnë mbi 80% të huave bankare dhe mbi 70% të depozitave në Shqipëri. Pyetësorit i janë përgjigjur 7 nga 16 bankat në total që operojnë në vend.

Tabela 3. Huatë dhe depozitat sipas bankave Burimi: Shoqata Shqipëtare e Bankave

Përpunimi: Autori

Bankat	Huatë	Depozitat
Alpha Bank Albania	5.76%	5.11%
American Bank of Investments	1.89%	2.77%
Banka Kombëtare Tregtare	21.99%	26.30%
Credins Bank	16.04%	12.34%
Credit Bank of Albania	0.05%	0.11%
FIBANK Albania	1.23%	1.39%
International Commercial Bank	0.68%	0.64%
Intesasanpaolo Bank Albania	7.33%	11.03%
NBG Bank Albania	4.76%	2.69%
ProCredit Bank	3.39%	2.27%
Raiffeisen Bank Albania	18.30%	18.94%
Societe Generale Albania	7.93%	5.58%
Tirana Bank	4.97%	5.38%
Union Bank	3.20%	3.02%
United Bank of Albania	0.57%	0.51%
Veneto Banka	1.90%	1.91%
Totali	100%	100%

Tabela 4. Huatë dhe depozitat sipas bankave që i janë përgjigjur pyetësorit Burimi:

Shoqata Shqipëtare e Bankave Përpunimi: Autori

Bankat	Huatë	Depozitat
Alpha Bank Albania	5.76%	5.11%
American Bank of Investments	1.89%	2.77%
Banka Kombëtare Tregtare	21.99%	26.30%
Credins Bank	16.04%	12.34%
Intesasanpaolo Bank Albania	7.33%	11.03%
Raiffeisen Bank Albania	18.30%	18.94%
FIBANK Albania	1.23%	1.39%
Societe Generale Albania	7.93%	5.58%
Veneto Banka	1.90%	1.91%

4.2. Mbledhja e të dhënave parësore

4.2.1. Lloji i pyetësorit dhe ndërtimi i tij:

Pyetësi ka karakter vrojtues dhe tenton të mbledhë informacione të përgjithshme mbi përdorimin e disponueshmërinë e financave të tregtisë. Pyetësi është ndërtuar posacërisht për ti ardhur në ndihmë analizës së punimit. Pëtesori ka 15 pyetje me fund të mbyllur. Për hartimin e këtij pyetësi ka ardhur në ndihmë kuadri teorik dhe pyetësi i UNCTAD/WTO i vitit 2005 i drejtuar bankave qendrore të vendeve në zhvillim. Pyetësi i janë përgjigjur ekspertët që merreshin direkt me financat e tregtisë ndërkombëtare ne qendrat e bankave përkatëse. Në disa pyetje eshte perdorur shkallezimi nga 1 në 4 pë

nenkupton , Aspak , Pak , Mjaftueshem , Shume. Ky shkallezim është përdorur për të kuptuar më mirë në rend rritës se cili faktor sipas ekspertëve të bankës ndikon më tepër financat e tregtisë.

4.2.2. Qëllimi i pyetësorit:

Qëllimi i pyetësorit është : së pari, pyetësi është hartuar në mënyrë që të kuptojë se sa përdoren instrumentat financiarë të financave të tregtisë për bizneset të cilat marrin pjesë në tregtinë ndërkombëtare.

Së dyti, të kuptojë nëse këto instrumente njihen nga tregtarët dhe sa të disponueshme janë ato nga ana e bankës.

Së treti, të kuptojë cilët instrumente përdoren nga financave të tregtisë në Shqipëri.

Së katërti, të kuptojë nëse bankat operojnë me të gjitha madhësitë e bizneseve dhe llojit të aktivitetit.

Së pesti, të kuptojë nëse këto instrumenta kanë ndihmuar biznesin për të ndërtuar marrëveshje të sukseshme duke menaxhuar rreziqet e tregtimit.

Së gjashti, të kuptojë nëse ka pengesa ligjore në përdorimin e instrumenteve.

Së shtati, cilët faktorë kushtëzojnë zhvillimin e tyre në Shqipëri.

4.2.3. Analiza përshkruese statistikore e të dhënave

Kjo analizë jep një panoramë të përgjithshme të rezultateve të pyetësorit dhe të punimit. Në këtë analizë përshkruhen rezultatet e përgjithshme të pyetësorit në matrica dhe shpjegime. Nëpërmjet analizës kuptojmë nivelin e përdorimit dhe arsyet e këtij niveli përdorimi të financave të tregtisë në Shqipëri. Gjithashtu nga analiza kuptojmë paraprakisht se cilët mund të jenë faktorët kryesorë që pengojnë zhvillimin e financave të tregtisë në Shqipëri.

4.2.4. Vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren

Vështirësitë gjatë mbledhjes së të dhënave në terren kanë qënë shumë. *Së pari*, disa nga ekspertët mundoheshin të mos identifikonin bankën dhe emrin e tyre për arsye të mungesës së besimit të përdorimit të të dhënave. *Së dyti*, po për këtë arsye mundoheshin të pëgjigjeshin shkurt dhe pa dhënë shumë informacion, me justifikimin e ruajtjes së privatësisë së informacionit.

Vështirësia më e madhe e mbledhjes së të dhënave dhe bërjes së këtij pyetësori një mjet funksional kërkimi ishte dhe mungesa e ekspertëve në filjalet e bankave dhe mos ofrimi i tyre instrumenteve nga këto filiale. Gjithashtu, shumica e bankave qendrore kishin mungesë të një departamenti të mirëfilltë për këtë qëllim. Kështu duke konsideruar se bankat kishin vetëm një ekspert në qendrat e tyre pyetësori është plotësuar vetëm nga ekspertët e qendrave të dhënat janë të pakta.

Gjykuar nga mundësitë dhe niveli i disponueshmërisë së informacionit rreth financave të tregtisë në Shqipëri, analiza vrojtuese mbetet thuajse forma e vetme e studimit në këtë rast. Megjithatë, duhet theksuar se pyetësori nuk lë vend për ndonjë kontroll statistikor ose përdorim modeli, e në këtë rast mbetet vetëm përdorimi i statistikes deskriptive, thjesht tabela me denduri dhe grafike.

Por edhe pse pyetësori nuk ka mjaftueshëm të dhëna për të analizuar statistikisht, ka arritur qëllimet e tij dhe ka ndihmuar, të kuptohen arsyet e mospërdorimit të instrumenteve të financave të tregtisë dhe faktorët të cilët kushtëzojnë zhvillimin e saj, duke kontribuar në analizën e çështjes me të dhëna cilësore primare.

Burime dytësore: Së pari, shfrytëzimi i literaturës egzistuese dhe i studimeve të ndrryshme mbi Financat e Tregtisë. Së dyti, të dhënat e mbledhura nga institucione prestigjioze, të

besueshme, ndërkombëtare si ICC, WEF, Banka Botërore, Banka Qendrore e Shqipërisë, OECD, INSTAT, etj.


4.3. Mbledhja e të dhënave dytësore

Faktorët e marrë në studim në analizën krahasuese

Për shkak se mjetet dhe instrumentet e financimit të tregtisë ofrohen kryesisht nga ose nëpërmjet institucioneve financiare, niveli i zhvillimit të infrastrukturës së financave të tregtisë është i lidhur ngushtë me atë të sektorit të përgjithshëm financiar. Prandaj mund të pritet që një mjedis i qëndrueshëm makroekonomik të jetë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e financave të tregtisë, së bashku me një politikë të hapur ekonomike.

Faktorët kryesorë të mjedisit makroekonomik që ndikojnë në zhvillimin institucional të financave të tregtisë, ky i fundit bashkë me faktorët kryesorë të mjedisit makroekonomik ndikojnë në disponueshmërinë e financave të tregtisë janë të diskutuara në kapitullin e tretë, monitorimi dhe zhvillimi i këtyre faktorëve mund të ndihmojë vendet në identifikimin e dobësive të infrastrukturës së financave të tyre të tregtisë dhe pengesat e mundshme për zhvillimin e financave të tregtisë. Vendet duhet se ndjekin një rrugë të ngjashme me atë të treguar në figurë, duke ditur se pak vende kanë qenë në gjendje të zhvillojnë efektivisht sektorin e tyre të financave të tregtisë pa, së pari, përforcuar mjedisin e tyre makroekonomik.


Figura 2. Interpretimi grafik të varësise Performance makroekonomike /Zhvillimi i kapacitetit te financave të tregtisë. Burimi: Development handbook for economies in transition 2005 Përpunimi: Autori



Analiza e treguesve/faktorëve të financave të tregtisë është një mjet i dizajnuar për të ndihmuar organet që përfaqësojnë sektorin privat në vendet në zhvillim, si dhe sektorin financiar, agjencitë qeveritare që merren me zhvillimin e tregtisë, për të kuptuar se cilët janë faktorët që kufizojnë zhvillimin e financave të tregtisë.

Disponueshmëria dhe zhvillimi i financave të tregtisë do të ndikohet në mënyrë indirekte nga mjedisi makroekonomik siç përcaktohet nga flukset tregtare aktuale të një vendi, burimet neto, borxhi i jashtëm dhe likuiditeti etj., Por do të ndikohet drejtpërdrejt nga struktura institucionale e financave të tregtisë dhe kapaciteti si të nxjerra nga grupi ekzistues i institucioneve financiare, kufizimet e kapitalit dhe kredisë dhe koston e huamarrjes. Megjithatë, siç tregohet qartë në figurë, struktura institucionale dhe kapaciteti i financave të tregtisë vetë varet drejtpërdrejt nga mjedisi makroekonomik.

Figura1 Dhjetë përcaktues të qasjes dhe disponueshmërisë së financave të tregtisë
Burimi: Development handbook for economies in transition 2005 Përpunimi: Autori



Një tabelë e TFP, për çdo vend apo grup vendesh të caktuar, bazohet në një set deri në 52 tregues, siç tregohet në tabelën e mëposhtme. Secili tregues paraqet ose i referohet një faktori që ndikojnë në mjedisin ose strukturën e sektorit financiar të vendit.

Si i tillë, ato mund të ndahen në dy grupe: një grup i parë që përfaqëson mjedisin makroekonomik të financave të tregtisë dhe tjetri përfaqëson strukturën dhe kapacitetin institucional të financave të tregtisë. Faktorët përqëndrohen në fushat e përgjithshme ku mund të bëhen përpjekje për të sjellë reforma apo ndryshime që duhet të ndihmojnë në përmirësimin e aksesit të ndërmarrjeve në financat e tregtisë.

Klasifikimi i faktorëve si mjedis makroekonomik dhe struktura institucionale ndihmon për të theksuar nëse problemet e financimit të tregtisë në një vend të caktuar shtrihen kryesisht në sektorin publik (p.sh., në mungesë të politikave qeveritare ose sistemit juridik ose gjyqësor) ose në vetë sektorin financiar (p.sh. një gamë të paplotë ose joadekuate të institucioneve, instrumenteve apo mekanizmave).

1.Situata e Tregtisë

- a) tregtia totale si përqindje e PBB-së
- b) kushtet e shkëmbimit neto të tregtisë
- c) ndryshimi i tregtisë totale

2.Burimet Neto

- a) Flukset neto të borxhit afatgjatë
- b) flukset neto të IHD-ve
- c) flukset neto të investimeve të portofolit
- d) asistencë zyrtare e zhvillimit zyrtar dhe ndihma zyrtare

3.Borxhi jashtëm dhe likuiditeti

- a) stoku total i borxhit të jashtëm
- b)shërbimi total i borxhit të jashtëm si një përqind e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve
- c) rezervat në muaj të importit të mallrave dhe shërbimeve
- d) bilancin e llogarisë korrente

e) borxhe afatshkurtër si përqindje e borxhit afatgjatë

4.Politika kursit të këmbimit dhe disponueshmeria

a) rregullimi i kursit të këmbimit MF

b) disponueshmëria e këmbimit valutor

c) luhatshmëria e kursit të këmbimit

d) Indeksi i kursit real të këmbimit valutor

5.Sistemi monetar dhe financiar

a) Depozitat si përqindje e PBB-së

b) thellimi financiar I: monetizimi i ekonomisë si përqindje

c) thellimi financiar II: Paratë

d) Raporti i qarkullimit të tregut të bursës

e) Kapitalizimi i tregut si një përqindje e PBB-së

6.Tregu i Kreditimit

a) Shtrëngimi i investimeve private si përqindje

b) Vlerësimi i borxhit sovran

c) Vlerësimi i borxhit sovran LT të Standard & Poor BB + A (C)

d) Normat e Forfaising

e) Rreziku i kredisë për eksport

7.Mjedisi Ligjor

a) Aftësia e sistemit ligjor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare Shih standardin e shënimeve

b) Efikasiteti në përmbushjen e procedurave ligjore, administrative

c) niveli i kostos ligjore

d) detyrën e vulës për marrëveshje

e) efektivitetin e ligjeve të falimentimit

f) standardet ndërkombëtare të auditimit Shihni standardin e shënimeve

8. Institucionet financiare

- a) plotësinë e sistemit bankar
- b) drejtimin e sistemit bankar
- c) plotësinë e sistemit jo-bankar
- d) drejtimin e sistemit jo-bankar
- e) instrumentet mbrojtëse
- f) efikasitetin operacional të sistemit bankar
- g) efikasiteti financiar i sistemit bankar: përhapja e normës së interesit
- h) kreditë me probleme
- i) sistemet e menaxhimit të rrezikut
- j) titullzimin

9. Kapitali dhe kreditimi

- a) kredia e brendshme për sektorin privat si përqindje e PBB-së
- b) kufizimet për derivativët dhe instrumentet e tjerë
- c) kufizimet në financimin e eksportit
- d) instrumentet e kapitalit dhe tregut të parasë
- e) kufizimet për investimet direkte
- f) kufizimet në operacionet e kredisë

10.Kosto e Huamarrjes

- a) norma e bankës kryesore
- b) norma reale e interesit
- c) vonesat e mbledhjes në muaj

4.3.1. Vështirësitë e mbledhjes së të dhënave dytësore

Në realizimin e këtij punimi kufizimet nuk kanë qenë të vogla. Realizimi i një studimi në kushtet e vendit tonë të vogël përbën vështirësi. Vështirësitë gjatë mbledhjes së të dhënave dytësor kanë qënë shumë.

Kufizime të tjera ka pasur edhe në gjetjen e të dhënave dytësore për Shqipërinë në institucione ndërkombëtare apo kombëtare për të bërë krahasimin dhe analizimin e faktorëve që kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë në Shqipëri. Së pari, të dhënat janë të pakta dhe kanë shtrirje kohore vogël. Së dyti, të dhëna mbi disponueshmërinë apo përdorimin e financave tregtare dhe instrumentave të saj në Shqipëri nuk mbildhen nga insitucionet tona financiare apo statistikat kombëtare, dhe rrjedhimisht nuk raportohen edhe nga institucionet ndërkombëtare. Të dhënat për financat e tregtisë në Shqipëri për tetë vitet e fundit janë marrë nga WEF (Indeksi i disponueshmërisë së instrumentave financiarë për biznesin në Shqipëri).

4.3.2. Burimet e faktorëve

Për të bërë analizën krahasuese të faktorëve të mjedisit makroekonomik dhe zhvillimit institucional të financave të tregtisë me vendet e tjera partnere në tregti me Shqipërinë, duhen burime të besueshme dhe të dhëna të mbledhura për një kohë disa vjecare dhe për shtete të ndrryshme. Të dhënat për faktorë të ndrryshëm janë marrë nga burime të ndrryshme. Të dhënat për situatën e tregtisë janë marrë nga INSTAT për Shqipërinë dhe nga Trademap për Bilancin tregtar të vendeve kryesore partnere të Shqipërisë. Nga Banka e Shqipërisë është marrë Struktura e stokut të borxhit dhe nga databaza e OECD-së është marrë Borxhi publik sipas vendeve. Niveli i investimeve të huaja direkte në Shqipëri 2014-2017 është marrë nga Tradingeconomics ndërsa IHD në % të PBB 2016 nga databaza e OECD. Kursi mesatar i këmbimit me dy monedhat kryesore 2012-2016 për Shqipërinë është marrë nga INSTAT. Zhvillimin financiar të Shqipërisë nga viti 2006-2015, Cilësia e Bankave, Indeksi i Disponueshmërisë së Instrumenteve Financiar për Biznesin dhe Veshtiresia në huamarrje janë marrë nga WEF. Normat humbjes të obliguesit 2008-2014 dhe Normat e humbjes të transaksionit 2008-2014 janë marrë nga ICC.

4.4.Përmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull u shshqyrtua në mënyrë të hollësishme metodologjia që do të ndiqet në vijim të punimit, për të gjetur faktorët që kushtëzojnë financat e tregtisë në Shqipëri. Përgjatë kapitullit u shqyrtuan çështje si: shrytëzimi i kuadrit teorik për kërkimin e të dhënave në teren; Burimet e informacionit: burime parësore, mbledhja e të dhënave parësore, lloji i pyetësorit dhe ndërtimi i tij, qëllimi i pyetësorit, analiza përshkruese statistikore e të dhënave, vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave në terren; dhe Burimet dytësore: faktorët e marrë në studim në analizën krahasuese, vështirësitë e mbledhjes së të dhënave dytësore. Kapitulli perfundon me renditjen e faktorëve kryesorë të nxjerë nga literatura që do analizohen për vërtetimin e hipotezës: situata e tregtisë, burimet neto, borxhi jashtëm dhe likuiditeti, politika kursit të kembimit dhe disponueshmeria, sistemi monetar dhe financiar, tregu i kreditimit, mjedisi ligjor, institucionet financiare, kapitali dhe kreditimi dhe kosto e huamarrjes. Në kapitullin vijues do të analizohet tregu bankar Shqiptar nëpërmjet një pyetësori (shiko shtojca1) të hartuar posacërisht për këtë punim.

KAPITULLI V : ANALIZË VROJTUESE E FINANCAVE TË TREGTISË NË SHQIPËRI

5.1. Rezultatet e pyetësorit

Pyetjes se cilat instrumente financiare të "financave të tregtisë" përdorin, bankat i janë përgjigjur sipas tabelës:

Tabela 5 Lloji i instrumentave të përdorur nga bankat në Shqipëri Burimi: Autori

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
LC (letër kredie)	x	x	x	x	x	x	x	x
Cash-in-Advance	x				x	x		
Documentary Collections (D/C)	x	x	x		x	x		
Open Account								x
Consignment								
ExportCredit Insurance								x
Export Factoring		x						
Leter Garanci	x	x		x	x	x		
Forfeiting								

Si vërehet edhe nga matrica në bankën Credins instrumentet më të përdorura në qëllim të tregtisë ndëkombëtare janë Letër Kredia dhe Garancitë Bankare. Banka Kombëtare Tregtare përdor LC (Letër Kredinë), Garancitë Bankare, Cash in Advance (kesh në avancë),

Documentary Collections (D/C) në ndihmë të tregetisë dhe tregtarëve që marrin pjesë në transaksione ndërkombëtare.

Instrumentet financiare për tregtinë që përdor Intesa Sanpaolo Bank Albania janë LC, Cash in Advance (kesh në avancë), Documentary Collections (D/C) dhe Open Account (llogari e hapur).

Instrumentet financiare për tregtinë që përdor banka ABI janë LC, Cash in Advance (kesh në avancë), Documentary Collections (D/C), Open Account (llogari e hapur) dhe Export Factoring.

ALPHA bank përdor Letër Kreditë, Garancitë Bankare.

Raifaisen Bank Albania. Raifaisen Bank Albania ofron një informacion të hollësishëm dhe të plotë për pyetjen duke i dhënë përgjigje të argumentuar në lidhje me llojin e instrumenteve, Instrumentat e më të përdorura dhe mënyra e përdorimit të RFAL janë Letër Kreditë, Garancitë Bankare, Dokumente për Arkëtim.

Kredia Dokumentare ose ndryshe Letër Kredia është një instrument pagese i lëshuar nga një bankë me kërkesën e klientit të saj. Pagesa e një Letër Kredie kryhet kundrejtë prezantimit të setit të kërkuar të dokumenteve, i cili duhet të jetë në përputhje me kushtet e vendosura në të. Letër Kreditë janë një instrument më i sigurt dhe më efektiv në kryerjen e pagesave në transaksionet e tregtisë ndërkombëtare dhe të tregtisë brenda vendit. Përdorimi i Letër Kredive nuk kufizohet vetëm në kryerjen e pagesave për blerjen e mallrave, por gjithashtu edhe për blerjen e shërbimeve dhe implementimin e projekteve specifike.

Letër Kreditë e Importit/ për blerje lëshohen nga Banka Raiffeisen në rastet kur klientët e saj blejnë/importojnë mallra ose shërbime nga partnerët e tyre brenda apo jashtë vendit. Në këtë lloj transaksioni Banka Raiffeisen merr përsipër një angazhim të pakthyeshëm, për llogari të klientit të saj, për të paguar përfituesin, kundrejtë prezantimit nga ana e këtij të fundit të setit të dokumenteve plotësisht në përputhje me kushtet e vendosura në Letër Kredi.

Letër Kreditë e Eksportit/ për shitje lëshohen në rastet kur klientët tanë shesin/eksportojnë mallra ose shërbime, brenda ose jashtë vendit, ata sugjerojmë që pagesa nga blerësit në favorin e tyre të kryhet përmes një Letër Kredie. Në këtë rast banka Raiffeisen merr Letër Kredine e lëshuar në favorin e klientit të saj me mesazh Swift-i ose me Letër, nga banka e blerësit (banka lëshuese). Letër Kreditë janë subjekt i Rregullave Standarte dhe Praktikës për Kreditë Dokumentare (Publikimi i ICC nr.600)

Garancitë Bankare janë subjekt i Rregullores Standarte të Garancive Bankare (URDG), Botimi ICC Nr. 758 i cili zëvendësoi rregulloren e mëparshme URDG Nr. 458. Megjithatë URDG NR.458 nuk përjashtohet nga përdorimi nëse palët e përfshira, aplikanti dhe përfituesi, bien dakort për përdorimin e saj.

Banka ofron lëshim të llojeve të ndryshme të Garancive Bankare direkte në favor të përfitueseve brenda dhe jashtë vendit duke përfshirë: *Garanci Pagesë* – lëshohet për llogari të aplikantit për të garantuar pagesën e mallrave dhe shërbimeve në favor të përfituesit. *Garanci për pagesë paraprake (Parapagimi)* – lëshohet për llogari të aplikantit për të garantuar përdorimin e shumës së parapaguar në përputhje me kontratën *Garanci Ofertë* - lëshohet për llogari të aplikantit për pjesëmarrje në tender. *Garanci Kontrate* - lëshohet për llogari të aplikantit për të garantuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. *Garanci për Magazinë Doganore. Lëshim të llojeve të ndryshme të Garancive Bankare Indirekte* - lëshohen nga banka në favorin e klientit të saj me kërkesë të një banke korrespondente (banka e aplikantit) për llogari të klientit të kësaj të fundit, nën përgjegjësinë e saj të plotë me kundërgarancinë e kësaj banke. *Hartim të teksteve të garancive* - Banka i përshtat tekstet e garancive me detajet e marrëveshjes së klientit. Me kërkesën e klientit suporton për hartimin e tekstit të garancisë që në fazën e negociimit të kontratës, cka mund të shoqërohet edhe me përfitime të tjera për ju ose partnerët tuaj vendas apo të huaj.

Dokumente për Arketim (Documentary Collection) është një instrument pagese sipas së cilës Eksportuesi/Shitësi dërgon në bankën e Importuesit/Blerësit dokumente të cilat lidhën me një dërgesë të vecantë mallrash së bashku me instruksionet përkatëse për pagesë. 1. D/P – Dorëzim i dokumenteve kundrejtë pagesës së menjëhershme nga Importuesi (Blerësi) 2.

D/A – Dorëzim i dokumenteve kundrejtë pranimi të tij për të kryer pagesën në një datë të mevonshme. Në këto transaksione bankat ndërmjetësojnë vetëm përmbushjen e instruksioneve për pagesë, por nuk mbajnë përgjegjësi për kontrollin e dokumenteve të eksportuesit.

Pyetjes se sa është përafërshish numri i klienteve që i përdorin këto instrumente, ekspertët i janë përgjigjur sipas tabelës me poshtë:

Tabela 6 Numri i klientëve që përdorin financat tregtare Burimi: Autori

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
0-10 kliente				x				
10-30 kliente		x	x					x
30-50 kliente								
50-70 kliente	x							
70-100 kliente					x			

Duket qartë se numri i klientëve është shumë i ulët. Eksperti i Credins Bankë shprehet se ka shumë pak klientë që përdorin këto lloj instrumente në Shqipëri për tregtinë, 0-10 klientë. ABI dhe ALPHA bank po ashtu kanë një numër të ulët, 10-30 klientë, në krahasim me numrin e bizneseve kliente që kërkojnë financim prej tyre. BKT dhe Intesa Sanpaolo Bank kanë numrin më të madh të klientëve 50-70 dhe 70-100 klientë, por përsëri është një numër i ulët që përkthehet automatikisht në një numër i ulët transaksionesh, rrezik i lartë i transaksioneve dhe besueshmëri e ulët ndërmjet palëve. Në krahasim me numrin e bizneseve Shqipëtare që operojnë në tregun ndërkombëtar dhe që kërkojnë të financohen

nga bankat apo thjesht të nënshkruajnë një dokument që i siguron një transaksion të sigurt numri i bizneseve është i ulët.

Ekspertët e bankave shprehen se vetëm 30% e totalit të bizneseve që marrin pjesë në tregtinë e jashtme të Shqipërisë i përdorin financat e tregtisë dhe instrumentet e tyre.

Kjo vërteton edhe të dhënat e publikuara në lidhje me përdorimin e instrumenteve financiare të financave të tregtisë për Shqipërinë ku WEF e rendit Shqipërinë në vendin 115 nga 150 vende të marra në shqyrtim për vitin 2015-2016. Vlerësimi i WEF për disponueshmërinë e instrumenteve të financave të tregtisë nga 1-7(shume) 3.745 për vitin 2015- 2016.

Pyetjes se i përdorin më së shumti në eksport apo në import, ekspertët përgjigjen si tabela më poshtë:

Tabela 7 Destinancini i përdorimit të instrumenteve të financave tregtare Burimi: Autor

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
0-20%	Eksport		Eksport	-	Eksport	-	Eksport	Eksport
20-40%		Import Eksport		-		-		
40-60%				-		-		
60-80%				-		-		
80-100%	Import		Import	-	Import	-	Import	Import

Bankat në Shqipëri i përdorin instrumentet e financave të tregtisë në një masë mbi 80 nga 100 transaksione për importe dhe pjesën tjetër për eksporte. Ekspertët shprehen se këto instrumente kërkohen vetëm kur i këkon patneri/ bashkëpunëtori jashtë vendit, pra eksportuesi. Vetëm ABI bank përdor ato në një masë të barabartë për eksport dhe import. Ekspertët shprehen se bizneset që i njohin i evitojnë këto instrumente për shkak të kostove duke i marrë vetë rreziqet përsipër duke i shkaktuar edhe më shumë kosto indirekte që ata nuk i kuptojnë.

Si duket edhe nga shpërndarja e përdorimit të instrumenteve në drejtim të eksportit dhe në drejtim të importit ka një disbalancim në drejtim të importeve. Kjo do të thotë se kushtet e tregut nuk janë shumë të favorshme për zhvillimin e financave të tregtisë. Kushtet e tregtisë konsiderohen nga ekonomistët një faktor i cili kushtëzon zhvillimin e financave të tregtisë. Sasia e flukseve tregtare është një tregues i mirë i nivelit të nevojës për instrumentet e financave të tregtisë. Duke rritur orjentimin e exporteve dhe të flukseve tregtare në afatgjatë krijohet një mjedis i përshtatshëm për zhvillimin e financave të tregtisë.

Pyetjes se sa është përafersisht koha e aprovimit i janë përgjigjur si më poshtë:

Tabela 8 Koha mesatare e aprovimit të instrumenteve Burimi: Autori

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
5-10 dite		x		-		-		
10-20 dite				-		-		
20-30 dite	x		x	-	x	-		
1-2 muaj	x			-		-		

Koha mesatare e aprovimit të instrumenteve dhe financimit nëpërpjet tyre ose jo është një muaj por ka raste që nevojitet edhe më shumë, dhe këtë e aprovojnë të gjithë ekspertët përvec ABI bank e cila ka një kohë të ulët të aprovimit deri në 10 ditë pune.

Kjo tregon cilësinë e institucioneve financiare, mënyrën se si e trajtojnë instrumentin si hua të zakonshme, apo aftësia e ekspertëve dhe si pjesë e faktorëve që kushtëzojnë financimin e tregtisë duket se ka mundësi të ulët koha e aprovimit të instrumenteve. Ky argument mbështetet nga koha e aprovimit të instrumenteve nga ABI bank, e cila është një bankë relativisht e re në tregun Shqipëtar. Instrumentet e financimit të tregtisë nuk trajtohen si kredi të zakonshme sepse afati i tyre i shlyerjes në bankë është e ulët, 30-90 ditë. Zakonisht nevoiten faturat e porosive dhe aprovimi i instrumentit nga banka pritëse.

Pyetjes se cilët biznese financoni më shumë, (biznes i vogël, i mesëm, i madh.), ekspertët i janë përgjigjur:

Tabela 9 Madhësia e biznesit që përdorin financat tregtare Burimi: Autor

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
0-20%	5% (i vogël)			-	i vogël	-		
20-40%	35% i madh		i mesëm	-		-		
40-60%	i mesëm			-	i mesëm i madh	-		
60-80%			i madh	-		-		
80-100%				-		-		

Në rastin e bashkëpunimit me madhësinë e bizneseve bankat kanë eksperiencë të ndryshme. Po supozojmë se Intesa Sanpaolo Bank nga 70 klientët që përdorin instrumentet e financave të tregtisë 4 janë biznese të vogla, 24 janë me bizneset e mëdha dhe 42 me bizneset e mesme.

Banka BKT. Supozojmë se numrin klientëve është maksimal, pra 100, ku më pak se 20 janë biznese të vogla, 40 të mesme dhe 40 të mëdha. Për ABI Bank 6 biznese nga 30 që supozohet numri maksimal i bizneseve të cilët përdorin instrumentet e financave të tregtisë janë të mesme dhe 24 të mëdha.

Ndërsa për bankat e tjera janë shumë pak biznese të cilët i kërkojnë këto lloj instrumentesh.

Pyetjes se keni biznese të preferuar me të cilët operonibankat janë pëgjigjursi më poshtë:

Tabela 10 Lloji i biznesit që përdorin financat tregtare Burimi: Autori

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
0-20%		-		-	agro	-		
20-40%	sherbime	-	sherbime	-	sherbime	-		
40-60%		-		-	prodhim	-		
60-80%	prodhim	-	prodhim	-		-		
80- 100%				-		-		

Në rastin e përdorimit të instrumenteve të financave të tregtisë sipas llojit të biznesit, bizneset e prodhimit i përdorin me së shumti këto instrumente, në 60-80% të rasteve, deri në 40% në shërbime të rasteve dhe biznese agro vetëm në BKT bank perdoret ne 20% të rasteve. Bankat e tjera shprehen se nuk kanë preferenca në llojin e biznesit, por nuk kanë një statistikë për t'iu përgjigjur pyetjes.

Banka Intesa Snpaolo Bank i përdor 20% të instrumenteve për eksport me bizneset e fasonit dhe naftës, të cilat bëjnë pjesë në prodhim dhe pjesën tjetër për biznese prodhuese por për import. Banka të tjera nuk japin të dhëna.

Pyetjes se cfarë kapitali kërkoni si kolateral më shpesh ekspertët e bankave i janë përgjigjur si në tabelën më poshtë:

Tabela 11 Lloji I kolateralit që kërkohet për instrumentet e financave tregtare Burimi :Autori

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
0-20%	Llogari, depozita	-		-	Asete + Llogari, depozita	-		
20-40%		-	Prona	Llogari, depozita		-		
40-60%		-		-		-		
60-80%	Prona	-	Llogari, depozita	Prona	Prona	-		
80-100%				-		-		

Kolaterali që kërkohet më së shumti kur financimi bëhet nga banka janë pronë në 80% të rasteve dhe depozita deri në 20% të rasteve. Kështu nëse në bankën BKT kemi përafërsisht 100 klientë që përdorin instrumentet për financimin e tregtisë 80 prej tyre duhet të kenë një pronë të patundshme për kolateral dhe 20 duhet të kenë një depozitë. Kjo varet edhe nga shuma e kërkuar duke marrë parasysh edhe rrezikun e bankës. E njëjta llogjikë përdoret edhe në bankat e tjera.

Pyetjes se a keni shtete te preferuara që operoni, ekspertet i janë përgjigjur:

Tabela 12 Rajonet ku përdoren më shpesh instrumentet e financave tregtare Burimi :Autori

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
0-20%	Kine etj	-		-	Tjera	-		
20-40%	Ballkan	-				-		
40-60%	BE	-		-		-		
60-80%		-			BE	-		
80-100%			BE	BE		-		

Ekspertën shprehen se shumica e instrumenteve lëshohen ndrejt vendeve të BE në 80-100% të rasteve për Alpha dhe Credins Bank, deri në 60% për Intesa Sanpaolo Bank dhe Deri në 80 % për BKT Bank. Ekspertët e bankave shprehen se bashkëpunëtorët e vendeve të BE pothuaj i detyrojnë bashkëpunëtorët Shqipëtarë për të përdorur këto instrumente ndërsa drejt Kinës dhe vendeve te Ballkanit evitohen për të minimizuar kostot. Bashkëpunimi me vendet e OECD është i ulët për shkak të rrezikut të lartë të vendit për Shqipërinë, shprehen ekspertët.

Kjo ndodh sepse perceptimi i gjendjes financiare të vendit nga pikëpamja e tregjeve ndërkombëtare mund të ketë ndikim shumë konkret në zhvillimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve financave të tregtisë. Për shembull, Standard dhe Poor-së dhe Moody, dy agjenci ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë, sugjeron një rrezik të lartë në detyrimet e borxhit të qeverisë, i cili ka ndikime të forta në kursin e këmbimit. Kjo e bën huamarrjen e eksportuesit më të shtrenjtë, interesi do të rritet, dhe një zhvlerësim i mëvonshëm i monedhës do të ketë efektin e rritjes së shlyerjes së borxhit të huaj për kompanitë private

dhe publike. Përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë minimizon rrezun politik, të kursit të këmbimit etj. Si i kemi përmendur në kapitullin e dytë.

Pyetjes se ka kufizime në kohë, dokumenta, financa bankat i janë përgjigjur:

Tabela 13 Dokumentacioni i kërkuar për instrumentet e financave tregtare

Burimi :Autori

Financim nga biznesi		Financim nga banka
Dokumentacion minimal		Dokumentacion sipas marrëveshjes
Koha me e shkurtër e aprovimit ,		Koha me e gjatë e aprovimit ,
Ska kufizime në financim sipas madhësisë të biznesit dhe marrëveshjes,		Kufizime në financim sipas madhësisë të biznesit , të ardhurave të biznesit, marrëveshjes,

Credins Bank. Dokumentacioni i kërkuar është në bazë të kërkesës, përshembull: nëse transaksioni kryhet me të gjithë financimin e klientit dokumentacioni është minimal por nëse klienti (importuesi) ka nevojë për financim të pjesshëm apo të plotë nga ana e bankës për të paguar ekstortuesin atëherë sasia e dokumentacionit të kërkuar është më i madh dhe koha e transaksionit zgjatet deri në plotësimin e plotë të tij nga ana e bankës së importuesit por edhe nga banka e eksportuesit.

Dokumentacioni dhe koha e nevojshme për të përfituar këto lloj instrumentesh në BKT varen nga lloji i kolateralit. Nëse ai është kesh dokumentacioni është minimal dhe koha e përfitimit është më e ulët sesa në rastin kur kërkohet një financim i plotë nga banka dhe kolaterali duhet të jetë një pronë e paluajtshme (koha e përfitimit me e gjatë dhe dokumentacioni i kërkuar më i madh).

Raifaisen Bank Albania. Dokumentacioni i kërkuar varet nga rasti, vendi dhe banka pritëse (banka e palës tjetër në marrëveshje). Megjithatë procedurat janë të shumta dhe kufizimet në kohë, financa, dhe dokumentacion gjithashtu.

Dokumentacioni i kërkuar për LC. Për të nisur procedurën e lëshimit të një Letër Kredie në bankën Raiffeisen, klienti duhet të depozitojë në bankë një kopje të skanuar të marrëveshjes tregtare të firmosur mes paleve ose faturën paraprake (Proforma Invoice) të lëshuar nga Shitësi. Alternativat e Financimit. Letër Kreditë mund të financohen me kolateral cash të siguruar nga aplikanti ose aplikanti mund të aplikojë për një linjë financimi në bankë. Garancia Bankare është një angazhim i pakthyesëm me shkrim i bankës lëshuese (garantori), i lëshuar në emër të aplikantit dhe në favorin e palës përfituese, për të kryer pagesën deri në shumën e specifikuar në garanci në favorin e përfituesit, kundrejt marrjes së një kërkesë të rregullt për pagësë, me shkrim nga përfituesi, në rastin e mospërmbushjes nga ana e aplikantit të detyrimit që është objekt i kësaj garancie. *Dokumentacioni i kërkuar për Garancitë Bankare.* Në varësi të llojit të garancisë së kërkuar klientët e Raiffeisen Bank sa duhet të dorëzojnë në bankë kopje të skanuar të kontratës së nënshkruar mes palëve ose një dokument justifikues për marrëdhënien mes tyre dhe objektin e garancisë së kërkuar. Garancitë Bankare mund të financohen me kolateral cash të siguruar nga aplikanti ose aplikanti mund të aplikojë për një linjë financimi në bankë.

Pyetjes se i ndihmojnë biznesin për të kryer transaksione të sigurta ekspertët i janë përgjigjur:

Nga 1(aspak) - 4(shumë): të gjitha bankat janë përgjigjur unanimitet se instrumentet e financave të tregtisë i ndihmojnë shumë (4) bizneset të kryejnë transaksione të sigurta.

Ky fakt është në përputhje të plotë me teorinë dhe me autorët që e kanë vlerësuar çështjen.

Pyetjes se sa e vlerësoni edukimin e biznesit në përdorimin e këtyre instrumenteve ekspertët i janë përgjigjur:

Nga 1(aspak) - 4 (shumë): të gjitha bankat janë përgjigjur unanimitet se edukimi i biznesit Shqipëtar në përdorimin e këtyre instrumenteve është 2 (pak).

Por jo vetëm bizneset apo biznesmenët nuk i njohin dhe rrjedhimisht nuk i përdorin por edhe financierët (kjo do të thotë mungesë në formim/arsim) e bizneseve nuk i njohin, rrjedhimisht nuk i përdorin në punën e tyre të përditshme dhe kështu nuk informojnë

investitorin se si të mbrohen nga rreziku dhe nga mungesa e vazhdueshme e likuiditetit. Ekspertë e bankave shprehen se manualët dhe rregulloret e përdorimit të këtyre instrumenteve i kanë blerë online dhe privatish. Kjo do të thotë se nuk ndiqet një politikë konkrete nga ana e bankës qendrore për cështjen në fjalë. Si rrjedhojë e së gjithës mund të themi se edhe politika e Bankës Qendrore në Shqipëri është një faktor kyc për zhvillimin e financave të tregtisë.

Pyetjes se sa e vlerësoni formalizimin e biznesit në Shqipëri ekspertët i janë përgjigjur:

Nga 1(aspak) - 4 (shumë): të gjitha bankat janë përgjigjur unanimitet se formalizimi i biznesit në Shqipëri është i ulët dhe vlerësohet me 2 (pak).

Ky është një nga faktorët problematik që kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë duke filluar nga problemet me pronën dhe deri te pagesa e taksave apo problemet me bilancet në Shqipëri. Për të vazhduar më tej me korrupsionin në institucione dhe organizata i cili prish gjithë zinxhirin e vlerave dhe të meritokracisë. Këto bëjnë që dhe qasja në financim të jetë e ulët duke qënë në përputhje të plotë me të dhënat e publikuara nga WEF ku qasja në financim është faktori i dytë më i rëndësishëm pas taksave që pengon zhvillimin e biznesit.

Korrupsioni në institucione dhe fortësia e tyre cojnë në destabilitet që në teori konsiderohet si rreziku politik apo rreziku i vendit dhe konsiderohet si faktor që ndikon apo kushtëzon zhvillimin e financave të tregtisë në tregun Shqipëtar.

Pyetjes se ka kufizime ligjore apo jo në ofrimin e instrumenteve të tregtisë ekspertët i janë përgjigjur:nga 1(aspak) -4(shumë)

Nuk ka kufizime ligjore në ofrimin e instrumenteve të tregtisë dhe vlerësohet me 1.

Ekspertët shprehen se këto instrumente trajtohen si kreditë e zakonshme nga pikëpamja ligjore.

Si mendoni sa i kushtëzojnë faktorët e renditur më poshtë përdorimin e këtyre instrumenteve? 1(aspak) - 4 (shumë):

Tabela 14 Vlerësimi i faktorëve që kushtëzojnë financat tregtare në Shqipëri Burimi:

Autori

	Intesa Sanpaolo Bank	ABI Bank	Alpha Bank	Credins Bank	BKT Bank	Raifaisen Bank	Veneto Bank	FI Bank
Kushtet e tregtise	4	4	4	3	4			
Politika monetare	4	3	2	2	4			
Zhvillimi i sistemit financiar	3	3	2	4	4			
Kostot e huamarrjes	3	3	2	3	3			
Institucionet Financiare	4	4	3	2	3			
Mjedisi ligjor	1	1	1	2	2			
Pengesat ne kreditim apo capital	3	4	3	3	-			
Borxhi i jashtem i vendit	3	2	-	3	3			
Kursi i kembimit	3	2	3	1	1			
Rreziku i vendit	4	4	4	4	4			

Kushtet e tregtisë sipas ekspertëve janë të disfavorshme për përdorimin e instrumenteve financiarë për tregtinë, duke e kushtëzuar atë, duke e konsideruar një faktor kyc në sasinë e përdorimit të tyre dhe duke e vlerësuar me 4 (shumë).

Politika monetare vlerësohet si një faktor që e kushtëzon mjaftueshëm përdorimin e tyre në Shqipëri dhe vlerësohet nga ekspertët me 3 (Mjaftueshëm). Që do të thotë se politika monetare e Shqipërisë e kushtëzon mjaftueshëm përdorimin e ketyre instrumenteve.

Zhvillimi i sistemit financiar vlerësohet me 3 nga ekspertët e bankave, që do të thotë se zhvillimi i sistemit financiar është mjaftueshëm i rëndësishëm për përdorimin e tyre dhe e

kushtëzojnë po aq nëse nuk është në nivelet e duhura në krahasim me vendet e tjera. Megjithatë ekspertët thonë se zhvillimi bankar është optimal për përdorimin e instrumenteve por faktorët ndërthuren me njëri tjetrin dhe krijojnë atë që quhet kushtëzim të përdorimit të tyre.

Kostot e huamarrjes konsiderohen se e kushtëzojnë përdorimin e instrumenteve mjaftueshëm dhe vlerësohen me 3 nga ekspertët bankave Shqipëtare. Si u sqarua dhe më lartë kosto të larta të instrumenteve krijojnë ulje të kërkesës për to.

Institucionet financiare konsiderohen se e kushtëzojnë mjaftueshëm përdorimin e instrumenteve mjaftueshëm dhe vlerësohen me 3 nga ekspertët bankave Shqipëtare. Ata thonë se korrupsioni në institucione financiare nuk kushtëzon vetëm përdorimin e këtyre instrumenteve.

Mjedisi ligjor konsiderohet i mirë në Shqipëri dhe nuk ka pengesa në përdorim. Ekspertët vlerësojnë se mjedisi ligjor e kushtëzon përdorimin e tyre 1 (aspak ose me raste pak). Cilësia e ligjeve të tregtisë, miratimi i rregullave ndërkombëtare, efektiviteti dhe zbatimi i ligjeve të falimentimit, standardeve dhe aftësia e sistemit ligjor për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tregtisë në kohën e duhur dhe transparente mund të ndikojë në zhvillimin dhe disponueshmërinë e financave të tregtisë. Gjithashtu, zhvillimi mund të lehtësojë dhe zvogëlojë koston dhe kohën që lidhen me kërkesat ligjore.

Pengesat në kreditim apo kapital pengesat në kreditim janë të mjaftueshme për shkak të informalitetit të bizneseve dhe korrupsionit, pronësisë dhe jo ligjore. Ekspertët e vlerësojnë me 3.

Kursi i këmbimit e kushtëzon pak përdorimin e instrumenteve dhe vlerësohet me 2.

Rreziku i vendit edhe pse nuk është vënë në pyetësor direkt por është pyetur indirekt, ekspertët këmbëngulin se është faktori kyc që kushtëzon përdorimin e instrumenteve financiare për tregtinë.

5.2. Përmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull është shpjeguar mënyra se si është shfrytëzuar për këtë studim, të dhënat e pëdorura dhe mënyra e mbledhjes, qëllimi i pyetësorit, lloji i pyetësorit, lloji i analizës së përdorur për interpretimin e të dhënave. Kapitulli vijon me vështirësitë për mbledhjen e të dhënave në teren. Së fundi është bërë analiza e të dhënave të mbledhura nga pyetësi në formë matricore dhe faktoriale. Në kapitullin në vijim analizohet konkurrenca e Shqipërisë në tregun global, analiza vazhdon në mënyrë të hollësishme me faktorët të cilët ndikojnë financat e tregtisë në Shqipëri. Analizohet niveli i zhvillimit të tyre dhe më pas të krahasuara me nivelin e zhvillimit vendet e huaja konstatohen se sa i kushtëzon niveli i zhvillimit të tyre financimin e tregtisë në Shqipëri. Në përfundim të kapitullit jepen fakte për natyrën e sigurt të instrumenteve të financave të tregtisë.

KAPITULLI VI: ANALIZË KRAHASUESE STATISTIKORE E FAKTORËVE QË KUSHTËZOJNË FINANCAT E TREGTISË

6.1. Konkurenca e Shqiperisë në tregun global

Konkurenca midis ekonomive në botë ka nisur shumë herët duke krijuar avantazhe kundrejt ekonomive të tjera, gjatë kohës ekonomistët i kanë quajtur: avantazh absolut, avantazh krahasues, avantazh konkurues. Kështu shtetet vazhdojnë të krijojnë avantazhe jo vetëm në investime, prodhim, kosto etj, por edhe në arsim, cilësi të institucioneve politike dhe ekonomike, infrastrukturë, lehtësi në financim për biznesin, etj. Këto avantazhe cojnë në zhvillim ekonomik të vendeve.

Indeksi global i konkurueshmërisë ndahet në tre shtylla të mëdha, që janë fazat e zhvillimit që kalon një ekonomi. Nëse një ekonmi është e udhëhequr nga faktorët e prodhimit, katër faktorët e parë zënë peshën më të madhe në indeks; nëse ekonomitë janë të udhëhequra nga efica, faktorët 5-10 zënë peshën më të madhe në indeks dhe në shtyllën e tretë ekonomitë të udhëhequra nga inovacioni, faktorët 11 dhe 12 zënë peshën më të madhe në indeksin e konkurueshmërisë.

Tabela 15 Shkallët e zhvillimit të vendit Burimi: World Economic Forum Perpunuar: autori

Shkalla e zhvillimit	Shkalla1 Te drejtuar nga faktoret	Tranzicion Shkalla 1-2	Shkalla 2 Te drejtuar nga efica	Tranzicion shalla 2-3	Shkalla 3 Te drejtuar nga inovacioni
PBB per fryme(US\$)	< 2,000	2,000-2,999	3,000-8,999	9,000-17,000	>17,000
Pesha e indeksit te Faktoreve baze	60%	40-60%	40%	20-40%	20%
Pasha e indeksit te Faktoreve te efica	35%	35-50%	50%	50%	50%
Pasha e indeksit te inovacionit	5%	5-10%	10%	10-30%	30%

Konkurrenca përcaktohet si një grup institucionevesh, politikash, dhe faktorësh që përcaktojnë nivelin e produktivitetit të një vendi. Niveli i produktivitetit, nga ana tjetër, përcakton nivelin e prosperitetit që mund të fitohet nga një ekonomi. Niveli i produktivitetit gjithashtu përcakton normat e kthimit të marra nga investimet në një ekonomi, të cilët janë shoferët themelorë të normave të saj të rritjes. Me fjalë të tjera, një ekonomi më konkurruese është ajo që ka rritjen të mbështetur (TheGlobalCompetitivenessReport,2005-2015).

Dymbëdhjetë shtyllat e indeksit janë si më posht:

Institucionet e forta dhe transparente, me nivel të ulët të burrokracisë dhe korrupsionit ndikojnë në zhvillim dhe konkurrueshmërinë e vendit.

Infrastruktura efikase është e rëndësishme për të siguruar funksionimin efektiv të ekonomisë, pasi ajo është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e vendndodhjes së veprimtarisë ekonomike dhe llojet e aktiviteteve apo sektorë që mund të zhvillohen. Infrastruktura e mirëzhvilluar zvogëlon efektin e distancës midis rajoneve, integrimin e tregut kombëtar dhe e lidh atë me kosto të ulët në tregjet në vendet e tjera dhe rajone. Përveç kësaj, cilësia e rrjeteve të infrastructures rrit dukshëm ndikimin e rritjes ekonomike dhe redukton pabarazitë në të ardhura dhe varfërinë në një shumëllojshmëri të mënyrash.

Stabiliteti i mjedisit makroekonomik është e rëndësishëm për biznesin dhe, prandaj, është e rëndësishme për konkurrencën e përgjithshme të një vendi. Edhe pse është e sigurt se stabiliteti makroekonomik i vetëm nuk mund të rrisë produktivitetin e një kombi, ajo që është e sigurt se paqëndrueshmëria makroekonomike dëmton ekonominë, siç e kemi parë gjatë viteve të fundit, veçanërisht në kontekstin evropian.

Forca punëtore e shëndetshme është jetike për konkurrencën e një vendi dhe produktivitetin. Punëtorët të cilët janë të sëmurë nuk mund të kontribuojnë në potencialin e tyre dhe do të jetë më pak produktiv.

Arsimi i Lartë dhe Cilësi e lartë trajnimi është veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë që duan të lëvizin deri në zinxhirin e vlerës përtej proceseve të thjeshta të

prodhimit. Në veçanti, ekonomia e globalizuar kërkon punëtorë të mirë-arsimuar të cilët janë në gjendje për të kryer detyra komplekse dhe për tu përshtatur me shpejtësi kur mjedisi i tyre ndryshon dhe nevojat evoluojnë në ekonomisë.

Efikasiteti i tregut dhe efikasiteti i tregjeve të mallrave bën që të prodhohet përzierja e duhur të produkteve dhe shërbimeve të tyre të diktuar nga ofert-kerkesa. Konkurrenca e shëndoshë të tregut, vendas dhe të huaj, është e rëndësishme në efikasitetin e tregut dhe kështu produktivitetin e biznesit, duke siguruar që firmat më efikase, të prodhojnë mallrat e kërkuara nga tregu.

Efikasiteti dhe fleksibiliteti i tregut të punës janë rëndësishme për të kuptuar që punëtorët janë ndarë në mënyrën më efektive në ekonomi duke përdorur aftësitë e tyre atje ku duhet. Tregjet e punës për këtë arsye duhet të kenë fleksibilitet në zhvendosjen e punëtorëve nga një aktivitet ekonomik në tjetrin me shpejtësi dhe me kosto të ulët, duke lejuar luhatjet e pagave.

Zhvillimi i tregut financiar. Kriza e fundit ekonomike ka nënvizuar *rolin* qendror të shëndoshë dhe mirë-funksionues të sektorin financiar për aktivitetet ekonomike. Një sektor efikas financiar alokon burimet e ruajtura nga qytetarët e një kombi, si dhe ato që hyjnë nga ekonomitë e tjera. Një vlerësim i plotë dhe i duhur i rrezikut për këtë arsye është një përbërës kyç i një tregu të shëndoshë financiar. Investimet e biznesit janë gjithashtu kritike për të pasur produktivitet. Prandaj ekonomitë kërkojnë tregje të sofistikuara financiare që mund jenë në dispozicion të sektorit privat për investime nga burime të tilla si kreditë nga një sektor bankar të shëndoshë, të mirë-rregulluar për shkëmbimet e letrave me vlerë, e kapitaleve, dhe *produkteve të tjera financiare*. Në mënyrë që të përmbushë të gjitha ato funksione, sektori bankar duhet të jetë i besueshëm dhe transparent, gjithashtu tregjet financiare kohët e fundit kanë nevojë për rregullim të përshtatshëm për të mbrojtur investitorët dhe aktorët e tjerë të ekonomisë në përgjithësi.

Në botën e sotme të globalizuar, teknologjia është gjithnjë e më thelbësore për firmat që konkurrojnë dhe duan të mbijetojnë. Gadishmëria mat aftësinë me të cilën një ekonomi adopton teknologjinë për të rritur produktivitetin e industrive të saj, për të rritur

kështu kapacitetin e saj për të rritur komunikimin me eknologjinë informacionin (TIK) në aktivitete të përditshme dhe procese të prodhimit. Kjo con në rritjen e efikasitetin dhe mundësimin e inovacionit për konkurueshmeri.

Madhësia e tregut ndikon në produktivitet, tregjet e mëdha lejojnë firmat për të shfrytëzuar ekonomitë e shkallës. Tradicionalisht, tregjet në dispozicion për firmat kanë qenë të detyruar nga kufijtë kombëtarë. Edhe pse reduktimi i barrierave tregtare dhe harmonizimi i standardeve në kuadër të Bashkimit European kanë kontribuar në rritjen e eksporteve brenda rajonit, ka ende shumë pengesa për të qënë një treg i vetëm, në veçanti në shërbime. Kështu eksportet mund të mendohet si një zëvendësim për kërkesën e brendshme në përcaktimin e madhësisë së tregut për firmat e një vendi.

Sofistikimi i biznesit- Praktikrat e biznesit të sofistikuar janë të favorshme për efikasitet më të lartë në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve. Sofistikimi i biznesit ka të bëjë me dy elemente që janë të lidhura pazgjidhshmërisht: cilësia e rrjeteve të përgjithshme të biznesit dhe cilësinë e operacioneve të firmave individuale dhe strategjitë. Këta faktorë janë veçanërisht të rëndësishëm për vendet në një fazë të avancuar të zhvillimit, kur, në një masë të madhe, burimet më themelore të përmirësimit të produktivitetit janë shteruar.

Risitë mund të dalin nga njohuritë e reja teknologjike dhe jo teknologjike. Inovacionet teknologjike janë të lidhura ngushtë me know-how, aftësitë dhe kushtet e punës që janë të përfshira në organizata. Edhe pse fitimet e konsiderueshme mund të merret me përmirësimin e institucioneve, ndërtimin e infrastrukturës, duke reduktuar jostabilitetin makroekonomik, ose përmirësimin e kapitalit njerëzor (The Global Competitiveness Report,2005-20015)

Indikatori i zhvillimit financiar në ekonomi prej vitesh konsiderohet si një indikator i rëndësishëm në lidhje me cilësinë e të bërit biznes. Ky indikator konsiderohet një nga 12 shtyllat kryesore të krijimit të avantazhit konkurrues midis shteteve, të cilat duke ndërvepruar me njëra tjetrën ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Raportet vjetore të Forumit Ekonomik Botëror publikojnë të dhëna të ecurisë së këtij indeksi për 144 vende si pjesë e indeksit global të konkurrueshmërisë, ku ndër to edhe zhvillimi financiar i Shqipërisë.

Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë është i udhëhequr nga efienca ku përfshihen faktorë si: edukimi, efienca e tregut dhe e mallrave, efienca e tregut të punës, zhvillimi i tregut financiar, aftësia teknologjike dhe madhësia e tregut. Në të njëjtën fazë janë edhe Bullgaria, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi etj.

Nëse shohim renditjen e këtij indeksi për Shqipërinë, në një renditje të 144 ekonomive të botës, ajo renditet e 97 – ta për vitin 2014-2015, 93 –ta në 2015-2016. Duke zbritur në renditje në krahasim me vitet e kaluara, psh. në vitin 2011-2012 ajo renditej e 78-ta. Kjo tregon për një ritëm zhvillimi të ulët të ekonomisë Shqipëtare në krahasim me vendet e tjera.

Po kështu Shqipëria nuk performon mirë as për nën indekset e tjera të fazës së zhvillimit ekonomik ku ndodhet duke zbritur gjithnjë në renditje duke përfshirë këtu edhe indeksin e zhvillimit financiar por edhe për nën indeksin e tij, disponueshmërinë e instrumentave financiarë për biznesin, të cilët i shërbejnë këtij punimi për të kuptuar se zhvillimi i tyre jo vetëm që rrit flukset tregtare por i ndihmon tregtarët në menaxhimin e rrezikut të vendit.

Analizimi i aftësisë konkurruese të vendit, fazes së zhvillimit të vendit dhe faktorëve që zënë peshën kryesore në të, na ndihmojnë në analizimin e çështjes duke parë konkretisht se pse nuk përdoren mjaftueshëm instrumentet e financave të tregtisë në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera? Cilët janë faktorët që e ndikojnë dhe kushtëzojnë financat e tregtisë në Shqipëri?

6.2. Analizë krahasuese e faktorëve të mjedisit makroekonomik që kushtezojnë financat e tregtisë në jashtme në Shqipëri

6.2.1. Situatës së tregtisë

Nga teoria ekonomia e një vendi duhet të jetë e orientuar nga eksportet dhe duhet të ketë flukse tregtare të konsiderueshme për të patur një përdorim të lartë të instrumenteve të financave të tregtisë. Si një nga faktorët që ndikojnë kërkesën dhe përdorimin e instrumenteve të financave të tregtisë ndikon në zhvillimin e saj. Pra Shqipëria duhet të rrisi orjentimin drejt eksporteve dhe të flukseve tregtare në afatgjatë për të krijuar një mjedis i përshtatshëm për zhvillimin e financave të tregtisë.

Në bazë të të dhënave të publikuara për tregtinë e Shqipërisë eksportet në pesë vitet e fundit (2012-2016) kanë ndjekur një trend rritës, duke përfshiruar vitin 2015, në të cilin ato kanë pësuar ulje. Rritja mesatare e eksporteve rezulton me 4,6 %. Nga ana tjetër, importet gjatë këtij 5 vjeçari kanë patur një ecure të luhatshme e cila ka rezultuar në një rritje mesatare 1,4 %. Defiçiti tregtar është përmirësuar, duke shënuar ulje mesatare vjetore me 0,2 %.

Sikurse shihet edhe nga tabela bilanci tregtar i Shqipërisë është negativ, domethënë Shqipëria është një vend që importon më shumë sesa eksporton.

Tabela 16 Tregtia në Shqipëri 2012-2016 Burimi: Instat

	2012	2013	2014	2015	2016
Eksporte (milion lekë)	213.030	246.397	255.759	243.183	243.498
Ndryshimi vjetor (%)	8,2	15,7	3,8	-4,9	0,1
Importe (milion lekë)	528.490	517.378	552.281	544.606	579.248
Ndryshimi vjetor (%)	-2,9	-2,1	6,7	-1,4	6,4
Bilanci tregtar (milion lekë)	-315.460	-270.981	-296.522	-301.423	-335.750
Volumi tregtar (milion lekë)	741.520	763.775	808.040	787.789	822.746
Përqindja e mbulimit	40,3	47,6	46,3	44,7	42,0


Por a vërteton kjo se ky faktor kushtëzon vërtet financat e tregtisë dhe përdorimin e instrumenteve të saj? Kjo mund të përcaktohet nëse krahasojmë bilancin tregtar të Shqipërisë me atë të vendeve partnere në tregti. Pra më parë duhen përcaktuar se cilët janë partneret kryesorë në tregti të Shqipërisë.

Nga grafiku shihet se partneri më i madh i Shqipërisë për destinacionin e eksporteve është Italia, me 54,6% të eksporteve. Më pas vjen Kosova, me 6,8 % dhe Greqia me 4,6% të eksporteve. Pastaj, vijnë Maqedoni, Mali Zi, Turqi, Gjermani, Kinë, Spanjë, Maltë.


Konfigurimi i shteteve për importet ndryshon. Nga grafiku i mëposhtëm shohim se partneri më i madh në importe për shqipërinë janë Italia, me 29,3%, Rusia, Kina, Gjermani etj.

Nga grafikët vërehet se vendet partneret kryesorë janë po ata qysh nga 2012 por ka ndrryshuar sasia e flukseve tregtare që shkënbejnë me Shqipërinë.

Grafiku 1: Eksportet sipas vendeve partnere kryesore Burimi INSTAT



Grafiku 2 Importet sipas vendeve partnere kryesore Burimi INSTAT



Meqënëse, sasia e flukseve tregtare dhe bilanci tregtar pozitiv janë tregues të mirë të nivelit të nevojës për instrumentet e financimit të tregtisë i krahasojmë me volumin dhe bilancin tregtar të vendeve partnere për të evidentuar nëse këta faktor kushtëzojnë përdorimin e saj.

Nga tabela e mëposhtme shohim se Maqedonia, Malta, Turqia, Spanja, Mali i Zi, ShBA, UK, kanë bilanc negativ tregtar por kanë përdorim më të lartë të financave të tregtisë (shih tabelën17). Në të kundërt Kina, Gjermania, Italia kanë bilanc tregtar pozitiv por edhe përdorimin e financimit të tregtisë e kanë të lartë. Kështu themi se bilanci tregtar nuk është një faktor i cili kushtëzon përdorimin e financimit të tregtisë. Nga teoria dimë se tregtarët i përdorin për të patur transaksione të sigurta dhe pagesa të sigurta, gjithashtu. Përdorimi i tyre rritet kur vendi tregton me vende me rrezik të lartë të vendit dhe kur marrëdhëniet me partnerët në tregti janë relativisht të reja ose të reja. Kështu, bilanci negativ tregtar i Shqipërisë nuk shpreh ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me përdorimin e financave të tregtisë së jashtme.


Po, sasia e flukseve tregtare i cili është një tregues i mirë i nivelit të nevojës për instrumentet e financimit të tregtisë e kushtëzon përdorimin e instrumenteve të tregtisë së jashtme? Volumi tregtar i Shqipërisë është i ulët në krahasim me volumin tregtar të vendeve partnere (shih tabelën më lartë) dhe përdorimi i financave të tregtisë është i ulët në krahasim me përdorimin e financat të tregtisë me vendet e tjera. Si rrjedhim mund të themi se, volumi tregtar ka një lidhje të drejtë me financat e tregtisë të vendeve. Sa më shumë trensankcione tregtare aq më i lartë numri i instrumenteve të përdorur për financimin e tregtisë së jashtme.

Tabela 17 Bilanci tregtar i vendeve kryesore partnere të Shqipërisë

Burimi: Trademap Përpunimi: Autori

Bilanci tregtar në dollar amerikan	20013	2014	2015	2016	Eksporte 2016	Importe 2016
Gjermani	263,636,300	283,202,100	270,932,748	280,080,029	1,340,752,046	1,060,672,017
Itali	38,758,750	55,446,174	46,055,456	56,951,428	461,529,407	404,577,979
Maqedoni	-2,320,820	-2,337,211	-1,909,889	-1,972,418	4,784,605	6,757,023
UK	-	-	-	-	415,856,497	635,569,887
	109,180,675	183,198,880	163,955,375	219,713,390		
Shtetet e Bashkuara	-	-	-	-	1,453,167,148	2,249,660,890
	749,002,900	791,112,600	811,578,705	796,493,742		
Spanjë	-21,303,198	-32,328,461	-27,144,022	-20,762,200	281,776,674	302,538,874
Turqi	-99,858,613	-84,566,959	-63,356,133	-55,995,687	142,606,247	198,601,934
Kine	259,015,000	384,321,700	600,185,106	530,284,715	2,118,980,582	1,588,695,867
	-2,505,605	-3,888,556	-3,211,881	-3,179,816	3,016,407	6,196,223
Malte						
Mali Zi	-1,854,497	-1,926,092	-1,697,090	-1,908,448	354,316	2,262,764

Grafiku 3 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin Burimi :WEF Përpunimi :Autori



6.2.2. Borxhi publik

Raporti i borxhit të përgjithshëm të qeverisë ndaj PBB-së është shuma e borxhit të përgjithshëm bruto të një vendi si përqindje e PBB-së së saj. Ky është një tregues i shëndetit të një ekonomie dhe një faktor kyç për qëndrueshmërinë e financave qeveritare. "Borxhi" zakonisht përkufizohet si një nëngrup i veçantë i detyrimeve të identifikuar sipas llojeve të instrumenteve financiare të përfshira ose të përjashtuara. Kështu, borxhi merret si shuma e kategorive të mëposhtme të detyrimeve (sipas rastit): monedha dhe depozitat; Letra me vlerë përveç aksioneve, përveç derivateve financiare; kredi; Rezervat teknike të sigurimit; Dhe llogari të tjera të pagueshme. Ndryshimet në borxhin e qeverisë me kalimin e kohës pasqyrojnë ndikimin e deficiteve qeveritare. Ky tregues matet si një përqindje e PBB-së


Borxhi publik apo borxhi qeveritar i referohet detyrimeve që ka një qeveri për të paguar një shumë të caktuar në një të ardhme të caktuar ndaj mbajtësve të obligacioneve të lëshuara nga qeveria apo institucione të tjera të lidhura me të.

Borxhi publik është i ndryshëm nga borxhi privat; ky i fundit konsiston në detyrimet e individëve, të firmave të biznesit apo organizatave jo-qeveritare.

Nga teoria dimë se sa më i lartë niveli i borxhit, më të larta në të ardhmen pagesat e shërbimeve të borxhit si rrjedhim shterim në financat e brendshme (pagesat e shërbimeve të borxhit janë flukset vjetore për të mbuluar pagesat e interesit dhe principalit). Një nivel i ulët i likuiditetit kufizon aftësinë e një vendi për të importuar mallra dhe shërbime.

Kështu për të stimuluar rritjen ekonomike duhen politika që kontrollojnë shpenzimet publike dhe uljen e shpërdorimeve dhe korrupsionit. Mbështetja e biznesit, sidomos ai prodhues dhe investimet, në mënyrë që të rritet punësimi.

***Grafiku 4 Struktura e stokut të borxhit Burimi : Banka e Shqipërisë
Përpunimi :Autori***



Si e shohim edhe nga grafiku i mësipërm borxhi publik i Shqipërisë është më i lartë se kufiri i këshilluar nga organizatat ndërkombëtare. Kufiri mesatar i lejuar është 60% të PBB të vendit, por vendi ynë ka një borxh publik rreth 70% të PBB- së për vitin 2016. Duke parë grafikun nga viti 2013– 2015 borxhi është luhatur në këto shifra në 68%-70% -72% ndërsa


financimi i tregtisë për Shqipërinë është luhatur në vitin 2013 ishte 3.81552²¹, në 2014 ishte 3.54935, në 2015 ishte 3.73536. Nga të dhënat shohim se, në vitin 2015 borxhi publik është rritur në 72% të PBB ku ka pasur dhe rritjen më të madhe të tij por edhe disponueshmëria e instrumenteve të financimit të tregtisë është rritur për këtë vit.

Për të kuptuar më mirë se sa e kushtëzon borxhi publik përdorimin e instrumenteve të financimit të tregtisë së jashtme, krahasojmë borxhin publik të Shqipërisë me vendet e tjera dhe më pas me volumin e përdorimit të financave të tregtisë në këto vende.


Vendet partnere të Shqipërisë panvarësisht borxhit të lartë publik në përqindje të PBB së tyre nuk e kanë kufizuar apo ulur përdorimin e instrumenteve të financave të tregtisë. Këtë e kuptojmë qartë nga grafiku i mësipërm ku borxhi publik i partnerit tonë kryesor Italisë është dukshëm më i lartë se borxhi i Shqipërisë në përqindje të PBB-të përkatëse dhe përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë është dukshëm më i lartë (referohu grafikut më poshtë). Po kështu për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Spanjën, Greqinë dhe Gjermaninë. Në të kundërt me Turqinë dhe Zvicrën ku borxhi publik është i ulët dhe përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë është dukshëm i lartë, siguri më i lartë se Shqipëria. Kështu mund të thuhet se borxhi publik nuk tregon ndonjë lidhje të rëndësishme me përdorimin e instrumenteve të financimit të tregtisë në afatshkurtër. Rrjedhimisht borxhi publik i Shqipërisë nuk kushtëzon rritjen e mëtejshme të përdorimit të instrumenteve të financave të tregtisë.

²¹ Indeksi I publikuar në mënyrë periodike nga WEF në lidhje me disponueshmërinë e instrumenteve të financimit të tregtisë për biznesin. Indeksi tregon se sa të disponueshme janë këto instrumente nga sistemi financiar I vendeve (1(pak) -7(shume))

Grafiku 6: Borxhi publik sipas vendeve për vitin 2015 Burimi : data.oecd.org



Grafiku 7 : Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin Burimi :WEF Përpunimi :Autori



6.2.3. Investime te huaja direkte

IHD-të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në transformimin e vendeve, veçanërisht atyre post komuniste (Moose, 2000: cituar nga Zoto, Oltiana 2012). Në ndryshimin e strukturës, nënkuptojmë përparimin dhe hapjen e ekonomisë nga pikëpamja ndërkombëtare dhe orientimin në avantazhet konkurruese si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Një nga përparësitë e IHD-ve është se ato ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit ku derdhen investimet, gjejnë zbatim në vendet në zhvillim. Gjatë viteve '90-të, ato ishin një nga burimet kryesore të financimit të jashtëm për shumicën e vendeve që kishin një prespektivë rritjeje ekonomike, dhe kanë ndihmuar disa vende kur ato janë përballur me vështirësi ekonomike, gjithashtu lejojnë edhe transferimin e teknologjive e cila është bërë kryesisht në mënyrë të sigurimit të inputeve kapitale. Vendet që kanë marrë IHD nga një vend tjetër mund të zhvillojnë resurset humane të tyre, duke punësuar njerëz të rinjë në veprimtarinë e ndonjë biznesi të veçantë. Fitimet që gjenerohen nga IHD-të të cilat janë bërë në atë vend, mund të përdoren për qëllim kontributi për taksat mbi të ardhurat e korporatave të vendit marrës. IHD-të ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e pagave të punëtorëve, lehtësimin e mënyrës së jetesës etj. Investimet e huaja direkte zakonisht kontribuojnë në zhvillimin e sektorit prodhues të vendit pritës të investimeve. IHD-të luajnë një rol vendimtar në kontestin e rritjes së produktivitetit të vendeve pritëse. Kompanitë e këtyre vendeve kanë mundësi të eksplorojnë tregje të reja, të huaja dhe në këtë mënyrë të gjenerojnë më shumë të ardhura dhe fitime. Lehtësojnë aksesin në tregje të reja dhe kështu mund të kontribuojnë në rritje e eksporteve dhe të të ardhurave prej tyre. IHD-të janë një burim për financimin e deficitit në Bilancin e Pagesave duke përmirësuar kreditimin në vendet pritëse (Zoto, Oltjana, 2012).


Kështu shohim nivelin e IHD-ve në Shqipëri për të kuptuar rolin e këtij faktori në Përdorimin e instrumenteve të financimit të tregtisë në Shqipëri. Vërejmë nga grafiku se ka një luhatje të madhe të tyre në 3 vitet e fundit. E megjithatë kjo nuk tregon ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë të përdorimit të instrumenteve financiare të tregtisë dhe IHD-ve.

Grafiku 8 Niveli I investimeve të huaja direkte në Shqipëri 2014-2017 Burimi: tradingeconomics




Patnerët kryesorë të Shqipërisë në tregti kanë nivel të IHD-ve më të ulët se 50% të PBB- së vendit. Më konkretisht Gjermania 41% të PBB-së, Spanja 39% të PBB, Italia 25% të PBB-së, SHBA 34% të PBB së, Turqia 4 % të PBB-së, Greqia 16 % të PBB-së dhe Shqipëria në nivelin rreth 8% të PBB- së, për vitin 2016. Duket se ka një lidhje të drejtë të nivelit të IHD-ve me përdorimin të instrumenteve financiare të tregtisë për shumicën e shteteve. Megjithatë në rastin e Turqisë duket se përdorimi të instrumenteve financiare të tregtisë është më i lartë po ta krahasosh me nivelin e përdorimit të instrumenteve financiare të tregtisë të vendeve të tjera dhe nivelin e IHD-ve të tyre. Duket se përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë mund të rritet edhe më shumë edhe pse niveli i IHD-ve të Shqipërisë qëndron në nivelet aktuale. Pra niveli aktual i IHD-ve të Shqipërisë nuk e kushtëzon rritjen e përdorimit të financave të tregtisë.

Grafiku 9 IHD në % të PBB 2016 Burimi data.oecd.org



Grafiku 10 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin Burimi :WEF Përpunimi :Autori



6.2.4. Kursi i këmbimit

Shqipëria qysh në fillimet e tranzicionit ka adoptuar regjimin fleksibël të kurseve të këmbimit, jo vetëm thjeshtë prej rezervave të kufizuara ndërkombëtare të saj, por gjithashtu për të shmangur korrigjimet e kushtueshme të shmangieve të kursit nga nivelet "ekuilibër" siç vërehet shpesh në regjimet fikse. Shqipëria është një vend i vogël dhe përgjithësisht çmimet e produkteve i merr të dhëna nga tregu ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, kursi i këmbimit ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në çmimet e produkteve të importuara, që konsumatorët vendas blejnë. Por, lëvizjet në kursin e këmbimit, mund të ndikojnë edhe në çmimet e produkteve të prodhuara nga ekonomia vendase. Modelimet e kursit të këmbimit fokusohen mbi kursin real të këmbimit, i cili llogaritet si kursi nominal, i korrigjuar me normën e inflacionit brenda dhe jashtë vendit. Arsyeja kryesore pas kësaj është se për shkak të niveleve të ndryshme të inflacionit, kursi nominal i këmbimit nuk reflekton me saktësi fuqinë blerëse të monedhës vendase për mallra dhe shërbime të huaja. Nëse vlera e kursit e përcaktuar në treg nuk është konsistente me kursin e nënkuptuar nga një model ekonomik, atëherë ekonomistët do të parashikonin mundësinë e disa rregullimeve në treg. Një kurs real i ekuilibruar i këmbimit ndihmon në krijimin e një ambienti makroekonomik të stabilizuar, duke ndihmuar kështu në thithjen e kapitaleve të huaja, të cilat janë shumë të rëndësishme në zhvillimin ekonomik, sidomos për vendet e vogla, si Shqipëria. Luhatjet e kursit të këmbimit në vendet në zhvillim mund të ndikojnë kërkesën agregate dhe zgjerimin e investimeve, ndërsa një monedhë e mbivlerësuar ndikon negativisht punësimin. Nga ana tjetër, niveli i lartë i borxhit të jashtëm, e bën vetë borxhin të ndjeshëm ndaj lëvizjeve të RER. Një kurs real vazhdimisht i mbivlerësuar është një tregues i hershëm i krizës së mundshme të monedhës. Prandaj ekonomistët i kushtojnë rëndësi studimit të ekuilibrit të kursit real të këmbimit dhe identifikimit të variablave ekonomike, që mund t'a drejtojnë një kurs të shmangur drejt ekuilibrit të tij. Përdorimi i një regjimi të lirë të kursit të këmbimit nënkupton që çmimi i monedhave të huaja, pra edhe i monedhës euro kundrejt lekut shqiptar përcaktohet nga kushtet e tregut valutor. Gjatë periudhës 2012-2016 kursi i këmbimit ka patur luhatje të konsiderueshme.

Tabela 18 kursi mesatar I këmbimit me du monedhat kryesore 2012-2016 Burimi: Instat

	2012	2013	2014	2015	2016
Kursi mesatar \$/lekë	108,2	105,7	105,5	126,0	124,1
Kursi mesatar € /lekë	139,0	140,3	140,0	139,7	137,4

Banka e Shqipërisë (Dokumenti i politikës monetare, 2015) zbaton një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Vlera e lekut kundrejt valutave të huaja përcaktohet lirisht në tregun e këmbimeve valutore. Luhatjet e kursit të këmbimit reflektojnë lëvizjen e lirë të mallrave e të kapitalit në shkëmbimet tregtare dhe financiare të Shqipërisë me partneret e saj tregtarë. Regjimi i lirë i kursit të këmbimit i mundëson politikës monetare të Bankës së Shqipërisë një fleksibilitet maksimal në ndjekjen e objektivit të inflacionit. Gjithashtu, regjimi i lirë i kursit të këmbimit i siguron ekonomisë shqiptare një instrument të dobishëm për përballimin e goditjeve të ndryshme ekonomike, nëpërmjet rivendosjes së shpejtë të ekuilibrit në shkëmbimet tregtare me jashtë. Në përputhje me politikën e saj monetare, si një garanci për përballimin e goditjeve të rënda në sektorin real të ekonomisë, si dhe në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit, Banka e Shqipërisë angazhohet për mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të rezervave valutore. Duke ndjekur praktikën më të mira botërore, Banka e Shqipërisë do të synojë të ruajë një nivel rezervash valutore të mjaftueshëm për respektimin e njëkohshëm të dy kriterëve sasiore: Ruajtjen, në afat të mesëm, të një niveli rezervash valutore të mjaftueshëm për të përballuar të paktën 4 muaj importe mallrash e shërbimesh; Ruajtjen, në afat të mesëm, të një niveli rezervash valutore të mjaftueshëm për të mbuluar borxhin e huaj afatshkurtër të ekonomisë shqiptare. Në akumulimin e rezervave përtej nivelit dysHEME të përcaktuar nga kriteret e mësipërme të mjaftueshmërisë, Banka e Shqipërisë do të mbajë parasysh edhe koston e grumbullimit dhe të mbajtjes së këtyre rezervave. Në funksion të rritjes së rezervës valutore si dhe në

mbështetje të stabilizimit dhe zhvillimit të tregjeve të brendshme financiare, Banka e Shqipërisë mund të ndërhyjë në tregun e brendshëm valutor. Këto ndërhyrje nuk reflektojnë politikën monetare; ato nuk synojnë të ndikojnë ecurinë e kursit të këmbimit dhe nuk çenojnë përmbushjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valuator bëhen në përputhje me rregulloret e brendshme për ndërhyrjet.

Rezerva valutore shërben për të:

- përmbushur nevojat e qeverisë për valutë për shlyerjen e borxhit të jashtëm;
- mbështetur tregtinë ndërkombëtare, duke përmbushur kërkesën për valutë që buron nga importuesit;
- mundësuar ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në treg, me qëllim parandalimin dhe zbutjen e lëvizjeve të forta të kursit të këmbimit.

Pra e thënë ndryshe, rezerva valutore shërben për të siguruar stabilitetin e kursit të këmbimit.

Duke pasur një monedhë e cila nuk është një monedhë e përbashkët kursi i këmbimit do të jetë një faktor i cili mund ta ndikojë në afatshkurtër përdorimin e financave të tregtisë. Megjithatë, këto instrumente të mbrojnë nga rreziku i kursit të këmbimit duke e fiksuar atë në datën e nënshkrimit të instrumentit. Thënë këto, kursi i këmbimit nuk konsiderohet një faktor i cili kushtëzon përdorimin e instrumenteve të financave të tregtisë për Shqipërinë. Argumenti përforcohet kur dimë se edhe vende të tjera të zhvilluara e vende në zhvillim përdorin një politikë të ngjashme me Shqipërinë në lidhje me kursin e këmbimit, dhe megjithatë, financat e tregtisë përdoren më tepër dhe gjenden më lehtë se në Shqipëri.

6.2.5. Politika monetare e Shqipërisë

Bazuar në ligj, objektivi kryesor i politikës monetare të është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Teoria ekonomike dhe praktika botërore sugjerojnë se ruajtja e një niveli të qëndrueshëm çmimesh është kontributi më i mirë që banka qendrore mund të japë

për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit (Dokumenti Politikës Monetare, 2015).

Nëpërmjet garantimit të stabilitetit të çmimeve, ndihmon në uljen e pasigurisë në ekonomi dhe në zgjatjen e horizontit kohor të vendimmarrjes së familjeve e të bizneseve shqiptare. Në këtë mënyrë, politika monetare ndikon në rritjen e eficiencës së shpërndarjes së burimeve dhe mbështet rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Gjithashtu, një nivel i ulët dhe i qëndrueshëm inflacioni frenon rishpërndarjet e paparashikuara dhe të padrejta të pasurisë në ekonomi, duke ndihmuar në rritjen e mirëqenies së përgjithshme. Së fundi, një nivel i ulët dhe i qëndrueshëm inflacioni ndihmon zhvillimin e sistemit bankar dhe rrit qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Nga ana tjetër, teoria ekonomike dhe praktika botërore sugjerojnë se politika monetare mund të përdoret për zbutjet e luhatjeve afatshkurtra të aktivitetit ekonomik, por ajo nuk mund të përdoret në mënyrë sistematike për nxitjen e rritjes ekonomike dhe të punësimit. Si instrument i administrimit të kërkesës agregate, politika monetare mund të përdoret për zbutjet e luhatjeve afatshkurtra të ekonomisë të cilat burojnë nga goditjet e kërkesës agregate.

Duke ndjekur një politikë monetare elastike, ndihmon në zbutjen e goditjeve të kërkesës dhe stabilizon prodhimin dhe punësimin afër tendencave të tyre afatgjata. Nga ana tjetër, rritja ekonomike afatgjatë e vendit dhe shkalla e punësimit e lidhur me të përcaktohen nga faktorë strukturorë, si rritja dhe kualifikimi i burimeve njerëzore, progresi teknologjik, struktura dhe funksionimi i ekonomisë, por edhe stabiliteti ekonomik dhe financiar i vendit. Në këtë kontekst, politika monetare nuk ka ndikim dhe nuk mund të përdoret për nxitjen e rritjes afatgjatë ekonomike. Gjithsesi, nëpërmjet garantimit të stabilitetit të çmimeve, i jep mundësi ekonomisë të shfrytëzojë në mënyrë të plotë burimet e rritjes afatgjatë ekonomike. *Në terma sasiorë, me “stabilitet çmimesh” do të kuptojë ruajtjen e ndryshimit vjetor të çmimeve të konsumit në nivelin 3.0%.* Në praktikë, inflacioni mbetet gjithnjë subject i goditjeve të ndryshme dhe të paparashikuara, të cilat janë jashtë ndikimit të politikës monetare. Për këtë arsye, ai do të ketë vazhdimisht luhatje dhe shmangie nga objektivi i synuar. Megjithatë, politika monetare synon që, në terma mesatarë dhe për periudha të gjata kohe, inflacioni i çmimeve të konsumit në ekonominë shqiptare të jetë në nivelin 3.0%.

Politika monetare përcillet në ekonomi me vonesa kohore. Këto vonesa kushtëzohen, së pari, nga reagimi i tregjeve financiare ndaj politikës monetare dhe instrumenteve të përdorura për realizimin e saj, dhe, së dyti, nga reagimi i familjeve dhe bizneseve ndaj normave të interesit dhe kushteve të likuiditetit në tregjet financiare. Ky zinxhir efektsh njihet si mekanizmi i transmetimit të politikës monetare. Kohëzgjatja e tij mbulon zakonisht një horizont afatmesëm që shkon nga një deri në tre vjet dhe formon horizontin kohor të veprimit të politikës monetare.

Ndrryshe nga politika monetare e përbashkët e Bashkimit European dhe një monedhe të përbashkët Shqipëria ka mundërinë e rregullimit të goditjeve afatshkurtra dhe monitorimin e efektit të ndërhyrjes e vetme dhe në kohë më të shkurtër. Efektet e politikave të përbashkëta mund të jenë efektive për disa vende dhe për disa mund të jenë të mëvonshme ose të paefekshme. Në këtë kuptim, politika monetare e Shqipërisë i ka të gjitha mundësitë që të mos jetë pengesë e përdorimit dhe e rritjes së mëtejshme të instrumenteve të financave të tregtisë.

6.2.6. Zhvillimi i tregut financiar

Si u përmend edhe në fillim të kapitullit *roli* i sektorin financiar për aktivitetet ekonomike është esencial. Një sektor efikas financiar alokon burimet e ruajtura nga qytetarët e një kombi, si dhe ato që hyjnë nga ekonomitë e tjera. Një vlerësim i plotë dhe i duhur i rrezikut për këtë arsye është një përbërës kyç i një tregu të shëndoshë financiar. Investimet e biznesit janë gjithashtu kritike për të pasur produktivitet. Prandaj ekonomitë kërkojnë tregje të sofistikuara financiare që mund jenë në dispozicion të sektorit privat për investime nga burime të tilla si kreditë nga një sektor bankar të shëndoshë, të mirë-rregulluar për shkëmbimet e letrave me vlerë, e kapitaleve, dhe *produkteve të tjera financiare*. Në mënyrë që të përmbushë të gjitha ato funksione, sektori bankar duhet të jetë i besueshëm dhe transparent, gjithashtu tregjet financiare kohët e fundit kanë nevojë për rregullim të përshtatshëm për të mbrojtur investitorët dhe aktorët e tjerë të ekonomisë në përgjithësi.

Nga tabela dallohet qartë se zhvillimi i sistemit financiar të vendit ka humbur ritmin e zhvillimit në krahasim me vendet e tjera të botës. Kjo do të thotë se marrëdhënia e institucioneve financiare me ekonominë e vendit ka humbur lidhjen. Lehtësia dhe disponueshmëria e shërbimeve financiare si përshëmbull lehtësia në huamarrje dhe financimi i tregtisë (sipermarrjeve) është i ulët në krahasim me vendet e tjera dhe kërkesën për to.


vitet	Indeksi (1-7) Nga 144 vende
2006	3.9080837
2007	3.6597311
2008	3.6998688
2009	3.9291884
2010	3.740928
2011	3.5878139
2012	3.3798905
2013	3.2679557
2014	3.3922372
2015	3.2413335

Tabela19: Zhvillimin financiar të Shqipërisë nga viti 2006-2015

Burimi: WEF Përpunimi :Autori

Grafiku 11. Zhvillimin financiar të Shqipërisë nga viti 2006-2015 Burimi: WEF

Perpunimi: Autori




Ky indeks përmban në vetvete disa parametra të sektorit financiar të cilët tregojnë zhvillimin financiar të Shqipërisë.

Zhvillimi i tregut financiar për vitin 2015-2016


Disponueshmëria e shërbimeve financiare.....	3.7	116
Mundësia e shërbimeve financiare.....	3.7	103
Financimi me tregun me kapital vendas.....	1.5	140
Lehtësia e qasjes në kredi.....	1.9	 127
Disponueshmërinë e kapitalit per sipermarrjet.....	1.9	133
B. Besueshmëria dhe besimi		
Cilësia e bankave.....	4.6	80
Rregullimi i shkëmbimeve të letrave me vlerë...	2.7	133
Indeksi i të drejtave ligjore.....	7	24

Grafikun i poshtëm tregon zhvillimin financiar të vendeve partnere dhe të Shqipërisë. Ku krahasohet zhvillimi financiar i Shqipërisë me vendet e tjera. Vendet me zhvillim financiar më të lartë janë Shtetet e bashkuara të Amerikës, Gjermania, Kanadaja, Norvegjia, Holanda etj. Në vazhdim të analizës tonë për të identifikuar dhe analizuar faktorët të cilët ndikojnë/ kushtëzojnë përdorimin e financimit të tregtisë konstatojmë nga të dhënat se zhvillimi financiar i Shqipërisë është mëse i mjaftueshëm që të ofruar një nivel më të lartë të instrumenteve të financimit të tregtisë së jashtme. Këtë e vërtetojmë duke krahasuar nivelin e zhvillimit të vendeve me nivelin e përdorimit të instrumenteve të financimit të tregtisë së jashtme. Nëse krahasojmë nivelin e zhvillimit të sistemit financiar të Sllovenisë, Greqisë, Italisë, Serbisë, Ukrainës me zhvillimin e sistemit financiar të Shqipërisë është e qartë se Shqipëria ka zhvillim financiar më të lartë por nivelin e përdorimit të instrumenteve të financimit të tregtisë është më i ulët se këto vende.

Grafiku 12 : zhvillimit financiar me vendet partnere. Burimi:WEF Perpunoi :Autori



**Grafiku 13 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin Burimi :WEF
Përpunimi :Autori**



Nga grafiku vërejmë se Shqipëria është vendi me disponueshmëri më të ulët të këtyre instrumentave për biznesin edhe duke u krahasuar me vendet fqinje si Mali Zi apo Maqedonia, Greqia, Italia etj të cilët janë edhe partnerët tanë kryesorë në shkëmbimet tregtare. Vendet të cilat kanë disponueshmëri më të lartë janë Hongkong, Zvicra, Kanadaja, Gjermania, Anglia.

Nëse krahasojmë disponueshmërinë e financimit të tregtisë me zhvillimin financiar shohim se disa vende si Greqia, Italia, Brazili, Zvicra Disponueshmërinë e Financimit të Tregtisë e kanë në nivele të larta edhe pse Zhvillimin Financiar e kanë më të ulët se vende të tjera. Përshembull, marrim dy vende rastësisht në grafik Zvicra dhe SHBA, shohim se Zvicra ka Disponueshmëri më të lartë të Financimit të Tregtisë sesa SHBA edhe pse SHBA ka Zhvillim Financiar më të lartë sesa Zvicra. Por që të dyja këto vende kanë Disponueshmëri më të lartë të Financimit të Tregtisë sesa vetë Zhvillimi Financiar, kjo do të thotë se Shqipëria mund të rrisë Disponueshmërinë e Financimit të Tregtisë më shumë me nivel aktual të Zhvillimit Financiar.

Kjo do të thotë se, nëse një eksportues nga Zvicra kërkon të bashkëpunojë me një biznes të vogël në Shqipëri duke kërkuar më shumë siguri për pagesat e tij nëpërmjet instrumentave financiarë të Financimit të Tregtisë, do të jetë pothuajse e pamundur të konkludojnë në një marrëveshje. Lidhur kjo me faktin që bankat tona pothuajse nuk financojnë tregtarët e vegjël, dhe jo vetëm, dhe banka e eksportuesit me bankën e importuesit që në këtë rast është banka Shqipëtare nuk do të mundin të lëshojnë një instrument të tillë në lidhje me marrëveshjen e bizneseve. Po kështu edhe me vende të tjera.

Faktorët më problematikë për të bërë biznes.

Analiza e mësipërme e të dhënave tregon se disponueshmëria e instrumentave financiarë për biznesin është e ulët kjo reflektohet dukshëm edhe në **faktorët më problematikë për të bërë biznes**. Të anketuarit, sipas raportit të WEF 2015, për problematikën e biznesit janë shprehur se faktorët me problematikë për të bërë biznes janë normat e taksave, qasja në financim dhe korrupsioni. Korrupsioni në institucion deformon realitetin duke krijuar një system klientelist për interesa vetiake, kjo bën më të më të vështirë tu besosh institucioneve. Kështu bizneset dhe bashkëpunëtorët e tyre të huaj ezitojnë ti kërkojnë instrumentet. Por jo vetëm korrupsioni në institucionet financiare pengon bashkëpunimin me patneët në tregti por edhe korrupsioni në institucionet gjyqësore. Aftësia e institucioneve gjyqësore për të zgjidhur, në kohë pa u korruptuar dhe në transparencë të fakteve, një mosmarrëveshje midis palëve pengon rritjen e përdorimit të financimit të tregtisë Thënë ndryshe, korrupsioni kushtëzon zhvillimin e financimit të tregtisë.

Faktorët më problematikë²² për të bërë biznes për vitin 2015-2016	
Normat e taksave	21.7
Qasja në financim	18.9
Korrupsioni	13.8
Kompleksiteti i rregullave tatimore	10.0
Burokracia /Qeveria joefikase	9.3
Furnizimi joadekuat i infrastrukturës	6.3
Paqëndrueshmëria Politike	3.8
Puna e dobët Etika në forcën e punës	3.6
Arsimimi i fuqisë punëtore.....	3.3
Krimi dhe vjedhje	3.2
Kapaciteti i pamjaftueshëm për tu përtërir	2.2
Inflacioni	1.9
rregullat kufizuese të punës	0.8
Paqëndrueshmëria e Qeverisë / grushtet	0.7
Rregulloret në monedhë të huaj	0.6
Shëndeti i dobët publike	0.0.

²² Nga lista e faktorëve, të anketuarit u pyetën për të zgjedhur pesë më problematika për të bërë biznes në vendin e tyre dhe të renditet e tyre në mes të 1 (më problematike) dhe 5. Rezultati korrespondon me përgjigjet e peshuara sipas renditje se tyre. Burimi WEF.

6.2.7. Cilësia e bankave

Nga tabela e mëposhtme dallojmë cilësinë e bankave në Shqipëri dhe në vende të tjera partnere në tregti me të. Duke u nisur me llogjikën me të cilën kemi gjukuar edhe faktorët e tjerë më lartë vërejmë se në renditje kemi vende që cilësinë e bankave e kanë shumë më të ulët se Shqipëria dhe kanë përdorim të instrumenteve të tregtisë më të lartë se ajo. Përshembull, Italia qëndron e 96 – shta në renditje, 16 vende më poshtë se Shqipëria për cilësinë e bankave dhe përdorimin e financave të tregtisë e ka më të lartë për vitet 2015-2016, kina ka një nivel të përafërt të cilësisë së bankave por nivelin e përdorimit të financimit të tregtisë e ka shumë më të lartë se Shqipëria, po kështu Greqia etj. Kështu edhe për këtë faktor analiza tregon se në Shqipëri përdorimit të financave të tregtisë nuk ndikohet nga niveli i cilësisë së bankave.

Tabela 20 Cilësia e Bankave Burimi : WEF Përpunimi Autori

Edition	2015-2016	2015-2016
Series	Cilësia e bankave, 1-7 (shmë e mirë)	Cilësia e bankave, 1-7 (shumë e mirë)
Attribute	vlerë	Rankim
Albania	4.632241593	80
Austria	4.806694608	68
Belgium	4.923415639	65
Brazil	5.768729904	27
Bulgaria	4.459067005	92
China	4.725199474	78
Czech Republic	6.076827957	13
Denmark	5.259757919	53
France	5.535663625	40
Germany	5.446327297	46
Greece	2.954541898	134
Italy	4.406304911	96
Macedonia, FYR	5.458424532	45

Montenegro	4.209609848	108
Serbia	4.149944861	112
Spain	4.703345776	79
Sweden	6.033935063	16
Switzerland	5.897454808	20
Turkey	5.327927448	51
Ukraine	2.572078013	140
United Kingdom	4.977151501	63
United States	5.551773885	39

6.2.8. Vështiësia në huamarrje

Tabela e mëposhme tregon të dhënat e një faktori si vështiësia në huamarrje i cili ndikon përdorimin dhe zhvillimin e financave të tregtisë ku në rastin e Shqipërisë është shumë problematik në krahasim me vendet e tjera. Përveç Spanjës e Italisë. Megjithatë dhe panvarësisht se Spanja e Italia kanë një vështirësi më të madhe se Shqipëria për të dhënë hua dhe nivelin e disponibilitetit të instrumenteve për financimin e tregtisë e kanë më të lartë. Edhe për këtë faktor shqipëria ka mundësi të rrisi më tepër përdorimin e financave tregtare.

Tabela 21 Vështiresia ne huamarrje Burimi : WEF Përpunimi Autori

Edition	2015-2016	2015-2016
Series	Vështirësia në huamarrje , 1-7 (shumë mirë)	Vështirësia në huamarrje , 1-7 (shumë mirë)
Attribute	Vlera	Rankimi
Albania	1.877603383	127
Austria	2.858141175	67
Belgium	3.328354323	36
Brazil	2.668874993	85
Bulgaria	2.993536041	54

China	3.660318303	21
Czech Republic	3.327315919	37
Denmark	2.913618394	61
France	3.779414627	17
Germany	3.348679265	35
Greece	1.675265791	134
Italy	1.61082173	136
Macedonia, FYR	2.977585855	56
Montenegro	3.040777299	50
Serbia	2.166034937	120
Spain	1.741450705	131
Sweden	4.088071453	10
Switzerland	3.582797158	28
Turkey	2.870295411	65
Ukraine	2.617612532	87
United Kingdom	2.690229466	82
United States	3.929245729	14

6.2.9. Aspekti ligjor

Një sistem i plotë juridik është i nevojshëm për zhvillimin e një shumëllojshmërie të shërbimeve të financimit të tregtisë (p.sh., leasing-ut). Liberalizimi jo i kujdesshëm (UNCTAD/WTO, 2005). mund të jetë e dëmshëm për ekonominë në këtë mënyrë që kuadri ligjor për kompanitë dhe bankat duhet të jetë i qartë dhe i rregulluar në mënyrë që të sigurojë minimizimin e rreziqeve sistematike. Cilësia e ligjeve të tregtisë, miratimi i rregullave ndërkombëtare, efektiviteti dhe zbatimi i ligjeve të falimentimit, standardeve dhe aftësia e sistemit ligjor për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tregtisë në kohën e duhur dhe transparente mund të ndikojë në zhvillimin dhe disponueshmërinë e financave të tregtisë. Gjithashtu, zhvillimi mund të lehtësojë dhe zvogëlojë koston dhe kohën që lidhen me kërkesat ligjore.

Nga teoria dimë se ekzistenca e kufizimeve të qeverisë në instrumentet e tregut dhe kapitalit do të ndikojë drejtpërdrejt në radhët e instrumenteve të financave të tregtisë dhe shërbimeve në dispozicion për të zbutur rrezikun ose sigurinë e kredisë. Institucionet financiare dhe ndërmjetesit mund të hartojnë instrumenta apo kontrata (marreveshje edhe pa ndihmën e institucioneve shtetërore duke krijuar një infrastrukturë të financimi i tregtisë në ndihmë të ekstortuesve apo importuesve)


Në vijimësi të analizimit të faktorëve shohim nga tabela se ligjet në Shqipëri janë të mira ku renditet e 24-ta , në 144 vende, në krahasim me shumë partnere të saj, në krahim me Italinë e cila renditet e 106-shta, Turqia e cila renditet e 93-ta bashkë me Greqinë, Kina renditet në vendin e 80 etj. Nga analiza e këtij faktori rezulton se përdorimi i instrimenteve të financave të tregtisë në Shqipëri nuk kushtëzohet nga ligjet.

Tabela 22 Indeksi për te drejtat ligjore Burimi : WEF Përpunimi: Autori

Edition	2015-2016	2015-2016
Series	Indeksi për te drejtat ligjore 0–10 (best)*	
Attribute	Value	Rank
Albania	7	24
Austria	5	63
Belgium	4	80
Brazil	2	106
Bulgaria	9	11
China	4	80
Czech Republic	7	24
Denmark	8	17
France	4	80
Germany	6	44
Greece	3	93
Italy	2	106
Macedonia, FYR	6	44
Montenegro	12	1

Serbia	5	63
Spain	5	63
Sweden	6	44
Switzerland	6	44
Turkey	3	93
Ukraine	8	17
United Kingdom	7	24
United States	11	4

Grafiku 14 : Disponueshmërinë e shërbimeve dhe instrumentave financiarë për biznesin nga viti 2010-2015. Burimi: WEF Perpunoi :Autori



6.2.10. Aftësia kredituese

Si u përmend edhe më parë kreditimi tregtar mund të ndikojë thelbësisht sistemin financiar, stukturën dhe efikasitetin e tij dhe si rrjedhim mund të ndikojë dhe disponueshmërinë e financave të tregtisë. Efikasiteti i sistemit që matet me diferencën midis depozitave dhe normat e huadhënies do të përcaktojë nevojat e eksportuesve dhe importuesve. Një treg bankar i plotësuar do të ishte kur ky sektor të kanalizohet në financimin e tregtisë duke u specializuar në përdorimin e këtyre instrumenteve.

Vlerësimi i Standard & **Poor's** për Shqipërinë qëndron në B + me një pikëpamje të qëndrueshme. Vlerësimi i kredisë i Moody për Shqipërinë u vendos për herë të fundit në B1 me një opinion të qëndrueshëm. Në përgjithësi, një klasifikim i kredive përdoret nga fondet e pasurive të patundshme, fondet e pensioneve dhe investitorët e tjerë për të vlerësuar aftësinë e kreditimit të Shqipërisë, duke ndikuar kështu në kostot e huamarrjes së vendit. Aftësia kredituese është e rëndësishme për nivelin e përdorimit të instrumenteve të tregtisë në Shqipëri dhe në mbarë vendet. Sic e shohim edhe nga vlerësimet e agjensive vlerësuese aftësia kredituese e vendeve reflekton drejtpërdrejt në nivelin e përdorimit të instrumenteve të financave të tregtisë, e megjithatë ka vende ku edhe me një vlerësim më të ulët të kreditimit kanë nivel më lartë përdorimi të përdorimit të financave të tregtisë se Shqipëria. Përshembull, Serbia e cila ka të njëjtin vlerësim të aftësisë kredituese dhe përdorimit të financimit të tregtisë më të lartë se Shqipëria. Nga analiza rezulton se Shqipëria me vlerësimin aktual të aftësisë kredituese mund të rrisi më shumë përdorimin e instrumenteve të financave të tregtisë.

**Grafiku 15 Indeksi i disponueshmërisë së instrumenteve financiar për biznesin Burimi :WEF
Përpunimi :Autori**




Tabela: 23 Aftësia kredituese Burimi : tradingeconomics Përpunimi: Autori

	S&P		Moody's		Fitch		TERating
<u>Greece</u>	B-	Stable	Caa3	Stable	CCC	N/A	10
<u>Germany</u>	AAA	Stable	Aaa	Stable	AAA	Stable	100
<u>Italy</u>	BBB-	Stable	Baa2	Negative	BBB	Stable	60
<u>Montenegro</u>	B+	Negative	B1	Negative			40
<u>Serbia</u>	BB-	Positive	Ba3	Stable	BB-	Stable	36
<u>Albania</u>	B+	Stable	B1	Stable			35

<u>Russia</u>	BB+	Positive	Ba1	Stable	BBB-	Stable	43
<u>Spain</u>	BBB+	Positive	Baa2	Stable	BBB+	Stable	62
<u>Turkey</u>	BB	Negative	Ba1	Negative	BB+	Stable	44
<u>United States</u>	AA+	Stable	Aaa	Stable	AAA	Stable	97
<u>Ukraine</u>	B-	Stable	Caa3	Stable	B-	Stable	15
<u>United Kingdom</u>	AA	Negative	Aa1	Negative	AA	Negative	95

6.2.11. Situata e kreditimit të biznesit dhe tregtisë


Kredia për biznese ka shfaqur përmirësim në tremujorin e dytë të vitit 2016. Zgjerimi i saj mujor ka qenë i luhatshëm, por dinamika vjetore ka konfirmuar tendencën pozitive të nisur që nga fillimi i vitit. Duke marrë parasysh edhe ecurinë e kursit të këmbimit, kjo dinamikë shfaqet dukshëm më pozitive se në vitin 2015. Zgjerimi prej 2.1% i këtij portofoli është mbështetur kryesisht nga përmirësimi i ecurisë në kredinë për investime. Bankat vijojnë të ndjekin politika konservatore ndaj kreditimit të bizneseve dhe kushtet për to në tremujorin e dytë janë shtrënguar. Kërkesa e bizneseve për financim shfaqet e dobët, në veçanti në segmentin e korporatave. Për tremujorin e tretë, bankat presin një lehtësim të kushteve të kreditimit dhe rritje të kërkesës vetëm në segmentin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Kredia për biznese në muajt prill dhe maj u rrit me 4.5 miliardë lekë, ndër rritjet më të larta të shënuara në dy vitet e fundit. Kontributin kryesor në këtë përmirësim e dha kredia për investime, e cila shënoi një rritje të ndjeshme në muajin maj. Për këto dy muaj, portofoli i kredisë për biznese u zgjerua mesatarisht me 2.1% krahasuar me një vit më parë, duke shfaqur përmirësim përkundrejt rritjes me 1.9% në tremujorin e parë. Gjithsesi, dinamika vjetore e portofolit të kredisë për biznese është ndikuar edhe nga mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj euros, për shkak të dominimit të këtij portofoli nga kreditimi në valutë. Duke mënjeluar efektin e kursit të këmbimit, zhvillimet në

tepricën e kredisë për biznese kanë ardhur në përmirësim gjatë pjesës së parë të vitit 2016. Rritja vjetore e këtij portofoli prej 3.4% është më e larta e shënuar për këtë segment në dy vitet e fundit. Kontributin kryesor në përmirësimin e ecurisë së kredisë për biznese e ka dhënë kreditimi në lekë. Zgjerimi vjetor i këtij portofoli shfaqet i përmirësuar në 4.2% për tremujorin e dytë. Në muajin maj, kredia në lekë e bizneseve përbënte 36% të totalit ose 0.7 pp më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, vihet re se zgjerimi i portofolit të kredisë për biznese është mbështetur nga kredia për investime, duke qenë në linjë edhe me kontributin më të lartë që investimet private kanë dhënë në rritjen e aktivitetit ekonomik në vend. Ndryshimet vjetore të kredisë për qëllime investimi shënuan përmirësim në 2.7% në muajin maj, përkundrejt 2.5% në mars, ndërsa rritja e kredisë për likuiditet u ngadalësua në 1.4% përkundrejt 2.1% që ishte në muajin mars. Sipas sektorëve të ekonomisë, portofoli i kredisë për biznese dominohet nga kredia për sektorin e tregtisë, hoteleve dhe restoranteve. Pësia e kredisë së këtij sektori arriti në 38.1%, duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e portofolit të kredisë për biznese në tremujorin e dytë. Ky portofol shënoi një rritje vjetore prej 2.9% në fund të muajit maj. Kredia për sektorin e ndërtimit shfaqet gjithashtu e përmirësuar. Kredia për këtë sektor u rrit me 1.7% krahasuar me një vit më parë dhe pësia e tij mbeti në 12.8% të kredisë për biznese në fund të muajit maj. Ndërkohë, kredia për sektorin e industrisë shënoi tkurrje me rreth 2% vit mbi vit. Kjo ecuri duket të jetë ndikuar kryesisht nga reduktimi i kredisë për nënsektorin e prodhimit të energjisë dhe lëndëve të tjera djegëse. Këto zhvillime sektoriale të financimit të bizneseve janë në linjë me ecurinë e aktivitetit ekonomik të secilit sektor në ekonomi.


Analiza e rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues, tregon se bankat kanë shtrënguar kushtet e kreditimit për bizneset gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016. Si faktorë kryesorë që kanë ndikuar këtë ecuri, vlerësohet të jenë situata makroekonomike dhe rreziku i kredisë, sikurse vihet re nga ecuria e treguesit të kredive me probleme të bankave. Pavarësisht reduktimit të raportit të kredive me probleme, ai vijon të mbetet i lartë. Problemet strukturore në sektorë specifikë të ekonomisë ndikojnë gjithashtu në politikat konservatore që bankat aplikojnë për bizneset. Për tremujorin e tretë bankat presin të lehtësojnë kushtet e

kreditimit vetëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, në linjë me politikat e tyre të kreditimit për të rritur portofolin në këtë segment. Ndërkohë, për biznesin e madh këto kushte priten të mbeten të shtrënguara. Në linjë me këto zhvillime, ato presin rritje të kërkesës për kredi nga bizneset në tremujorin e tretë të vitit, kërkesë e cila pritet të gjenerohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Grafiku :16 Kredia për biznese sipas sektorëve të ekonomisë. Burimi: Banka e Shqipërisë




Grafiku: 17, Kërkesa dhe oferta e kredisë. Burimi : Banka e Shqipërisë



Kredia për sektorin privat vijon përmirësimin gradual edhe në rajon, e nxitur nga rikuperimi më i shpejtë i kredisë për individë. Rritja e kredisë vijon më e fortë për vendet e Evropës Qendrore, por përshpejtimi i saj në vendet e Ballkanit ka ngushtuar hendekun mes këtyre dy rajoneve. Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit, Shqipëria renditet më mirë sa i takon kreditimit të bizneseve, por mbetet mbrapa në ritmet e rritjes së kredisë për individë.

Grafiku 18 Kredia për biznese sipas ekonomive. Burimi :Banka e Shqipërisë



Ecuria e kredisë për biznese në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore Kredia për sektorin privat ka vijuar të rritet në pjesën më të madhe të vendeve të rajonit edhe në muajt prill dhe maj. Rritja vjetore e saj rezultoi mesatarisht 5.1% në këta dy muaj, nga 4.9% që shënonte në fund të tremujorit të parë të vitit. Rimëkëmbja e kreditimit në rajon vazhdon të mbështetet nga rritja e kredisë për individë, e cila ka shfaqur ecuri më të mirë se ajo për biznese në thuajse të gjitha vendet. Tendencat për ulje të ekspozimit të grupeve të mëdha bankare në rajon kanë vijuar, por me një ritëm më të moderuar. Përgjithësisht, bankat e huaja të pranishme në rajon tregojnë për një rikuperim të kërkesës për kredi, ndërkohë që kushtet e kreditimit mbeten në thelb të pandryshuara, duke zgjeruar kështu hendekun mes kërkesës dhe ofertës për kredi. Në pjesën e mbetur të vitit, pritet një lehtësim i kushteve të kreditimit në terma mesatarë për rajonin, duke iu përgjigjur më mirë rritjes së kërkesës për kredi. Në krahasimin rajonal, kredia për sektorin privat në Shqipëri ka shënuar rritje të krahasueshme me mesataren e vendeve të Ballkanit. Ajo ka shënuar rritje vjetore prej mesatarisht 4.1% në këta muaj, nga 3.4% që shënonte në tremujorin e parë të vitit. Ndryshimi vjetor i saj ka kaluar në territor pozitiv për pjesën më të madhe të vendeve, me përjashtim të Kroacisë dhe Hungarisë, në të cilat ky portofol vijon tkurrjen, por me ritme më të moderuara. Vendet e Evropës Qendrore – Çeki dhe Poloni – mbeten ato me ecuri më të mirë të kredisë për biznese. Në krahasim me fundvitin e kaluar, përmirësime të dukshme vërehen edhe në Shqipëri dhe Serbi. Ndërkohë, në IRJM kredia për biznese ka vijuar ngadalësimin e nisur që gjatë vitit 2015. Vendet të cilët kreditojnë më shumë sektorin privat janë Turqia, Meksika, Mozambiku, Bullgaria dhe Paraguai.

6.2.12. Rreziku i vendit

Rreziku i vendit është një koleksion i rreziqeve që lidhen me investimin në një vend të huaj. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun politik, rrezikun e kursit të këmbimit, rrezikun ekonomik, rrezikun sovran dhe rrezikun i transfertave, që është rreziku i mbylljes së kapitalit ose ngrirjes nga veprimi i qeverisë. Rreziku i vendit ndryshon nga një vend në tjetrin. Vende që kanë rrezik të lartë dekurajojnë shumë investimet e huaja.

Rreziku i vendit mund të zvogëlojë kthimin e pritur të një investimi dhe duhet të merret parasysh kurdoherë që investon jashtë vendit. Rreziku i një vendi nuk ka një mbrojtje efektive. Risqe të tjera, të tilla si rreziku i kursit të këmbimit, mund të mbrohen kundër me një humbje marginale të potencialit të fitimi

Shtetet e Bashkuara në përgjithësi konsiderohen si pikë

referimi për rrezikun e ulët të vendit dhe shumica e vendeve mund të matin rrezikun e tyre në krahasim me SHBA. Rreziku i vendit është më i lartë me investime afatgjata dhe investime direkte, të cilat janë investime që nuk bëhen nëpërmjet një tregu të rregulluar ose shkëmbime.

Nga tabela shohim se vendet e Ballkanit kanë rrezik të lartë të vendit që do të thotë se vendet e tjera si Zvicra për të krijuar një marrëveshje të sigurtë, se do të paguhet në kohë apo nga ana tjetër nëse është importues të marrë produktin e kërkuar, kërkon të nëshkruaj një instrument të financave të tregtisë i cili në rastin më të keq merr trajtë ligjore. Shqipëria nga vlerësimet ka një rrezik të lartë të vendit dhe sipas teorisë dhe gjetjeve empirike të mëparshme, me rritjen e rrezikut të vendit duhet të rritet edhe përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë.

Tabela 24 Rreziku i vendit
Burimi :OECD Përpunimi
:Autori

Rreziku i vendit 1-7 (shume i larte)	Vendet (Nga OECD)
2	Franca
0	Gjermania
5	Greqia
4	Italia
5	Maqedonia
5	Rusia
3	kine
0	SHBA
3	Spanja
4	Turqia
0	Zvicra
1	Anglia
0	Austria
6	Ukraina
4	kroaci
5	Serbia
5	Montenegro
5	Shqipëria

6.3. Natyra e sigurt e përdorimit të financave të tregtisë së jashtme

Instrumentet e financimit të tregtisë si u përmendëm më parë në punim mbrojnë tregtarin nga një sërë rreziqesh ku bankat luajnë rolin kryesor për ofrimin e instrumentave për mbrojtjen nga këto rreziqe, të cilat po ashtu i treajtuam më lart. Kështu mendohet se humbjet duhet të jenë të ulëta nëse zgjidhjent instrumenti i duhur. Sipas të dhënave të publikuara nga ICC, konstatohet një humbje shumë e ulët në krahasim me totalin e transaksioneve të kryera me anë të këtyre instrumenteve.

Humbja sipas llojit të produktit. Më pak se 3000 humbje janë vërejtur nga të dhënat, nga totali i 11.4 milion transaksioneve. Këto norma të ulëta të humbjes janë në përputhje me të kuptuarit teorik të mekanikës dhe kontekstin e financimit të tregtisë të ICC-së²³. Duke përdorur një llogaritje standarde, ICC llogarit normat mesatare të humbjeve brenda çdo lloji të produktit gjatë tre viteve të fokusit (2008-2014):

Relativisht pak janë humbjet përgjatë rënies ekonomike globale. Më pak se 500 humbje janë regjistruar nga më shumë se 7.5 milionë transaksione në vitin 2008, 2009 dhe 2010. Në të vërtetë, numri i humbjeve në disa produkte (p.sh., huatë e importit dhe L / Cs, garanci,) ka mbetur i papërfillshëm gjatë kësaj periudhë (269 nga më shumë se 4 milionë transaksione), pavarësisht kushteve ekonomike dhe vëllime të larta të transaksioneve.

Shifra konkrete jepen në tabelat e mëposhtme:

²³ Rapirtet vjetore ICC(2008- 2016)


Tabela 25: Normat humbjes te obliguesit 2008-2014 Burimi: ICC Përpunimi : Autori

PRODUCT	TOTALI # OBLIGUESVE	TOTALI # OBLIGIMEVE Të MOSPAGUARA	OBLIGIMEVE TE MOSPAGUARA	KLASIFIKIMI I MOODI'S
1. Export L/C	92,881	36	0.04%	Aaa-Aa
2. Import L/C	113,026	333	0.29%	Baa
3. Performance Guarantees	181,626	773	0.43%	Baa-Ba
4. Loans for Import/Export	145,021	1,050	0.72%	Ba

Tabela 26: Normat e humbjes te transaksionit 2008-2014 Burimi: ICC Përpunimi : Autori


PRODUCT	TOTALI # TRANSAKSIONEVE	TOTALI # TRANSAKSIONEVE TE DESHTUARA	TOTALI # TRANSAKSIONEVE TE DESHTUARA %
1. Export L/C	1,847,734	121	0.01%
2. Import L/C	3,164,200	2,509	0.08%
3. Performance Guarantees	1,615,351	2,736	0.17%
4. Loans for Import/Export	6,816,742	15,176	0.22%

Grafiku19, 20 , 21, 22:Normat e mospagesës te konsumatorëve nëpër rajone dhe Produkte, 2008-2014 BURRIMI :ICC




Grafikët e mësipërm tregojnë normat e mospagesës te konsumatorëve nëpër rajone dhe produkte, për vitet 2008-2014. Dallohet qartë për LC të lëshuara për eksport dhe për import (grafiku 5 dhe 6) nivelin më të lartë të mospagesës e kanë vendet europiane, por përsëri është një shifër shumë e ulët në krahasim me numrin e transaksioneve, të përmendura më lart. Po kështu për garancitë nivelin më të lartë të mospagesës e kanë tregtarët europian dhe për huatë vendet e SHBA-ve.

Grafiku 23: Vëllimi i L / Cs dërguar nga Rajonet, 2014 Burimi: ICC



Asia-Pacific kryesojnë tabelën në Importin e L / Cs. Deri tani numri më të madh i L / Cs janë lëshuar në Azi-Paqësor. Shumica e këtij trafiku është ndër-rajonal, duke sugjeruar edhe një herë dëshirën për të zbutur rrezikun në tregti. Vlera mesatare e një L / C importi në Azi-Paqësor është shumë nën mesataren, e cila gjithashtu sugjeron se eksportuesit gabojnë në anën e sigurisë. Vlera më e lartë e L/C-ve të dërguara është në vendet e Europës por jashtë eurozonës.

Grafiku 24: Vlera mesatare e L / Cs dërguar nga Rajonet, 2014



ICC në raportin e saj tregon se 53% e bankave të anketuara, raportuan se ata perceptojnë një mungesë të financimit të tregtisë në nivel global. Kjo është afërsisht në përputhje me rezultatet e anketës e vitit të kaluar.

Gjeografikisht, normat e refuzimit të propozimeve të financimit të tregtisë mbeten më të larta në tregjet në zhvillim: Asia (31%), Afrika (18%) dhe Rusia / CIS (15%) kanë të regjistruar normat më të larta refuzimi se tregjet e vendosura në Evropë dhe Amerikën e Veriut. Në kuadër të zhvillimit të rajoneve të vendit, refuzimet më të larta janë në tregjet më të zhvilluara. Për shembull, Afrika, Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut kanë normë rekord më të lartë refuzimi se Afrikën Sub-Sahariane. India dhe Kina përsëri ka reflektuar edhe numrin më të madh të propozimeve të financimit të tregtisë (26% e totalit) dhe shkallën më të lartë të refuzimit (16%). Kundërshtimet janë pak më të ulëta se ato të raportuara vitin e kaluar. SME-të vazhdojnë të jenë në disavantazh në transaksionete financimit të tregtisë. Bankat raportojnë se 45% e transaksioneve të propozuara të financimit të tregtisë janë paraqitur nga SME-të, 39% nga korporatat e mëdha dhe 14% nga shumëkombëset. Megjithatë, në dallim nga korporatat e mëdha të cilat kanë 79% të propozimeve të tyre të pranuar, SME-ve u janë refuzuar 53%. Për probleme, 68% e bankave raportojnë se, SME janë ndikuar më negativisht nga kërkesa më të rrepta të pajtueshmërisë me rregullatoren.


Duke vazhduar trendin pozitiv të vitit të kaluar, më shumë se 80% i janë përgjigjur bankave për të ruajtur ose rritur linjat e tyre të kreditit në vitin 2014. Pjesa më e madhe e bankave ka raportuar rritjen e numrit të linjave të kreditit për të dy, klientët e korporatave (62%) dhe institucionet financiare (57%). Rreth 60% e bankave raportuan se niveli i rritjes së linjave të kreditit të ofruara ishte në rangun e 25%, ndërsa 15% e bankave raportuan rritje shumë të konsiderueshme të 25-50% për klientët e korporatave.

Bankat kanë qenë pozitive për rolin e bankave shumëpalëshe të zhvillimit në adresimin e mangësive të financimit të tregtisë. 75% e të anketuarve u pajtuan se MDB ka ndihmuar

boshllëqet e ngushta financimit të tregtisë të paktën në një farë mase. Agjencitë e kreditit të eksportit kanë ngushtuar boshllëqet, në bazë të 72% të të anketuarve.

Grafiku 25 : Transaksionet e propozuara Burimi ICC 2015

Grafiku 26:Transaksionet E refuzuara Burimi ICC 2015



6.4. Përmbledhje kapitulli

Në këtë kapitull, pasi u analizua konkurrenca e Shqipërisë në tregun global, u analizuan në mënyrë të hollësishme edhe faktorët të cilët ndikojnë financimin e tregtisë në Shqipëri. U analizua niveli i zhvillimit të tyre dhe më pas të krahasuara me nivelin e zhvillimit vendet e huaja konstatuam se sa i kushtëzon niveli i zhvillimit të tyre financave e tregtisë në Shqipëri. Faktorët të cilët u analizuan në këtë kapitull janë, *situates së tregtisë*, borxhi public, investime te huaja direkte, kursi i këmbimit \$/lekë dhe € /lekë, politika monetare e Shqipërisë, zhvillimi i tregut financiar, cilësia e bankave,vështiësia në huamarrje, aspekti ligjor, aftësia kredituese dhe situata e kreditimit të biznesit dhe tregtisë. Faktorët makroekonomik më problematik të cilët kushtëzojnë përdorimin e financave të tregtisë në Shqipëri ishin volumi i ulët flukseve tregtare, vështirësia në financim. Në përfundim të

kapitullit u dhanë fakte për natyrën e sigurt të instrumenteve të financave të tregtisë. Në kapitullin vijues do të diskutojmë mbi konkluzionet më të rëndësishme të punimit, kontributi i punimit, rekomandime, kufizimet, kërkimet e ardhshme.

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke marrë shtysë nga disa arsye fillestare si: së pari, financat e tregtisë janë një mjet i mirë për ti krijuar likuiditet tregut, rrisin flikset tregtare dhe ulin rrezikun e shkëmbimeve ndërkombëtare; së dyti, biznesi ka qenë dhe do ketë gjithnjë nevojë për financim, këtë fakt e ka përforcuar më shumë kriza e fundit financiare; së treti, tregtia ndikon pozitivisht në zhillimin e vendit dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë; së katërti, nevoja e biznesit për të menaxhuar rreziqet në tregti është një çështje me fokus në rritje dhe një problematikë themelore në Shqipëri. Instanca të ndrryshme ndërkombëtare publikojnë në mënyrë periodike raporte që tregojnë nivelin e ulët të financave të tregtisë dhe rrjedhimisht edhe nivelin e ulët të përdorimit të instrumenteve të saj. Por një studim i thelluar i cili analizon shkaqet e mundshme të një niveli të ulët të zhvillimit të financave të tregtisë në Shqipëri, me fokus implementimin e tij dhe gjetja e mënyrave për nxitjen dhe përmirësimin e tij në të ardhmen, do të ishte me interes të biznesit, institucioneve financiare dhe institucioneve politikebërëse. Pikërisht për këto arsye edhe qëllimi i këtij studimi në këtë punim doktore është të identifikojë dhe analizojë faktorët që kushtëzojnë zhvillimin dhe ofrimin e financave të tregtisë në Shqipëri. Punimi është shtrirë në bankat më të mëdha në Shqipëri për vitin 2017, të cilat përbëjnë afërsisht 80% të huasë bankare dhe 80% të depozitave.

Punimi parashtron hipotezën: *Zhvillimi i financave të tregtisë dhe struktura institucionale varet drejtpërdrejt nga mjedisi makroekonomik dhe rreziku i vendit.*

Cilët faktorë të mjedisit makroekonomik kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë së jashtme në Shqipëri?

Në funksion të testimit të hipotezës në punim është shtjelluar një kuadër i plotë teorik, i cili përbëhet në dy kapituj, ku trajtohen në mënyrë të detajuar teoritë dhe përkufizimet kryesore të financave të tregtisë, ndrryshimi ndërmjet huasë dhe financave të tregtisë, rëndësia e financave tregtare, rëndësia në vecanti në më menaxhimin e rrezikut dhe vlerësime nga autorë të ndrryshëm dhe llojet e instrumentave të financave të tregtisë, përdorimin e tyre dhe teknika.

Në pjesë e parë të kuadrit teorik u trajtuan rreziqet të cilat menaxhojnë instrumentet e tregtisë si: rreziqet e transportit dhe sigurimit të ngarkesave, rreziqet komerciale, rreziku i informacionit, rreziqet e biznesit, rreziqet politik, rreziqet e monedhës, rreziqet financiare. Ghithashtu llojet e instrumenteve kryesore të financimit si: Cash -in -Advance (Parapagim), Documentary Collections (Koleksionet dokumentar), Open Account (Llogari e Hapur), Consignment (dorëzimi i porosisë), Letter of credit (Leter kredie), Export Working Capital Financing (EWC), Government-Guaranteed Export , Working Capital Loan Programs, Export Credit Insurance (ECI) , Eksport Factoring, Forfaiting, Government-Backed Agricultural Export Financing, E-Trade Finance.

Në pjesën e dytë evidentohen nga teoria faktorët kryesorë që kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë, institucionet kryesore dhe aktorët kryesorë që marrin pjesë në infrastrukturën e financave të tregtisë si dhe u bë i mundur evidentimi i Indikatori i matjes së financave të tregtisë si pjesë e faktorëve kryesorë për lehtësimin e tregtisë. Faktori kryesor i kushtëzimit të financave të tregtisë është mjedisi makroekonomik i cili ndikon edhe në cilësinë e institucioneve financiarë dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin e financave të tregtisë e nëpërmjet disa elementeve: Situates së tregtisë, burimeve, borxhet e jashtme dhe likuiditeti, politika e kursit të këmbimit, sistemi monetar dhe sistemi financiar, tregu i kreditimit, mjedisi ligjor, aftësia kredituese, rreziku i vendit. U trajtua gjithashtu natyra e sigurt e përdorimit të financave të tregtisë ku më pak se 3000 humbje , janë vërejtur nga të dhënat, nga totali i 11.4 milion transaksioneve.

Analiza e faktorëve që kushtëzojnë financat e tregtisë të Shqipërisë në punim u nda në analizë hulumtuese nëpërmjet pyetësorit dhe analizë krahasuese të faktorëve me zhvillimin e faktorëve të vendeve partnere. Kështu edhe konkluzionet e punimit do të ndahen në dy pjesë. Në pjesën e parë do të diskutohen gjetjet nga pyetësi dhe analizës përshkruese të tij. Pjesa e dytë do të fokusohet rezultatet më të analizës krahasuese të faktorëve që ndikojnë në financat e tregtisë dhe nivelin e tyre të zhvillimit të Shqipërisë me ata të vendeve partnere. Punimi nëpërmjet pyetësorit bën një pasqyrë të përdorimit të financave të tregtisë në tregun bankar Shqipëtar dhe nëpërmjet analizës krahasuese të nivelit të

zhvillimit të faktorëve që kushtëzojnë financat në tregtisë me vendet e tjera identifikon faktorët më problematik për çështjen në fjalë.

Konkluzione për pjesën hulumtuese

Qëllimi i pyetësorit ishte që të kuptojë se sa përdoren instrumentat financiarë të financave të tregtisë për bizneset të cilat marrin pjesë në tregtinë ndërkombëtare, të kuptojë nëse këto instrumente njihen nga tregtarët dhe sa të disponueshme janë ato nga ana e bankës, të kuptojë cilët instrumente përdoren, të kuptojë nëse bankat operojnë me të gjitha madhësitë e bizneseve dhe llojit të aktivitetit, të kuptojë nëse këto instrumente kanë ndihmuar biznesin për të ndërtuar marrëveshje të sukseshme duke menaxhar rreziqet e tregtimit. Pyetësi kishte karakter vrojtues, ku tenton të mbledhë informacione mbi përdorimin e disponueshmërinë e financave të tregtisë.

Nga rezultatet e pyetësorit rezultoi se lloje të ndryshme instrumentesh nuk përdorehin ose nuk përdorehin shumë në bankat Shqipëtare. Instrumenti më i përdorur por ende pak i njohur nga tregtarët ishte L/C. Instrumentat e tjerë nuk kërkoheshin dhe nuk përdorehin për një sërë arsyes. Madje ekspertët shprehen se tregtarët Shqiptarë shpesh i kërkojnë sepse partnerët e tyre të huaj nuk konkludonin marrëveshjen pa nënshkruar një instrument të tillë.

Credins Bankë shprehet se ka shumë pak klientë që përdorin keto lloj instrumente në Shqipëri për tregtinë, 0-10 klientë. ABI dhe ALPHA bank po ashtu kanë një numër të ulët, 10-30 klientë, në krahasim me numrin e bizneseve kliente që kërkojnë financim prej tyre. BKT dhe Intesa Sanpaolo Bank kanë numrin më të madh të klientëve, 50-70 dhe 70-100 klientë, por përsëri është një numër i ulët që përkthehet automatikisht në një numër i ulët transaksionesh, rrezik i lartë i transaksioneve dhe besueshmëri e ulët ndërmjet palëve. Në krahasim me numrin e bizneseve Shqipëtare që operojnë në tregun ndërkombëtar dhe që kërkojnë të financohen nga bankat apo thjesht të nënshkruajnë një dokument që i siguron një transaksion të sigurt numri i bizneseve është i ulët. Ekspertët e bankave shprehen se

vetëm 30% e totalit të bizneseve që marrin pjesë në tregtinë e jashtme të Shqipërisë e përdorin e financave tregtar dhe instrumentet e tyre. Kjo vërtetohet edhe të dhënat e publikuara në lidhje me përdorimin e instrumenteve financiare të financave të tregtisë për Shqipërinë ku WEF e rendit Shqipërinë në vendin 115 nga 150 vende të marra në shqyrtim për vitin 2015-2016. Vlerësimi i WEF për disponueshmërinë e instrumenteve të financave të tregtisë nga 1-7 (shume) është 3.745 për vitin 2015- 2016.

Bankat në Shqipëri i përdorin instrumentet e financave të tregtisë në një masë mbi 80 nga 100 transaksione për importe dhe pjesën tjetër për eksporte. Vetëm ABI bank përdor ato në një masë të barabartë, 20-40%, për eksport dhe import. Bizneset që i njohin i evitojnë këto instrumente për shkak të kostove duke i marrë vetë rreziqet përsipër duke i shkaktuar edhe më shumë kosto indirekte që ata nuk i kuptojnë.

Në rastin e bashkëpunimit me madhësinë e bizneseve bankat kanë eksperiencë të ndryshme. Intesa Sanpaolo Bank nga 70 klientët që përdorin instrumentet e financave të tregtisë 4 janë biznese të vogla, 24 janë me bizneset e mëdha dhe 42 me bizneset e mesme. Në Bankën BKT më pak se 20 janë biznese të vogla, 40 të mesme dhe 40 të mëdha. Për ABI Bank 6 biznese nga 30 që supozohet numri maksimal i bizneseve të cilët përdorin instrumentet e financave të tregtisë janë të mesme dhe 24 të mëdha.

Bizneset e prodhimit i përdorin me së shumti këto instrumente, në 60-80% të rasteve, deri në 40% në shërbime të rasteve dhe biznese agro vetëm në BKT bank përdoret në 20% të rasteve. Bankat e tjera shprehin se nuk kanë preferencë në llojin e biznesit, por nuk kanë një statistikë për t'iu përgjigjur pyetjes. Banka Intesa Sanpaolo Bank i përdor 20% të instrumenteve për eksport me bizneset e fasonit dhe naftës, të cilat bëjnë pjesë në prodhim dhe pjesën tjetër për biznese prodhuese por për import. Bankat e tjera nuk japin të dhëna.

Ekspertët shprehin se shumica e instrumenteve lëshohen ndrejt vendeve të BE në 80-100% të rasteve për Alpha dhe Credins Bank, deri në 60% për Intesa Sanpaolo Bank dhe deri në 80 % për BKT Bank. Ekspertët e bankave shprehin se bashkëpunëtorët e vendeve të BE pothuaj i detyrojnë bashkëpunëtorët Shqipëtarë për të përdorur këto instrumente ndërsa drejt Kinës dhe vendeve të Ballkanit evitohen për të minimizuar kostot. Bashkëpunimi me

vendet e OECD është i ulët për shkak të rrezikut të lartë të vendit për Shqipërinë, shprehen ekspertët. Kjo ndodh sepse perceptimi i gjendjes financiare të vendit nga pikëpamja e tregjeve ndërkombëtare mund të ketë ndikim shumë konkret në zhvillimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve financave të tregtisë. Për shembull, Standard dhe Poor-së dhe Moody, dy agjenci ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë, sugjeron një rrezik të lartë në detyrimet e borxhit të qeverisë, i cili ka ndikime të forta në kursin e këmbimit. Kjo e bën huamarrjen e eksportuesit më të shtrenjtë, interesi do të rritet, dhe një zhvlerësim i mëvonshëm i monedhës do të ketë efektin e rritjes së shlyerjes së borxhit të huaj për kompanitë private dhe publike. Përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë minimizon rrezun politik, të kursit të këmbimit etj. Si i kemi përmendur në kapitullin e dytë.

Koha mesatare e aprovimit të instrumenteve dhe financimit nëpërpjet tyre ose jo është një muaj por ka raste që nevojitet edhe më shumë, dhe këtë e aprovojnë të gjithë ekspertët përvec ABI bank e cila ka një kohë të ulët të aprovimit deri në 10 ditë pune.

Kolaterali që kërkohet më së shumti kur financimi bëhet nga banka janë prona në 80% të rasteve dhe depozita deri në 20% të rasteve.

Dokumentacioni i kërkuar është në bazë të kërkesës nëse transaksioni kryhet me të gjithë financimin e klientit dokumentacioni është minimal por nëse klienti (importuesi) ka nevojë për financim të pjesshëm apo të plotë nga ana e bankës për të paguar ekstortuesin atëherë sasia e dokumentacionit të kërkuar është më i madh dhe koha e transaksionit zgjatet deri në plotesimin e plotë të tij nga ana e bankës së importuesit por edhe nga banka e eksportuesit.

Të gjitha bankat janë shprehur unanimitet se instrumentet e financave të tregtisë i ndihmojnë shumë bizneset të kryejnë transaksione të sigurta.

Të gjitha bankat janë shprehur unanimitet se edukimi i biznesit Shqipëtar në përdorimin e këtyre instrumenteve është i ulët. Por jo vetëm bizneset apo biznesmenët nuk i njohin dhe rrjedhimisht nuk i përdorin por edhe financierët (kjo do të thotë mungesë në formim/arsim) e bizneseve nuk i njohin, rrjedhimisht nuk i përdorin në punën e tyre të përditshme dhe

kështu nuk informojnë investitorin se si të mbrohen nga rreziku dhe nga mungesa e vazhdueshme e likuiditetit. Ekspertë e bankave shprehen se manualët dhe rregulloret e përdorimit të këtyre instrumenteve i kanë blerë online dhe privatish. Kjo do të thotë se nuk ndiqet një politikë konkrete nga ana e bankës qendrore për cështjen në fjalë. Si rrjedhojë e së gjithës mund të themi se edhe politika e Bankës Qendrore në Shqipëri në lidhje me përdorimin e tyre është një faktor kyc për zhvillimin e financave të tregtisë.

Të gjitha bankat janë përgjigjur unanimisht se formalizimi i biznesit në Shqipëri është i ulët dhe vlerësohet me 2 (pak). Ky është një nga faktorët problematik që kushtëzojnë zhvillimin e financimit të tregtisë duke filluar nga problemet me pronën dhe deri te pagesa e taksave apo problemet me bilancet në Shqipëri. Për të vazhduar më tej me korrupsionin në institucione dhe organizata i cili prish gjithë zinxhirin e vlerave dhe të meritokracisë. Këto bëjnë që dhe qasja në financim të jetë e ulët duke qënë në përputhje të plotë me të dhënat e publikuara nga WEF ku qasja në financim është faktori i dytë më i rëndësishëm pas taksave që pengon zhvillimin e biznesit. Korrupsioni në institucione dhe fortësia e tyre cojnë në destabilitet që në teori konsiderohet si rreziku politik apo rreziku i vendit dhe konsiderohet si faktor që ndikon apo kushtëzon zhvillimin e tregtisë së jashtme Shqipëtare.

Nuk ka kufizime ligjore në ofrimin e instrumenteve të tregtisë dhe vlerësohet me 1(aspak). Ekspertët shprehen se këto instrumente trajtohen si kreditë e zakonshme nga pikëpamja ligjore.

Arsyet e mospërdorimit të financave të tregtisë dhe instrumentave të tij në Shqipëri

Nga pyetësi rezulton se, dishponueshmëria e financave të tregtisë nëpërmjet instrumentave financiarë për biznesin në shqipëri është e ulët. Ekspertët shprehen se ka disa arsye pse këto instrumente nuk përdoren dhe nuk ofrohen gjithashtu në masë për biznesin Shqiptar.

Një arsye, për të cilën shprehen dhe ekspertët e bankave, është se tregtarët Shqipëtarë nuk i njohin këto instrumente dhe kështu nuk i kërkojnë. Momenti i vetëm në të cilin ata kërkojnë informacion është kur duan të nënshkruajnë një marrëveshje dhe bashkëpunëtori i huaj i kërkon përdorimin e këtyre instrumentave financiarë.

Por përsëri, oferta e bankave është e kufizuar në llojin e instrumentave që ofrojnë. Kështu dhe tregtarët e huaj eksportues apo inportues përballen me një problem në përmbushjen e marrëveshjes. Në të tilla raste tregtari Shqipëtar është i rrezikuar. Ai mund të humbi klientin apo bashkëpunëtorin duke u berë më pak konkures në treg. Si rrjedhim dhe financat e tij dobësohen. Rasti me i keq është kur produktet mund të jenë ushqime ose agro.

Arsye tjetër është promovimi i këtyre instrumentave. Pra bankat nuk informojnë bizneset e eksportit apo të importit për ekzistencën e këtyre instrumentave edhe kur ata nuk i kërkojnë instrumentet prane institucionit bankar.

Kultura e sipërmarrësve Shqipëtarë të cilët mendojnë se po të bëjnë cdo gjë vetë do të kursejnë dhe rreziku do të jetë më i ulët. Këtu ka vend për diskutim, sepse një biznes nuk mund të specializohet në të gjithë zinxhirin e vlerës dhe të minimizojë kostot në cdo hallkë. Prandaj biznese si bankat të specializuara në menaxhimin e rrezikut dhe ndërtimit të marrëdhënieve formale e ligjore mund të ndihmojnë ata të jenë më konkurent në tregun global, për më shumë kur rreziku i vendit është relativisht i lartë.

Disponueshmeria e instrumentave financiarë për biznesin është e kufizuar. Një sipërmarrës i vogël ose i mesëm për të kryer një transaksion nëpërmjet një instrumenti financiar bankar nuk mund ta gjejë këtë shërbim në filialin ku ai operon gjithmonë, sepse aty mungon eksperti. Vetë filialet e bankave të ndryshme thonë se, edhe në qendër ndodhet vetëm një ekspert dhe kuk ka departament të mirëfillt për ofrimin e tyre. Pra përvec gjendshmërisë dhe ekspertët janë të pakët.

Bizneset nuk janë të formalizuara sa duhet. Kjo bën që bankat të jenë skeptikë për financimin e tyre, edhe pse ato janë në dijeni për informalizimin e tyre. Ka disa arsye pse bankat nuk preferojnë SME-te për ti financuar:

- Kosto të larta trasankionesh- sepse kreditë e NPV-ve janë me kosto të lartë për shkak se ata janë zakonisht të vogla, në krahasim me kreditë për kompanitë e mëdha. Kreditë e NPV-ve shpesh konsumojnë më shumë kohë për të vlerësuar, monitoruar dhe menaxhuar. Shumë bankierë perceptojnë se bizneset e vogla kërkojnë mbështetje e këshillim më të madhe se bizneset e mesme dhe klientët e korporatave të mëdha. Bankat drejtohen nga teknologjia dhe NPV-te nuk ia lehtësojnë punën bankave në këtë drejtim. Nuk kanë një plan biznesi të qartë dhe të detajuar dhe një propozim i cili do mund të justifikojë sasinë e huasë që kërkojnë. Në këndvështrimin e një banke NPV-te janë riskoze dhe kanë kthime të ulta në krahasim me madhësitë e tjera të bizneseve.
- Informacioni joperfekt. Literatura për asimetrinë e informacionit parashtrohet se ka dy burime të rrezikut: përzgjedhje e keqe dhe rrezik moral. Përzgjedhja e keqe i referohet vështirësisë së zgjedhjes së një huamarrësi të mirë, ndërsa rrezik moral i referohet vështirësisë së zbatimit të kontratës për të cilën është rënë dakord. Rreziku i përzgjedhjes së keqe i ndalon bankat nga dhënia e kredive për ofertuesit me normë interesi të lartë duke i lejuar tregut për tu vetëpastruar. Përkundrazi, racionimi i kreditit bëhet, duke vënë në ekuilibër optimal normën e kthimit, dhe probabilitetin të mospagimit. Një mënyrë për bankat për të anashkaluar problemin asimetrike të informacionit është të kontrollojë huamarrësit nëpërmjet kolateralit dhe informacionin financiar. Kjo ngelet në doren e bizneseve për të komunikuar hapur ose jo me bankierët e tyre. Pra informacioni jo i saktë bën që bankat të praktikojnë interesa të larta për bizneset e vogla dhe projekte të produkte të njëjta për të gjitha pa përjashtuar edhe ato të rregullat.
- Rreziku i lartë i falimentimit NPV-ve – është një arsye më shumë për bankat për refuzuar financimin. Mungesa e kolateralit të NPV-te është një tjetër faktor bindës për institucionet financiare: Kolaterali i limituar - bankat mbrojnë asetet e tyre të kredituara nëpërmjet kolateralit. Edhe në qoftë se kolaterali është në dispozicion, në

vendet ku nuk ka regjistër të besueshëm për hipotekat, të pengjeve dhe garancive të tjera, që kolaterali mund të mos jetë ai që duket për shkak se ajo mund të jetë bllokuar tashmë për kredi të tjera. Sistemet ligjore në vendet ku është e vështirë për bankat për të zbatuar të drejtat për kolateral të kontribuojë gjithashtu në kujdesin e bankave për kreditimin e NPV-ve.

Konkluzione për pjesën analitike

Në këtë pjesë së punimit janë nxjerrë përfundimet nga analiza krahasuese e nivelin të zhvillimit të faktorëve që ndikojnë në financat e tregtisë të Shqipërisë me ata të vendeve partnere, duke identifikuar faktorët që kushtëzojnë zhvillimin e financave të tregtisë.

Bilanci tregtar negativ nuk e kushtëzon përdorimin e financave të tregtisë së jashme sepse nga statistikat rezulton se edhe vende të tjera me bilanc negativ të tregtisë, partnerë të Shqipërisë, të cilët përdorin më shumë se Shqipëria instrumentet e financave të tregtisë.

Volumi tregtar i Shqipërisë është i ulët në krahasim me volumin tregtar të vendeve partnere dhe përdorimi i financave të tregtisë është i ulët në krahasim me përdorimin e financave të tregtisë me vendet e tjera. Si rrjedhim mund të themi se, volumi tregtar ka një lidhje të drejtë me financimin tregtar të vendeve. Sa më shumë trensankione tregtare aq më i lartë numri i instrumenteve të përdorur për financave e tregtisë së jashme.

Borxhi publik nuk tregon ndonjë lidhje të rëndësishme me përdorimin e instrumenteve të financimit të tregtisë në afatshkurtër përderisa edhe vende me borxh të lartë publik edhe vende me borxh të ulët publik kanë përdorim të lartë të financave të tregtisë, e sigurisht më të lartë se Shqipëria. Rrjedhimisht borxhi publik i Shqipërisë nuk kushtëzon rritjen e përdorimin e instrumenteve të financave të tregtisë.

Përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë mund të rritet edhe më shumë edhe pse niveli i IHD-ve të Shqipërisë qëndron në nivelet aktuale. Pra niveli aktual i IHD-ve të Shqipërisë nuk e kushtëzon rritjen e përdorimit të financave të tregtisë.

Politika monetare e Shqipërisë favorizon përdorimin instrumenteve të financave të tregtisë duke shënjestruar inflacionin në një nivel të caktuar, regjimi i lirë i kursit të këmbimit i siguron ekonomisë shqiptare një instrument të dobishëm për përballimin e goditjeve të ndryshme ekonomike, nëpërmjet rivendosjes së shpejtë të ekuilibrit në shkëmbimet tregtare me jashtë dhe mbajtja e rezerva valutore shërben për të siguruar stabilitetin e kursit të këmbimit.

Zhvillimi i sistemit financiar të Shqipërisë lejon që përdorimi i instrumenteve të tregtisë të rritet akoma më shumë, pa qënë kusht zhvillimi i mëtejshëm i tij. Vende me zhvillim të sistemit financiar më të ulët se Shqipëria i përdorin më shumë instrumentet e financave të tregtisë.

Problem i rëndësishëm i biznesit Shqipëtar është qasja në financim, i cili e kushtëzon shumë përdorimin e financave të tregtisë. Megjithatë dhe panvarësisht kësaj Spanja e Italia kanë një vështirësi më të madhe se Shqipëria për të dhënë hua dhe nivelin e disponibilitetit të instrumenteve për financat e tregtisë e kanë më të lartë.

Aftësia kredituese e Shqipërisë nuk përbën pengesë për Shqipërinë duke vlerësuar se vende me aftësi kredituese më të ulët kanë përdorim të financave të tregtisë më të lartë. Serbia ka aftësi kredituese të njëjtë me Shqipërinë dhe përdorim të financave të tregtisë më të lartë.

Analiza tregon se në Shqipëri përdorimi i financave të tregtisë nuk ndikohet nga niveli i cilësisë së bankave.

Aspekti ligjor për sistemin financiar është shumë i mirë dhe i rregulluar. Pra aspekti ligjor nuk e kushtëzon zhvillimin e rritjen e përdorimit të financave të tregtisë në Shqipëri.

Shqipëria nga vlerësimet ka një rrezik të lartë të vendit dhe sipas teorisë dhe gjetjeve empirike të mëparshme duhet që me rritjen e rrezikut të vendit të rritet edhe përdorimi i instrumenteve të financave të tregtisë.

Korrupsioni në institucion deformon realitetin duke krijuar një system klientelist për interesa vetiake, kjo bën më të më të vështirë tu besosh institucioneve. Kështu bizneset dhe bashkëpunëtorët e tyre të huaj ezitojnë ti kërkojnë instrumentet. Por jo vetëm korrupsioni në institucionet financiare pengon bashkëpunimin me patnëret në tregti por edhe korrupsioni në institucionet gjyqësore. Aftësia e institucioneve gjyqësore për të zgjidhur, në kohë pa u korruptuar dhe në transparencë të fakteve, një mosmarrëveshje midis palëve pengon rritjen e përdorimit të financave të tregtisë. Thënë ndryshe, korrupsioni kushtëzon zhvillimin e financave të tregtisë.

Si përfundim financat e tregtisë kanë një natyrë të sigurt në përdorim këtë e tregojnë edhe të dhënat e publikuara nga ICC. Qeveri të vendeve të ndryshme qofshin vende të varfëra si Afrika apo një vend si Kina janë ndërgjegjësuar për të mirat që sjell përdorimi i financave tregtare dhe e implementojnë atë në shumë aspekte të ekonomisë duke mbështetur eksportet, lehtësuar varfërinë dhe duke e zhvilluar atë.

7.2. Rekomandime

Financat e tregtisë, janë dukshëm pak e kuptuar për ndjekjen dhe zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, nga kompanitë e të gjitha madhësive, dhe nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në veçanti. Të cilët janë bazuar në zhvillim dhe në zgjerimin e tregjeve kanë nevojë edhe më urgjente të likuiditetit dhe të zbutjes së rezikut përmes financave të tregtisë. Kriza globale financiare ka treguar se sektorin publik dhe aktorët ndërkombëtarë të institucioneve kanë një rol të rëndësishëm në sigurimin e financave, sidomos (por jo ekskluzivisht) në kohë krize.

Financat e tregtisë duhet të kuptohen në kuptimin më të gjerë të mundshëm, që përfshin çdo financim dhe veprimtari të lidhura në zbutjen e rrezikut, që synon të mbështesë zhvillimin e tregtisë ndërkufitare. Fokusi duhet të jetë në një kuptim tërësor të kësaj fushe, lidhja e saj me zhvillimin e tregtisë dhe potencialin e saj të qartë për të kontribuar në zhvillimin ndërkombëtar dhe rritjen e mireqenies.

Zgjidhja e problemeve me informalitetin dhe korrupsionin

Informaliteti është një ndër problemet kryesore që ndeshin tregtarët e huaj në Shqipëri, prandaj është detyrë zgjidhja. Zgjidhja e problemeve informalitetit dhe korrupsionin do të ndikonte në zgjerimin e aktiviteteve që zhvillojnë financimin e tregtisë dhe si rrjedhim dhe biznesin.

Shqipëria ka bërë progres në përmirësimin e klimës së biznesit, por përmirësimi i vazhdueshëm si: rritja e transparences, lehtësirat e të bërit biznesi, rritja e nivelit të shërbimit të administratës publike etj, do të ndikojë jo vetëm në nxitjen e biznesit për të investuar si rrjedhim prodhim më I madh si rrjedhim eksporte më të larta.

Rregullimi i pronësisë

Rregullimi i pronësisë do të përmirësonte marrëdhëniet midis tregtarëve dhe institucioneve tregtare dhe lehtësim të kreditimit.

Trajnimi dhe kualifikimi i menaxherëve dhe financierëve

Trainimi dhe kualifikimi i menaxherëve dhe financierëve do të conte në një shërbim më të mire të këtyre instrumentave dhe këshillim të tregtarëve për mundësitë dhe benefitet që ofrojnë instrumentet e financimit të tregtisë.

Ofrimi i një game më të gjerë të instrumenteve

Ofrimi i limituar i tyre dhe një mosdakortësi midis bashkëpunëtorësh për përdorimin e instrumentit të financave tregtare con në prishje të marrëveshjes. Ofrimi i game më të gjerë të instrumenteve do ti shërbente tregtarit të krijonte më lehtë marrëveshjet e tij me bashkëpunëtorët ndërkombëtarë. Si pasojë do të rriteshin flukset tregtare në vend.

Lehtësira në financim të biznesit

Lehtësia në financim i tregtisë duke rritur përdorimin e financave të tregtisë do të bënte që të rritej likuiditeti në biznes dhe rritja e flukseve tregtare.

Informimi në masë i biznesit

Krijimi i një rrjeti të koordinuar informativ të institucioneve financiare në lidhje me instrumentet e financimit të tregtisë. Si mediat, interneti, media e shkruar, informim me fletëpalosje e manual ose informim direct nga sportelet e bankave.

Ulja e kohës së aprovimit

Ulja e kohës së aprovimit të dokumentit do të ishte lehtësuese si për biznesin dhe për bankat duke krijuar likuiditet të biznesi dhe rritje të klientëve për bankën.

Trainimi dhe kualifikimi i punonjësve në institucione financiare

Disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar do t'i përgjigjej më mirë kërkesave të tregut. Trainimi dhe kualifikimi i punonjësve në institucionet financiare do të conte në një shërbim më të mirë të këtyre instrumentave dhe këshillim të tregtarëve për mundësitë dhe benefitet që ofrojnë instrumentet e financimit të tregtisë. Kështu bëhet edhe lidhja treg pune – dije, për çështjen në fjalë, e cila është problem madhor në Shqipëri.

Informimi në lidhje me instrumentet

Informimi mbi pëdorimin, domethënë, kur përdoret një instrument, për çfarë shtate është i rëndësishëm/nevojshëm, çfarë të mirash sjell? Ose, a është në gjendje banka me të cilën punoj të më mundësoj instrumentin e duhur për nevojat e mia? Ose, a jam në gjendje ta menaxhoj rrezikun deri në fund pa ndihmë, a më mjaftojnë fondet që kam në dispozicion, a i menaxhoj dot marrëdhëniet me bashkëpunëtorët, (sidomos kur janë bashkëpunëtor të rinj)

Rekrutimi i stafit

Rekrutimi i menaxherëve dhe i financierëve të cilët kanë informacion ose janë trajnuar në lidhje me instrumentet e financave tregtare dhe menaxhimin e rrezikut.

Menaxherët duhet të përgatiten në përputhje me rrethanat, me një analizë të normave të interesit dhe çmimeve të aksioneve, bilancit të pagesave të vendit, parashikimeve të politikave të mundshme makroekonomike dhe defiçencave fiskale dhe të llogarive korente. Është e rëndësishme që të shqyrtohen skenarët dhe projeksionet e mundshme alternative

dhe të përcaktohen probabilitete për secilin skenar për të përcaktuar rreziqet dhe përfitimet që lidhen me mundësitë e veçanta të biznesit.

Ndërgjegjësimin e biznesit, bankave dhe politikbërësve mbi rëndësinë e financave të tregtisë dhe domosdoshmërinë e përdorimit të këtyre instrumentave në shkëmbimet ndërkombëtare nëpërmjet punimeve shkencore.

Lehtësimi dhe koordinimi global të përpjekjeve, menaxhimin e njohurive, dhe rekomandime të politikave rreth tregtisë . Angazhim i bankave shumëpalëshe të zhvillimit, dhe të tjerët për të shtuar më tej me diskutimet rreth rastit, por jo mbyetje rregullimin e ndermjetesimit të bankës me financa të tregtisë, duke përfshirë mjaftueshmërinë e kapitalit, pajtim, kujdesin e duhur.

7.1. Kontributi i punimit

Besoj se ky punim mund të japë ndihmë në disa drejtime:

Kjo analizë është e rëndësishme për të ndihmuar biznesin në menaxhimin e rrezikut gjatë transaksioneve tregtare por dhe në ndërtimin e politikave të përshtatshme në tregtinë e jashtme për biznesin në Shqipëri.

Duke shpresuar se ky punim do të kontribuojë në tejkalimin e hendekut të dijes midis institucioneve financiare dhe firmave në vendin tonë, duke çuar në sukses të qëndrueshëm dhe ndikim në zhvillim. Punimi nëpërmjet pyetësorit bën një pasqyrë të përdorimit të financave të tregtisë në tregun bankar Shqipëtar dhe nëpërmjet analizës krahasuese, të nivelit të zhvillimit të faktorëve që kushtëzojnë financat e tregtisë me vendet e tjera, identifikon faktorët më problematik për çështjen në fjalë në Shqipëri.

Punimi ndihmon studiuesit dhe hartuesit e politikave me të dhena primare të mbledhura në tregun bankar Shqipëtar dhe analizimin e faktoreve të cilët duhen përmësuar për zhvillimin e financave të tregtisë.

Ky punim mund të jetë një burim shumë i mirë për studiues që në të ardhmen dëshirojnë të studiojnë çështjen. Këtë e them duke vënë re se instrumente të financave të tregtisë kanë një natyrë me rrezik të ulët në transaksionet tregtare, duke u përqëndruar në sektorë kyç si në sektorin bankar dhe biznes. Këto modele mund të shërbëjnë dhe për studimin e mëtejshëm në sektorë të vecantë të ekonomisë.

6.4. Kërkimet e ardhshme

Ky punim më jep shtysë që në vitet e ardhshme studimet të përqëndrohen në:

Studimin e mëtejshëm në sektorë kyç të ekonomisë.

Studimin e mëtejshëm në sektorin privat.

Studim i çështjes nga kënvështimi i biznesit dhe kostove të përdorimit të financave të tregtisë.

Në studime të ardhshme, nese ka të dhena statistikore, të vlerësohet ndikimi i financave të tregtisë mbi importet dhe eksportet.

Shtojca 1

Pyetesor per Bankat dhe Institucione Financiare

Ky pyetesor ka te beje me perdorimin instrumentave financiare bankare ne ndihme te tregtise nderkombetare.

Ky studim behet ne kuader te marrjes se titullit Doktor te Shkencave Ekonomike, prane universitetit UET dhe ka si qellim te evidentoje perdorimin e ketyre instrumenteve ne tregun Shqiptar dhe faktoret qe e kushtezojne ate.

Bashkepunimi juaj do ti jepte vlere studimit dhe do te permendet ne punim si nje vlere e shtuar ne qellimin e tij.

Pyetensori kerkon vetem pak minuta nga koha juaj.

Ju faleminderit per mirekuptimin

Dr(c)Dorina Çumani

Rretho, nenvizo ose pergjigju individualisht pyetjes.

1. A i perdorni instrumentet financiare te Financimit te tregtise?

- LC (leter kredie)
- Cash-in-Advance
- Documentary Collections (D/C)
- Open Account
- Consignment
- Export Credit Insurance
- Factoring
- Forfeiting
- ose te tjera qe nuk permenden.

2. Nese po, sa i perdorni? (numri i klienteve ne interval)

- a. 10-30 b. 30-50 c. 50-70 d. 70-100 e. Vendos nje interval tjeter.

3. I perdorni me se shumti ne eksport apo ne import?

<u>Ne eksport</u>	<u>Ne import</u>
20-40% te klienteve	20-40% te klienteve
40-60%	40-60%
60-80%	60-80%
80-100%	80-100%
Vendos nje interval tjeter	Vendos nje interval tjeter

4. A keni kufizime ne kohe ? dokumenta, financa etj?

Koha e aprovimit a. 5-10 b. 10- 20 c. 20 – 30 dite

(ose vendos nje interval tjeter)

5. A keni kufizime ne financa?(Leke)

Sasia e financimit a. 100 000- 300 000 b. 300000- 500000 c. 500000-1000000

d. vendos nje interval tjeter

6. A keni kufizime per bizneset?(te vogla, te mesme apo te medha)?

0-20% binese te vogla	0-20% binese mesme	0-20% binese te medha
20-40%	20-40%	20-40%
40-60%	40-60%	40-60%
60-80%	60-80%	60-80%
80-100%	80-100%	80-100%
Vendos nje interval tjeter	Vendos nje interval tjeter	Vendos nje interval

Shenim. Rretho ose nenvizo sa % te bizneseve qe financoni jane te vogla, te mesme apo te medha.

7. A keni biznese te preferuara?

0-20% binese agro	0-20% binese prodhim	0-20% binese sherbime
20-40%	20-40%	20-40%
40-60%	40-60%	40-60%
60-80%	60-80%	60-80%
80-100%	80-100%	80-100%
Vendos nje interval tjeter	Vendos nje interval tjeter	Vendos nje interval tjeter

Shenim: vendos ne interval ndonje biznes tjeter qe financoni nese ka.

8. A operoni vetem me shtete te caktuara, ne perdorimin e ketyre instrumentave?

(Ku me shume ne vendet e BE, OECD, Ballkan, Tjeter)

0-20% 20-40% 40-60% 60-80% 80-100%

Vendos nje interval tjeter

Shenim : vendos ne krah te perqindjes rajonet ku operoni me shume.

9. A i ndihmojne keto instrumente klientet te kryejne shkembime tregtare te sigurta?

Nga 1(aspak) deri ne 4 (shume) si e vleresoni? (komente nese ka)

10.Sa e vlereson edukimin e biznesit ne perdorimin e ketyre instrumenteve?

Nga 1 (aspak) -4 (shume) sa e vlereson?

11.A i keshilloni klientet tuaj te perdorin instrumentet e duhura per transaksione te caktuara?

Nga 1 (aspak) -4 (shume) sa e vlereson?

12.Cfare kapitali kerkoni si kolateral me shpesh?

Prona (shtepi,magazine, etj)	0-20%	20-40%	40-60%	60-80%	80-100%
--------------------------------------	-------	--------	--------	--------	---------

Asete (makineri, vegla pune etj)	0-20%	20-40%	40-60%	60-80%	80-100%
---	-------	--------	--------	--------	---------

Produkte, inventare tjeter	0-20%	20-40%	40-60%	60-80%	80-100%
-----------------------------------	-------	--------	--------	--------	---------

Llogari rrjedhese tjeter	0-20%	20-40%	40-60%	60-80%	80-100%
---------------------------------	-------	--------	--------	--------	---------

Tjeter...

13.A ka pengesa ligjore per ofrimin e ketyre instrumenteve? (nese po, cilet jane)

Nga 1 (aspak) -4 (shume) sa e vlereson

14.Sa e vleresoni formalizimin e binesit ne Shqiperi?

Nga 1-4 sa e vleresoni?

15.Si mendoni sa i kushtezojne faktoret e renditur me pashte perdorimin e ketyre instrumenteve?

Kushtet e tregtise	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
---------------------------	--------------	------------	--------------------	--------------

Politika monetare	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
--------------------------	--------------	------------	--------------------	--------------


Zhvillimi i sistemit financiar	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
---------------------------------------	--------------	------------	--------------------	--------------

Kostot e huamarrjes	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
Institucionet Financiare	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
Mjedisi ligjor	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
Pengesat ne kreditim apo capital	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
Borxhi i jashtem i vendit	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
Kursi i kembimit	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume
Tjeter factor qe nuk eshte permendur	Aspak	Pak	Mjaftueshem	Shume

Emer , Mbiemer, Emri i institucionit

Faleminderit, Dr(c) Dorina Çumani

SHTOJCA 2



Metodat dhe instrumentet e financimit të tregtisë mund të klasifikohen gjerësisht në tri kategori:

- Metodat dhe instrumentet për të ngritur kapital (në të verdhë në figurë)
- Metodat dhe instrumentet për zbutjen e rreziqeve (në të gjelbër në figurë)
- Metodat dhe instrumenti për të bërë pagesën (në dritën gri në figurë)

Figure 2.3. Documentary collection process





Figure 2.4. Letters of credit



Figurat tregojne procesin e marrjes se nje instrumenti te financave te tregtise.

Figure 5.5. Kazakhstan 2002 ready reckoner chart





Figura tregon indeksimin e niveli te zhvillimit te faktoreve makroekonomik te Kazakistanit ne vitin 2002

Nga teoria dihet se mjedisi makroekonomik ndikon zhvillimin Financave të Tregtisë e nëpërmjet disa elementeve: situates së tregtisë, burimeve, borxhet e jashtme dhe likuiditeti, politika e kursit të këmbimit, sistemi monetar dhe sistemi financiar, tregu i kreditimit, mjedisi ligjor dhe rreziku i vendit. Funksionimi jo i mirë i këtyre elementeve bën që institucionet financiare të mos funksionojnë mirë, kapitali dhe kreditë të tkurren dhe kostot e borxhit të rriten (UNCTAD/WTO 2005).



Avantazhe dhe disavantazhe te leter kredise L/C




Figura tregon procesin e Sigurimit te nje leter kredie

Depozitat dhe huate sipas bankave nga AAb per 2016

BANKS*	Total Assets		Loans		Deposits	
	in LEK	in % **	in LEK		in LEK	in %
Alpha Bank Albania	73,801,572,570	5.1 5%	34,922,403,044	5.8 6%	58,889,463,592	5.07 %
American Bank of Investments	36,912,100,549	2.5 7%	10,619,724,637	1.7 8%	31,459,194,775	2.71 %
Banka Kombëtare Tregtare	386,899,302,555	26. 98%	129,075,280,881	21. 66%	300,967,000,863	25.9 0%
Credins Bank	166,936,910,643	11. 64%	94,511,302,931	15. 86%	143,041,973,752	12.3 1%
Credit Bank of Albania	2,858,832,899	0.2 0%	310,876,335	0.0 5%	1,300,934,049	0.11 %
FIBANK Albania	18,795,225,035	1.3 1%	7,049,429,468	1.1 8%	16,093,342,598	1.38 %

International Commercial Bank	10,006,353,247	0.70%	4,136,627,636	0.69%	7,534,309,523	0.65%
Intesasanpaolo Bank Albania	155,724,724,096	10.86%	45,239,962,460	7.59%	125,974,219,606	10.84%
NBG Bank Albania	41,764,345,137	2.91%	28,857,269,411	4.84%	30,900,169,065	2.66%
ProCredit Bank	33,243,909,334	2.32%	19,893,840,630	3.34%	27,302,128,611	2.35%
Raiffeisen Bank Albania	270,035,274,593	18.83%	110,107,724,982	18.48%	229,338,768,718	19.73%
Societe Generale Albania	81,202,984,502	5.66%	47,159,083,319	7.92%	64,199,729,591	5.52%
Tirana Bank	81,503,444,229	5.68%	30,822,303,021	5.17%	63,585,399,549	5.47%
Union Bank	41,489,418,749	2.89%	18,211,974,015	3.06%	34,106,196,535	2.93%
United Bank of Albania	6,264,343,000	0.44%	3,940,090,000	0.66%	4,959,828,000	0.43%
Veneto Banka	26,429,322,218	1.84%	10,955,018,602	1.84%	22,588,701,191	1.94%
Totali	1,433,868,063,356	100%	595,812,911,372	100%	1,162,241,360,018	100%

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Ahn JaeBin (November, 2014) , “Understanding Trade Finance: Theory and Evidence from Transaction-level Data “, International Monetary Fund, PRELIMINARY DRAFT.

Ahn, J. (2013).” Estimating the direct impact of bank liquidity shocks on the real economy: Evidence from letter-of-credit import transactions in Colombia.” Washington, DC: International Monetary Fund.

Albania | Credit Rating, <https://tradingeconomics.com/albania/rating>, (pare me Qershor 2017)

Amiti, Mary and David E Weinstein (2011), "Exports and Financial Shocks", *The Quarterly Journal of Economics*, 126 (4), 1841-1877

Anderson 1978; Bergstard 1985; Helpman 1987; Deardorff 1998). Linder (1961), Tinberben (1962) dhe Linnemann (1966), Gravity Model

Antàs, Pol, and C. Fritz Foley. 2011. Poultry in Motion: A Study of International Trade Finance Practices, NBER Working Paper 17091.

Atradius N.V.insurance group, www.atradius.com

Auboin, M. (2009), “Boosting the availability of trade finance in the current crisis: Background analysis for a substantial G20 package,” London, CEPR Policy Insight (35).

Auboin, M. (2012), “Use of Currencies in International Trade: Any Changes in the Picture?,” Geneva, World Trade Organization, WTO Working Paper No. ERSD-2012-10.

Auboin, M. and M. Engemann (2012), “Testing the Trade Credit and Trade Link: Evidence from Data on Export Credit Insurance,” Geneva, World Trade Organization, WTO Working Paper No. ERSD-2012-18.

Auboin, M., & Engemann, M. (2014). Testing the trade credit and trade link: Evidence from data on export credit insurance. *Review of World Economics*, 150, 715-743.
B2BeX(www.scb2bex.com).

Baldwin, Richard E. (2010), “Understanding the GATT’s wins and the WTO’s woes,” London, Centre for Economic Policy Research, CEPR Policy Insights No. 49.

Baldwin, Richard (2009), *The Great Trade Collapse: Causes, Consequences and Prospects*, ebook, VoxEU.org, 27 November.

Beck, T. (2002), “Financial development and international trade Is there a link?,” *Journal of International Economics* 57(1): 107-131.

Berman, N., & Martin, P. (2012). The vulnerability of sub-Saharan Africa to financial crises: The case of trade. *IMF Economic Review*, 60(30).
BIS , www.bis.org

Bishop, Eric (2004), “Finance of International Trade”, Elsevier

Borens, Michael tein, L. V. Hedges, J. P. T. Higgins and H. R. Rothstein, “Introduction to Meta-Analysis” 2009, John Wiley & Sons, Ltd. ISBN: 978-0-470-05724-7

Brandi, Clara and Schmitz, Birgit, (2015) “Trade flows in developing countries: What is the role of trade finance?” German Development Institute / Deutsches Institut für Entwicklungspolitik (DIE).

Brandi, Schmitz, “What is the role of trade finance?”, 2015 German Development Institute / Deutsches Institut für Entwicklungspolitik (DIE).
Bricogne, J.-C., Fontagné, L., Gaulier, G., Taglioni, D., & Vicard, V. (2012). Firms and the global crisis: French exports in the turmoil. *Journal of International Economics*, 87(1), 134-146.

Chor, D., & Manova, K. (2012). Off the cliff and back? Credit conditions and international trade during the global financial crisis. *Journal of International Economics*, 87(1), 117-133.
Coface - Country risk assessment map, [www. Coface country risk assessment map](http://www.cofacecountryriskassessment.com), (23.03. 2016)

Country Risk Classifications of the Participants to the Arrangement on Officially Supported Export Credits, <http://www.oecd.org/tad/xcred/crc.htm>, (28 October 2016)

Çumani, Dorina, "Integrimi i informacionit të Indeksit Global të Konkureshmerise në një model statistikor Graviteti për Shqipërinë", 2013, Universiteti European i Tiranës.

Del Prete, S., & Federico, S. (2014). *Trade and finance: Is there more than just "trade finance"?* Evidence from matched bank-firm data (Banca d'Italia Working Paper 948). Rome: Banca d'Italia.

Dokumenti i Politikës Monetare u miratua me vendimin nr. 4, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë., Albdesign, WWW.bankofalbania.org
Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik Drejtoria e strategjisë dhe monitorimit të borxhit Sektori i Rregjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit
[http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Borxhi/Treguesit_e_borxhit/2017/Buletini_Borxhi_Q1_2017_shqip_\(1\).pdf](http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Borxhi/Treguesit_e_borxhit/2017/Buletini_Borxhi_Q1_2017_shqip_(1).pdf) (pare më qersor 2017)

Dun & brandsrteet, www.dnb.com

Egger, P., & Url, T., (2006), Public export credit guarantees and foreign trade structure: Evidence from Austria. *The World Economy*, 29(4), 399-418.

Experian, www.experian.com

Fisman, R., and M. Raturi. 2004. "Does Competition Encourage Credit Provision? Evidence from African Trade Credit Relationships." *Review of Economics and Statistics* 86 (1): 345–52.

Foreign Direct Investment (FDI) stocks, <https://data.oecd.org/fdi/fdi-stocks.htm#indicator-chart> (pare me qershor 2017)

Foreign Direct Investment (FDI) stocks, <https://tradingeconomics.com/albania/foreign-direct-investment> (parë më qershor 2017)

Friederike Niepmann, Tim Schmidt-Eisenlohr (2014), “International Trade, Risk, and the Role of Banks”, Federal Reserve Bank of New York Staff Reports

General government debt, <https://data.oecd.org/gga/general-government-debt.htm> (pare më Qershor 2017)

Giannetti, Mariassunta, Mike Burkart, and Tore Ellingsen. 2008. “What You Sell Is What You Lend? Explaining Trade Credit Contracts.” *The Review of Financial Studies* (online). <http://rfs.oxfordjournals.org/content/early/2007/12/31/rfs.hhn096.extract>.

Glady, Nicolas and Potin, Jacques (August 5, 2011),” Bank Intermediation and Default Risk in International Trade - Theory and Evidence”.

Global Trade Corporation GTC (www.globaltradecorp.com)

Golden gate university San Francisco, Ca
([Http://internet.ggu.edu/~emilian/bankreq.html#LC](http://internet.ggu.edu/~emilian/bankreq.html#LC)).

Grath, Anders (2008),”The handbook of international trade and finance: the complete guide to risk management, bonds and guarantees, credit insurance and trade finance”, Kogan Page.

Grossman, Gene M. and E. Helpman (2005), “Outsourcing in a Global Economy,” *Review of Economic Studies* 72: 135-159.

Gupta, Satya Dev,” Comparative Advantage and Competitive Advantage: An Economics Perspective and a Synthesis, 2009, St. Thomas University, Fredericton, N.B., Canada

GUSTIN, DAVID , China Trade Finance 2016: A closer look at the trends and issues shaping the market, <http://spendmatters.com/tfmatters/china-trade-finance-2016-closer-look-trends-issues-shaping-market/> (pare më qershor 2017)
Handbook for Economies in Transition”, Thailand.

http://www.trademap.org/tradestat/Country_SelProduct_TS.aspx?nvpm=1||||TOTAL|||2|1|1|3|2|1|2|1|1 , (parë më qershor 2017)

Iacovone, L., & Zavacka, V. (2009). *Banking crises and exports: Lessons from the past* (Policy Research Working Paper 5016). Washington, DC: World Bank.

ICC (2008), “Rethinking Trade & Finance” Global Trade and Finance Survey

ICC (2009), “Rethinking Trade & Finance” Global Trade and Finance Survey

ICC (2010), “Rethinking Trade & Finance” Global Trade and Finance Survey

ICC (2011), “Rethinking Trade & Finance” Global Trade and Finance Survey

ICC (2012), “Rethinking Trade & Finance” Global Trade and Finance Survey

ICC (2013), “Rethinking Trade & Finance” Global Trade and Finance Survey

ICC (2014), “Rethinking Trade & Finance” Global Trade and Finance Survey

ICC (2015), “Rethinking Trade & Finance”, Global Trade and Finance Survey

IFC (INTERNATIONAL FINANCE CORPORATION, WASHINGTON D.C., US,”World Bank Group,” Global Trade Finance Program. Promoting a Network of Bank Partnerships”.

IMF (2003), “Trade Finance in Financial Crisis – Assessment of Key Issues”, Seminar Document, IMF Conference on Trade Finance, Brennan, Michael, Vojislav Maksimovic, and Josef Zechner. 1988. “Vendor Financing.” *The Journal of Finance* 43 (5): 1127–41. Washington, DC, 15 May,.

IMF-BAFT Trade Finance Survey (2009), "Survey Among Banks Assessing Current Trade Finance Environment".

International Monetary Found, <http://www.imf.org/>

ITA, The International Trade Administration (2007), “Trade Finance Guide: A Quick Reference for U.S. Exporters “,U.S Departament of Comerce,

ITA, The International Trade Administration (2008), “Trade Finance Guide: A Quick Reference for U.S. Exporters “,U.S Departament of Comerce,

ITA, The International Trade Administration (2012), "Trade Finance Guide: A Quick Reference for U.S. Exporters", U.S. Department of Commerce,

ITC, The International Trade Centre (2009), "HOW TO ACCESS TRADE FINANCE. A GUIDE FOR EXPORTING SMEs", Switzerland

Keljikian, Sadie and Estrakh, David, Express Trade Capital, January 27, 2017, TRADE FINANCE VS. BANK LOANS PART I: WHY TRADE FINANCE

, <https://www.expresstradecapital.com/trade-finance-vs-bank-loans-part-1/>

Korinek, Jane, Jean Le Cocguic and Patricia Sourdin (2010), "The Availability and Cost of Short- Term Trade Finance and its Impact on Trade", OECD Trade Policy Papers, 98.

Krugman, 1993; Baldwin, 1996; Harris etj.2008. Frankel, Stein dhe Wei (1997) ,Gravity Model.

Krugman, Obstfeld, Melitz, 2012, "International Economics Theory & Policy", Parson, fq.10-155.

LatinTrade, 1999, <http://latintrade.com/1999/01/>

List of markets for the selected product Product: TOTAL All products:

Liston, Daniel Perez dhe McNeil Lawrence, "The impact of trade finance on international trade: Does financial development matter? Research in Business and Economics Journal

Love, Inessa dhe Zaidi, Rida , "Trade Credit, Bank Credit and Financial Crisis", World Bank, Interanional Trade Center, <http://www.intracen.org/>

Malaket ,Alexander R., (October 2013), Financing International Trade: Ankara, Turkey, CITP, President OPUS Advisory Services International Inc.

Malaket, Alexander R , "Leveraging Supply Chain Finance for Development", World Economic Forum, and Center for International Development at Harvard University September 2015, Geneva, Switzerland.

Malaket, Alexander R., (2014), Financing Trade and International Supply Chains Commerce Across Borders, Finance Across Frontiers, GOWER, p.1-34.

Manova, K. (2008b), “Credit Constraints, Heterogeneous Firms, and International Trade,” Cambridge MA, National Bureau of Economic Research, NBER Working Paper No. 14531.

Manova, K. (2013). Credit constraints, heterogeneous firms, and international trade. *Review of Economic Studies*, 80(2), 711-744.

Moise, Evdokia and Le Bris, Florian, “TRADE COSTS: WHAT HAVE WE LEARNED? A SYNTHESIS REPORT”, 2013, OECD Trade Policy Paper No. 150

Monterey Bay International Trade Association (MBITA)

([Http://www.tradeport.org/ts/trade_expert/details/payment/cash.html](http://www.tradeport.org/ts/trade_expert/details/payment/cash.html))

Niepmann, F., & Schmidt-Eisenlohr, T. (2013). *Banks in international trade finance: Evidence from the US*. (Staff Report 633). New York: Federal Reserve Bank of New York.

Niepmann, Friederike and Schmidt-Eisenlohr, Tim, (April 21, 2014), ”No Guarantees, No Trade: How Banks Affect Export Patterns”

Olsen, Morten Graugaard (2010),” Banks in International Trade: Incomplete International Contract Enforcement and Reputation , November 11, 2010 JOB MARKET PAPER

OPUS (March 2013),”Observations on the Evolution of Trade Finance and Introduction to the Bank Payment Obligation Educational report”

Paravisini, D., Rappoport, V., Schnabl, P., & Wolfenzon, D. (2015). Dissecting the effect of credit supply on trade: Evidence from matched credit-export data. *Review of Economic Studies*, 82(1), 333-359

Rauch, J. E. and V. Trindade (2002), “Ethnic Chinese Networks In International Trade,” *Review of Economics and Statistics* 84(1): 116-130.

Ronci, Marcio (2004), “Trade Finance and Trade Flows: Panel Data Evidence from 10 Crises” Authorized for distribution by Martin Gilman, International Monetary Fund.

https://www.snscourseware.org/snsce/files/CW_588b1c213bea3/IBM%20case%20study.pdf

Schmidt-Eisenlohr, Tim (2009), “Towards a Theory of Trade Finance”, European University Institute.

Spolaore, E. and R. Wacziarg (2009b), “War and Relatedness,” Cambridge MA, National Bureau of Economic Research, NBER Working Paper No. 15095.

Shoqata Shqipëtare e Bankave, Aab
http://www.aab.al/documents/stat/q2016/Q4_2016_Consolidated_Quarterly_Unaudited
 Banking Data IFRS, (parë më qershor 2017)

Tregtia e jashtme 2012 – 2016, www.instat.gov.al (parë më qershor 2017)

United Nations and ITC (2005), “Trade Finance Infrastructure Development
United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL) www.uncitral.org

Van der Veer, K. J. M. (2015). "The private export credit insurance effect on trade". *Journal of Risk & Insurance*, 82(3), 601-624.

Zoto,Oltiana, (2012)”Investimet e huaja direkte ne Shqiperi, Analize e efekteve , politikave dhe lidhja me rritjen ekonomike”, Universiteti i Tiranes, Departamenti i Ekonomise.

WEF _Global_Competitiveness_Report_2015-2016, Geneva, Switzerland

WEF, “The Global Competitiveness index historical dataset”, GCI_Dataset_2006-2015
Geneva, Switzerland

WEF_ The Global Competitiveness Report 2014–2015, Geneva, Switzerland

WEF_GlobalCompetitivenessReport_2009-10, Geneva, Switzerland

WEF_GlobalCompetitivenessReport_2010-11, Geneva, Switzerland

WEF_GlobalCompetitivenessReport_2012-13, Geneva, Switzerland

WEF_GlobalCompetitivenessReport_2013-14, Geneva, Switzerland

WEF_SCT_EnablingTrade_Report_2013, Geneva, Switzerland

WEF_SCT_EnablingTrade_Report_2015, Geneva, Switzerland

World Bank, “International trade payment methods”,
[http://lnweb90.worldbank.org/ECA/Transport.nsf/0/786e3f9f52ad321485256b7a0051b6be/\\$FILE/PAYMENTP.pdf](http://lnweb90.worldbank.org/ECA/Transport.nsf/0/786e3f9f52ad321485256b7a0051b6be/$FILE/PAYMENTP.pdf)

World bank, www.worldbank.org

World Intellectual Property Organization (2011), *World Intellectual Property Report 2011: the changing face of innovation*, Geneva: WIPO

World Trade Organization (WTO) (2011), *Trade in Financial Services and Development*, Geneva, World Trade Organization, Note by the Secretariat S/FIN/W/76.

World Trade Organization ‘Trade finance and SMEs Bridging the gaps in provision’,faqe 20-36

World Trade Organization, www.wto.org

World Trade Report ,2013 , “Factors shaping the future of world trade”, Published by the World Trade Organization, Geneva.

Wyman, Oliver,(2008),”The Future of Transaction BankingVolume 2: Trade Finance Financial Service”,MMC.

